



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I
VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital”
Universiteti “EPOKA”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Elson Agastra



Dr. Miranda Harizaj

Korrik 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital"

| | | |
|------|---|---|
| Nr. | | |
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "EPOKA" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike (Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë) |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMASh Nr. 269 datë 28.06.2012 (VKA Nr.332, datë 08.06.2012) ky program studimi është hapur me emërtimin: Bsc Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacion ". |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | UMASh Nr. 232, datë 06.06.2013 (VKA Nr. 432, datë 03.05.2013) është bërë riorganizimi duke ndryshuar emërtimi në: Bsc Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital . |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër MASR Nr. 103, datë 09.03.2016 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës: | UMAS Nr.359, datë 25.09.2015 (Sipas VKA Nr. 51, datë 29.06.2015) |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli I |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Anglisht |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | JO |
| 13.1 | • Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | JO |
| 13.2 | • Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | JO |
| 14 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 |
| 15 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 9 PAE dhe 7 PAK (56% / 44%) Bazuar në ngarkesën mësimore rezultojnë: 69% PAE /31% PAK |
| 16 | Numri i studentëve (për tre vitet e fundit): | 124 Studentë |
| 17 | Komente / të tjera: | - |



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti EPOKA ka filluar aktivitetin akademik në vitin 2009 -2010, pas liçensimit të tij me VKM Nr.281, datë 12.03.2008. Me Urdhrin Nr. 260, datë 07.06.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës është realizuar akreditimi i parë për institucionin e organizuar si më poshtë:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë

- Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit
- Departamenti i Arkitekturës
- **Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike**

2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative

- Departamenti i Ekonomiksit
- Departamenti i Financë-Bankës
- Departamenti i Administrim Biznesit

3. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale

- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
- Departamenti i Drejtësisë
- Qendra për Studime Europiane

Programi është në varësi të Departamentit të Shkencave kompjuterike

IAL ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me agjencinë Britanike të sigurimit të cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Vendimin Nr.92, datë 20.10.2017 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike. Universiteti "EPOKA" është në proces riakreditimi institucional.

Programi i studimit Bsc në "Inxhinieri Elektronike dhe komunikimi dixhital" është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr.269 datë 28.06.2012, me emërtimin: Bsc në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacion". Me Urdhrin Nr. 232, datë 06.06.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës është bërë riorganizimi i këtij programi, duke ndryshuar emërtimin në Bsc në "Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital".

Akreditimi i parë i këtij programi studimit është finalizuar me Urdhrin Nr.359, datë 25.09.2015, të Ministrit të Arsimit dhe Sporteve. Afati i vlefshmërisë së akreditimit është 6 vite. Aktualisht programi i studimit ka hyrë në procesin e ri-akreditimit. Regjistrimi i formës së diplomës është bërë me Urdhër MAS Nr. 103, datë 09.03.2016.

Kohëzgjatja e tij normale është 3 vite dhe numri krediteve të tij është 180 ECTS. Programi zhvillon mësimdhënien në gjuhën angleze.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të procedurave për ri-akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital", të ofruar nga Universiteti EPOKA.

Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV) të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Analiza e Përbushjes së Rekomandimeve të dhëna nga Bordi i Akreditimit në Vendimin Nr. 51, datë 29.06.2015 të Akreditimit të mëparshëm të programit të studimit dhe gjykimit për përbushjen e rekomandimeve:

REKOMANDIMET:

- a) Institucioni të marrë masa për përmirësimin e nivelit të gjuhës angleze për një pjesë të studentëve që hasin vështirësi, përmes organizimit të kurseve të posaçme të gjuhës të nivelit të avancuar akademik;
- b) Institucioni të marrë masa për rritjen e cilësisë në hyrje të pranimeve në këtë program;

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), duke u mbështetur në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV) Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB), vizitën në institucion si dhe plan-programin e programit të studimit shpreh mendimin se institucioni i ka përbushur rekomandimet e Bordit të Akreditimit si më poshtë:

- **Rekomandimi i parë:** Institucioni të marrë masa për përmirësimin e nivelit të gjuhës angleze për një pjesë të studentëve që hasin vështirësi, përmes organizimit të kurseve të posaçme të gjuhës të nivelit të avancuar akademik:

GVJ: Në planin mësimor [<http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program>], që në semestrin parë të vitit të parë është parashikuar një lëndë për përvetësimin e gjuhës angleze teknike, “*ENG 103 - Development of Reading and Writing Skills in English I*”. Kjo lëndë pasohet në semestrin e dytë të vitit të parë nga lënda “*ENG 104 - Development of Reading and Writing Skills in English II*” me qëllim rritjen e nivelit të përvetësimit të njohurive në gjuhën angleze. Bazuar në plan-programin e këtyre dy lëndëve, si dhe në kriteret hyrëse/pranuese të studentëve në këtë program studimi (njohja paraprake e gjuhës angleze të paktën në nivel B1), e konsiderojmë **të përbushur** këtë rekomandim.

- **Rekomandimi i dytë:** Institucioni të marrë masa për rritjen e cilësisë në hyrje të pranimeve në këtë program

GVJ: Bazuar në kriteret e pranimit të studentëve në Universitetin Epoka në përgjithësi, dhe në veçanti në kriteret e pranimit në këtë program studimi, takimi me studentëve gjatë vizitës së GVJ në institucion, vizita në sekretarinë mësimore [Shenimet në vizitë Bsc Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Digital - EPOKA], vihet re se cilësia e studentëve të pranuar në këtë program studimi është e lartë. Përkatesisht në vitin e fundit akademik, mesatarja e notave e shkollës së mesme për studentët e pranuar ka qenë 9.5 kundrejt kriterit minimal 6.5 të vendosur me vendim të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe atij maksimal prej 10 të vlerësimit. Cilësia e studentëve në hyrje vërehet edhe me notat e tyre në vijim të formimit të tyre universitar ku bazuar edhe në politikën motivuese (bursa) [Admission Office Report], studentët vazhdojnë të mbajnë nota të larta vlerësuese.

Bazuar në vlerësimin e mësipërm e konsiderojmë **të përbushur** këtë rekomandim.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përbërja e GVJ

Prof. Asoc. Elson Agastra

Dr. Miranda Harizaj

Ky raport është përgatitur nga grupi i ekspertëve të jashtëm të përcaktuar me Urdhrin e ASCAL Nr. 8, Datë 22.01.2021 “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programit të studimit të ciklit të parë, aplikuar nga Universiteti “Epoka”, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ku janë përcaktuar kodi i cilësisë dhe standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të ciklit të parë të studimeve.

Ekspertët fillimisht vlerësuan dokumentacionin e vetëvlerësimit të dorëzuar nga Universiteti “Epoka”, në kuadër të procedurës së aplikimit për akreditim të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital”, e përbërë nga 204 dokumenta në total.

Ekspertët sipas një axhende të hartuar në funksion të procesit të vlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital” kanë realizuar vizitën në datën 8 Prill 2021 në Universitetin “Epoka”, sipas veprimtarive të parashikuara në agjendë, në funksion dhe plotësim të procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët.

Grupi i ekspertëve ka vijuar punën për hartimin e një raporti të integruar të vlerësimit të jashtëm të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital” bazuar në gjetjet dhe konstatimet e zbatimit të kriterëve të standarteve shtetërore të cilësisë nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Epoka”.

Koordinator teknik i procedurës nga ASCAL është ME. Renata Qatipi

Më datë 09.06.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 46/19 Prot., datë 09.06.2021 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, “Universiteti EPOKA” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

“Universiteti EPOKA” përcjell përgjigjen për Draft-Raportin përmes sistemit AMS dhe zyrtarisht me shkresë Nr. 55/11 Prot., datë 25.06.2021 “Komente në lidhje me Draft-RVJ të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Elektronike dhe komunikimi dixhital”. Në këtë dokument institucioni ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. Gjithashtu UEPOKA ka sjellë të dhëna tabelore më të sakta me datë 07.07.2021.

GVJ, pasi u njoh me komentet, mori në shqyrtim edhe të dhënat e sjella më datë 07.07.2021, sqaron si më poshtë:

GVJ në Draft RVJ:

- 1- Tabelat e planeve mësimore, të paraqitura në tabelat 10.1-10.4 në RVB, nuk janë plotësuar në mënyrë uniforme, në disa raste kanë informacion të pasaktë dhe të paqartë për vitet akademike 2016-2017, 2018-2019 dhe 2020-2021, si dhe për provimin final që është me zgjedhje nga studentët, apo tek kreditet përmbledhëse semestrale të llogaritura në planet mësimore;
- 2- Për vitet akademike 2016-2017; 2018-2019 dhe 2020-2021 për vitin e tretë nuk ka informacione të mjaftueshme për lëndët me zgjedhje;
- 3- Ngarkesa e orëve mësimore në auditor dhe e orëve për studim individual të studentit nuk përputhet me standartin e totalit prej 180 ECTS/4500 orë.

Përgjigja e GVB:

- a) Tabelat në fjalë janë korrigjuar nga GVB dhe bashkëngjitur gjenden tabelat me të dhënat e përditësuara.
- b) Në faqen zyrtare të Universitetit "EPOKA" (përkatësisht në linkun: <http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program>), por edhe në dosjen e vetëvlerësimit, GVB ka bashkëngjitur të gjithë informacionin e nevojshëm përshumicën e lëndëve me zgjedhje të ofruara gjatë tre viteve akademike në fjalë të programit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital. Në të njëjtën kohë, bashkëngjitur këtij dokumenti gjenden silabuset e lëndëve të tjera me zgjedhje për vitin e tretë akademik.
- c) Siç mund të konstatohet edhe në tabelat e përditësuara të pikës 1, ngarkesa e orëve mësimore në auditor dhe e orëve për studim individual përputhet me standardin e totalit prej 180 ECTS/4500 orë.

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, në standartet II.4, Kriteri 3 dhe V.5, Kriteri 3, gjetjet paraprake të vëna në dukje nga GVJ janë qartësuar me dokumentacionet shtesë të dorëzuara nga institucioni. RVJ u përditësua me të dhënat e reja të paraqitura nga institucioni.

Komenti merret parasysh dhe RVJ ndryshon.

GVJ në Draft RVJ:

- 4- GVJ konstaton referuar të dhënave të përmbledhura të paraqitur në tabelën 10 në RVB, se studentët nuk kanë marrë njohuritë e mjaftueshme për kreditet në vitet akademike 2015-2016, 2016-2017 dhe 2020-2021.

Përgjigja e GVB:

GVB vëren që GVJ ka arritur në konstatimin në fjalë duke iu referuar të dhënave që përmbanin mangësi në Tabelën 10 për shkak të një lapsusi gjatë hedhjes së të dhënave në RVB. Korrigjimi i të dhënave të plotësuara në Tabelën 10 pasqyron përputhshmërinë e planit mësimor me kriterin përkatës, ku ngarkesa e përgjithshme mësimore e 180 ECTS është 4500 orë.

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, Standartet II.4, Kriteri 3 dhe V.5, Kriteri 3, gjetjet paraprake të vëna në dukje nga GVJ janë qartësuar me dokumentacionet shtesë të dorëzuara nga institucioni. RVJ u përditësua me të dhënat shtesë të sjella nga Institucioni.

Komenti merret parasysh dhe RVJ ndryshon.

GVJ në Draft RVJ:

5. GVJ konstaton se një pjesë e syllabuseve të programit të studimit nuk e kanë literaturën e pesë viteve të fundit.

Përgjigja e GVB:

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Faqe 6

Çdo lëndë e ofruar në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital përdor tekste në version hard copy, të cilat gjenden në bibliotekë dhe janë të aksesueshme nga studentët dhe pedagogët. Për disa nga lëndët në fjalë, është në proces blerja e kopjes fizike të edicioneve të fundit (për shembull përditësimi i 4th edition me 5th edition të një teksti mësimor) dhe sapo të jetë e disponueshme në bibliotekë, do të bëhet ndryshimi edhe në silabuset përkatëse.

Gjithësesi, GVB e vlerëson këtë sugjerim dhe do të rishikojë literaturën e përdorur nga personeli akademik, për lëndët e përmendura. Megjithatë, GVB thekson që literatura në përgjithësi është e përditësuar nisur dhe nga fakti që literatura akademike bashkëkohore në gjuhën angleze përbën një nga pikat e forta të programit të studimit.

Departamenti do të marrë masa që vitin e ardhshëm akademik të gjitha lëndët të përdorin vetëm literaturën e 5 viteve të fundit.

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizita në institucion, në Standartin II.4, Kriteri 6, konstatimi i GVJ që “se një pjesë e syllabuseve të programit të studimit nuk e kanë literaturën e pesë viteve të fundit.” qëndron dhe mbështetet dhe nga komentet e sjella nga GVB.

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.

GVJ në Draft RVJ:

- 6- Të dhënat me ngarkesën totale të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, duke përfshirë edhe ngarkesën në programe të tjera studimi të institucionit për vitin akademik aktual duhej të jepej e plotë në tabelën 4 në shtojcat në RVB. Plotësimi i kësaj table nuk është i saktë, të dhënat e paraqitura nuk përputhen me ato të plotësuara për të njëjtët staf akademik në tabelat 12.1-12.6 po në RVB.

Përgjigja e GVB:

Tabela 4 paraqet ngarkesën mësimore totale të personelit akademik që ofron mësim në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital. Sikundër evidentohet nga tabela në fjalë, stafi akademik angazhohet në mësimdhënie edhe në dy fakultetet e tjera pjesë e Universitetit “EPOKA”, dhe totali i ngarkesës mësimore të tyre është paraqitur tek tabela nr 4. Ndërkohë, tabela 12 paraqet ngarkesën mësimore të personelit akademik duke konsideruar vetëm lëndët që ata ofrojnë në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital.

Në dokumentin bashkëngjitur gjenden tabelat e përditësuara, duke përfshirë edhe ngarkesën mësimore të personelit akademik përgjatë semestrit të pranverës të vitit aktual akademik 2020- 2021.

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, Standarti IV.2, kriteri 4, gjetjet paraprake të vëna në dukje nga GVJ janë qartësuar me dokumentacionet shtesë të dorëzuara nga institucioni. RVJ u përditësua me të dhënat shtesë të sjella nga Institucioni.

Komenti merret parasysh dhe RVJ ndryshon.

GVJ në Draft RVJ:

- 7- Në tabelat nr. 23 në RVB, mungon informacioni për numrin e studentëve të diplomuar në vitin e fundit akademik (2019-2020), ç’ka ka të bëjë me kohën kur është hartuar dosja e

vetëvlerësimi pasi viti akademik është mbyllur fizikisht në sezonin e vjeshtës të vitit kalendarik 2020

Përgjigjia e GVB:

- a) Të dhënat në lidhje me numrin e studentëve të diplomuar për vitin akademik 2019-2020 gjenden në tabelën nr 23 të përditësuar.

| Programi i Studimit | Period of Data 2019- 2020 | | |
|--|---------------------------------------|---|--|
| | Numri Total i studentëve të diplomuar | Numri Total i studentëve të punësuar (në përputhje me diplomën) | Numri Total i studentëve të punësuar (jo në përputhje me diplomën) |
| Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital | 35 | | |

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, Standarti V.4, Kriteri 1 përditësohet duke shtuar edhe këto të dhëna.

Komenti merret parasysh dhe RVJ ndryshon.

Komenti i GVB:

Në draft-raportin e vlerësimit të jashtëm periodik të kryer në kuadër të ri-akreditimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital, në Standartin II.5 *“Personeli akademik dhe ndihmës akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kriteret ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standarteve të mësimdhënies”*, grupi i vlerësimit të jashtëm ka vlerësuar si “përmbushet kryesisht” shkallën e përmbushjes së këtij standarti, por nga ana tjetër nuk ka përcaktuar arsyet e këtij vlerësimi, e për më tepër të gjitha kriteret brenda këtij standarti janë cilësuar si të përmbushura nga GVJ.

GVJ: Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, në kriterin 1 të Standartit II.5, GVJ konstaton se ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv për këtë program studimi është në rritje për vitet akademike 2015-2020 dhe vetëm për vitin akademik 2020-2021 ka pësuar ulje, afër limitit të lejuar. Në mënyrë specifike personeli akademik me kohë të plotë në vitin akademik 2020-2021 mbulon 69% të ngarkesës mësimore;

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

| Standardi I.1 | |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se programet e studimit të ofruan nga kjo IAL nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Misioni i Universitetit EPOKA në të gjitha aktivitetet e tij është <i>të jetë një institucion arsimor dhe kërkimor inovativ dhe me ndikim në shërbim të vlerave themelore njerëzore përmes përgatitjes, zhvillimit dhe dhënies së njohurive të një niveli ndërkombëtar, si dhe duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale. Universiteti EPOKA synon të përgatisë individë të mirëkualifikuar, produktivë dhe të aftë, të orientuar drejt kërkimit, me etikë profesionale dhe të ndjeshëm ndaj shoqërisë, si dhe të përgatitur për sfidat kombëtare dhe ndërkombëtare.</i></p> <p>Një tregues domethënës në plotësimin e misionit të IAL është pjesëmarrja në platformën U-Multirank.</p> <p>[dok DVV Evidenca Annex 4.4b Statuti Uni EPOKA 16 12 2016_shq, Pjesa 1, Kreu 1, Neni 3] [http://pre.umultirank.org/sunburst/uni/2621]</p> |
| Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton nga shqyrtimi i statutit të Universitetit EPOKA që programet e studimit, përfshirë programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) kanë synim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. [dok DVV Evidenca Annex 4.4b Statuti Uni EPOKA 16 12 2016_shq, Pjesa 1, Kreu 1, Neni 3] dhe planit strategjik [dok DVV Evidenca Annex 3.1.1 Framework Strategy and Action Plan 2018-2022]</p> |
| Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit se programet e studimit, përfshirë programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet, misionin dhe fushën e veprimtarisë të Universitetin EPOKA. [dok DVV Evidenca Annex 3.1.1 Framework Strategy and Action Plan 2018-2022, Seksioni 2 “Principles” dhe [dok DVV Evidenca Annex 4.4b Statuti Uni EPOKA 16 12 2016_shq, Pjesa 1, Kreu 1, Neni 3]</p> |
| Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se Universitetin EPOKA ofron programe studimi në tre ciklet e studimit në fushat e shkencave inxhinierike: arkitekturë, inxhinieri civile dhe inxhinieri kompjuteri, shkencave ekonomike dhe administrative, si dhe shkencave humane: të drejtësisë dhe ato sociale. Në statutin dhe planin strategjik të IAL është përcaktuar që vizioni dhe synimi është përgatitja e individëve të</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | <p>kualifikuar, të frytshëm dhe të aftë, të orientuar drejt hulumtimit shkencor, me etikë profesionale dhe të ndjeshme ndaj shoqërisë, të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SKSTI 2020), me Strategjinë e Inovacionit dhe Teknologjisë së Biznesit (BITS), me Strategjinë për Teknologjinë e Informacionit dhe Telekomunikacionit (e miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 216, datë 10.04.2003) dhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.</p> <p>Në website të Universitetit EPOKA citohet se Universiteti Epoka pranon në programet Bachelor dhe të intergruara me ciklin e dytë, studentë shqiptarë dhe të huaj bazuar në kuotat e studentëve dhe kriteret e pranimit të vendosura nga MASH. Ky program studimi, Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) ofrohet në gjuhën angleze.</p> <p>[http://admissions.epoka.edu.al/cat-bachelor-integrated-programs-admissions-1923.html] [dok DVV Evidenca Annex 4.4b Statuti Uni EPOKA 16 12 2016_shq, Pjesa 1, Kreu 1, Neni 3] dhe [dok DVV Evidenca [dok DVV Evidenca Annex 3.1.1 Framework Strategy and Action Plan 2018-2022]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Në përmbushje | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| Standardi I.2 | |
|---|---|
| Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se programi i studimit është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit në të cilën teknologjia e informacionit dhe komunikimi është përcaktuar si një nga fushat dhe prioritetet ku Universiteti Epoka do të ketë fokus dhe do të dedikojë burime, ku përfshihet dhe programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE).</p> <p>[dok DVV Evidenca Annex 3.1.1 Framework Strategy and Action Plan 2018-2022 Seksioni 2.3 Vizioni dhe Seksioni 3 Prioritetet Institucionale dhe të Fakultetit]</p> |
| <p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p> <p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në statutin e IAL dhe në rregulloret e programeve të studimit janë përcaktuar qartë prioritetet akademike në zbatim të misionit strategjik (shih stand I.1, kriteri 4).</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se emërtimi, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me fushat/drejtimit akademike prioritar të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e IAL.</p> |

| | | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|---|
| | [dok DVV Evidenca Annex 4.4b Statuti Uni EPOKA 16 12 2016_shq, Pjesa 1, Kreu 1, Neni 3] [http://epoka.edu.al/home-staff-doc-publications-6-404.html] dhe [dok DVV Evidenca 9 Regulation on undergraduate studies and examinations] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | |
| | | | | X |

| Standardi I.3 | |
|--|---|
| Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të publikuar në website të IAL, GVJ konstaton se janë të përcaktuara qartë objektivat e mësimdhënies, në planin strategjik të departamentit të inxhinierisë së kompjuterave që mbulon dhe programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE). Ky program studimi realizohet në përputhje objektivat për formimin e studentëve me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitohen në përfundim të këtij programi studimi dhe që kërkohen nga tregu i punës.</p> <p>[http://cen.epoka.edu.al/home-education-112-116.html] dhe [http://cen.epoka.edu.al/home-strategic-plan-112-1831.html] [http://cen.epoka.edu.al/home-program-and-job-opportunities-112-178.html]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se nga Institucioni realizohen vlerësime të vazhdueshme mbi tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të programeve të studimit që ofrohen dhe mbështeten në vlerësimin e vazhdueshëm të strategjive të punësimit dhe të dhëna nga komunikimi me aktorët e tregut të punës në fushë, mundësitë e punësimit, zhvillimet e pritshme në fushë dhe të dhëna nga punësimi i studentëve të diplomuar, që mbahen nga Zyra e Karrierës dhe të diplomuarve.</p> <p>Në një studim i realizuar ishte dhe mbi "Rezultatet e të diplomuarve në tregun e punës". Nga Zyra e Karrierës dhe të Diplomuarve mbahen të dhëna mbi punësimin real të të diplomuarve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE), që jepen në mënyrë të detajuar në dokumentin [dok DVV Summary Tables of Annex_SER ECE The data on graduation and employment of students (Table 23)] që në total vlerësohen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 17.1% e të diplomuarve janë të punësuar në sektorin privat; • 23.1% e të diplomuarve janë punësuar në IT ose Zhvillues Softueri; • 28.6% e të diplomuarve vazhdojnë studimet master; • 2.9% e të diplomuarve janë në kërkim të një pune; • 20% nuk ka të dhëna; • 5.7% e të diplomuarve janë duke kryer praktikë; • 2.9% e të diplomuarve kanë marrë një vit pushim. |

| | | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|----------|
| | <p>Ndërkohë nga departamenti i inxhinierisë kompjuterike që mbulon programin e studimit ka ftuar kompani të fushës në auditore me të cilat ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale të studentëve dhe bashkëpunime në projekte, të cilat kanë ndarë të rejat dhe zhvillimet në fushë.</p> <p>[dok DVV Evidenca 1.4_Employment Strategies]; [http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-statistics-2019-1457-2813.html]. [https://drive.google.com/file/d/1XxEh01fT7SX3JzXZDFZrH_0LdZaTFys0/view]. [dok DVV Evidenca Annex 1.5 RAPORTI_VJETOR_2019-2020] dhe [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE, Cooperating Institutions and Organizations (other state institutions, professional organizations, business community, labor market and other social actors important for higher education) at Study Program/s-level and Professional Practice (Table 5)]</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfitim e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se objektivat formuese, struktura, përmbajtja e programeve të studimit, ku përfshihet dhe Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) dhe rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim e dijeve, aftësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut, lehtësojnë dhe bëjnë të mundur punësimin e studentëve.</p> <p>[http://cen.epoka.edu.al/home-education-112-116.html] dhe [dok DVV Evidenca 1.4_Employment Strategies] [dok DVV Evidenca Annex 1.5 RAPORTI_VJETOR_2019-2020] dhe [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE, Cooperating Institutions and Organizations (other state institutions, professional organizations, business community, labor market and other social actors important for higher education) at Study Program/s-level and Professional Practice (Table 5)]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | X |


| | |
|---|---|
| <p>Standardi I.4 Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p> | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| <p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se Universiteti EPOKA ka përvojën mbi 12 vjeçare në fushën akademike, kapacitetet në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse, si dhe burimet e duhura në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Personeli akademik në programin e studimit është i kualifikuar, me një përvojë shumëvjeçare në fushat studimore dhe aplikative të programit të studimit, në vend dhe jashtë tij, gjë që mundëson rritjen e cilësisë së mësimdhënies. [dok DVV Evidenca CV e stafit të angazhuar ndër vite në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)].</p> |

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se njësia kryesore, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë ofron aktualisht këto programe studimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bsc në Inxhinieri Civile • Bsc në Inxhinieri Kompjuterike • Bsc në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital • Bsc në Inxhinieri Software • Msc në Arkitekturë (Programi 5-vjeçar i ciklit të dytë të integruar) <p>Programi Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) ka si fusha të përgjithshme dhe specifike fushat e teknologjisë elektronike dhe të komunikimit. GVJ konstaton se aktiviteti mësimor-kërkimor i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike është në përputhje me një nga fushat akademike e kërkimore të Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, fushën e teknologjisë. GVJ konstaton që nga IAL është realizuar kodifikimi i programeve dhe lëndëve të studimit në përputhje me nenin 86 të ligjit të ligjit nr. (80/2015) “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe direktivat evropiane.</p> <p>[DVV Evidenca univ_org_scheme_EN_nov_201], [dok DVV Annex 1.3 Computer Engineering Department_Epoka University], [http://cen.epoka.edu.al/home-mission-vision-112-115.html], [http://cen.epoka.edu.al/home-strategic-plan-112-1831.html] [http://fae.epoka.edu.al/cat-general-2390.html].</p> |
|--|---|


| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është teknologjia e elektronikës dhe komunikimit dixhital. Këto fusha janë në përputhje me fushat akademike e kërkimore të njësisë bazë. GVJ konstaton që nga IAL ka realizuar kodifikimin e programit dhe lëndëve të studimit në Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE), në përputhje me nenin 86 të ligjit të ligjit (nr. 80/2015) “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe direktivat evropiane.</p> <p>[DVV Evidenca univ_org_scheme_EN_nov_201], [dok DVV Annex 1.3 Computer Engineering Department_Epoka University], [http://cen.epoka.edu.al/home-mission-vision-112-115.html], [http://cen.epoka.edu.al/home-strategic-plan-112-1831.html] dhe [http://fae.epoka.edu.al/cat-general-2390.html].</p> |
|--|---|

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

| | |
|--|-------------------------------|
| Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |




| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, GVJ konstaton se në funksion të hartimit, monitorimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit ka realizuar ndarjen e detyrave mes njësisve të IAL, të paraqitura dhe në organigramën e përditësuar të vitit 2018 të organizimit të Universitetit Epoka, që përcaktohet nga institucioni në aktet rregullore dhe udhëzuese të tij Nga vlerësimi rezulton se departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike menaxhon dhe drejton me efektivitet programin e ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE), që ka një kohëzgjatje 3-vjeçare dhe në total përmban 180 kredite.</p> <p>[dok DVV Evidenca_univ_org_scheme_EN_nov_201], [http://epoka.edu.al/home-staff-doc-publications-6-404.html] dhe [dok DVV Evidenca Directive_Acad_Admin Perfor Assess_Quality Improv.pdf]. [dok DVV Evidenca univ_org_scheme_EN_nov_201], [dok DVV Evidenca Annex 1.3 Computer Engineering Department_Epoka_University], [http://cen.epoka.edu.al/home-mission-vision-112-115.html], [http://cen.epoka.edu.al/home-strategic-plan-112-1831.html] dhe [http://fae.epoka.edu.al/cat-general-2390.html] dhe [dok DVV Evidenca Raportet Vjetore Institucionale 2015-2020].</p> |
| <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Universiteti EPOKA ka bashkëpunime ndër-institucionale me një numër të konsiderueshëm institucionesh shtetërore dhe IAL brenda dhe jashtë vendit, si dhe me kompani dhe komunitet biznesi.</p> <p>[dok DVV Evidenca 1.7 List of Institutional Cooperations.pdf], [dok DVV Evidenca RVB_BA ECE_Tabelat permbledhese_shqip.pdf, Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5)] dhe [dok DVV Evidenca Raportet Vjetore Institucionale 2015-2020].</p> |
| <p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se departamenti i inxhinierisë kompjuterike, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) harton në mënyrë periodike raportet vjetore të tij, të cilat ndahen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Zyrën e kërkimeve dhe Projekteve, ▪ Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare ▪ Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve <p>Të cilat bëhen pjesë e raporteve vjetore të IAL ku paraqitet analiza e bashkëpunimit me aktorët e jashtëm në kuadër të procesit mësimor dhe formues të programeve të studimit.</p> <p>[DVV Evidenca 1.7 List of Institutional Cooperations.pdf],[dok DVV Evidenca RVB_BA ECE_Tabelat permbledhese_shqip.pdf, Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 5)] dhe [dok DVV Evidenca Raportet Vjetore Institucionale 2015-2020].</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Universiteti EPOKA ka nënshkruar marrëveshje dhe bashkëpunon me numër të konsiderueshëm institucionesh, organizatash dhe biznesesh për</p> |




| | | | | |
|---|---|-----------------------------|----------------------------|---|
| <p>për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p> | <p>kryerjen e praktikave profesionale, Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikën profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë. Studentëve u ofrohet mundësia të shprehur kërkesat e tyre për realizimin e praktikës dhe institucioni me punëdhënësit me të cilët nuk ka bashkëpunim zyrtar dhe jo vetëm, nis kërkesën për bashkëpunim nëpërmjet një komunikimi shkresor. Në fund të realizimit të praktikës përgatitet një raport si nga punëdhënësi dhe nga studenti. Nga Universiteti EPOKA kërkohet që nga kompanitë të lëshohet një certifikatë që tregon se studenti ka përfunduar praktikën, si dhe një vlerësim për studentin.</p> <p>[DVV Evidenca 1.7 List of Institutional Cooperations.pdf], [dok DVV Evidenca RVB_BA ECE_Tabelat permbledhese_shqip.pdf (Tabela 5)] dhe [dok DVV Evidenca Annex 6.4.2 Company Satisfaction Survey 2018-2019 Academic Year] [Dok DVV Evidenca 4. Professional Practice_ECE], [dok DVV Evidenca Agreement, EPOKA University & Smartwork for Electronics and Digital Communication Engineering program] dhe [dok DVV Evidenca Agreement_EPOKA University & Facilitation for Computer Engineering program].</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se nga institucioni janë siguruar trajnime profesionale për studentët e diplomuar në koordinim me partnerë kombëtar dhe ndërkombëtar qoftë nga akademia dhe industria. Disa trajnime profesionale të organizuara janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vizitë trajnuese në Shkollën e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Studimeve të Aplikuara (Beograd, Serbi); • Shkolla Verore Ndërkombëtare: Studime të Përparuara mbi Biometrinë për Vërtetim të Sigurt në Alghero, Itali; • Shkolla Verore Ndërkombëtare mbi Arkitekturën e Përparuar të Kompjuterit dhe Përmbledhjen për Sisteme me Performancë të Lartë dhe të Mbërthyer (ACACES) në Fiuggi, Itali; • Kompani lokale të vendosura në Tiranë, Shqipëri etj. <p>Në të njëjtën kohë, në Universitetin EPOKA, për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) ka një mekanizëm tjetër shtesë që janë Klubet e Studentëve në të cilat zhvillohen më tej aftësitë e studentëve, përfshirë dhe të diplomuarve në bashkëpunim me industrinë, në përputhje me nevojat e tyre. Një shembull i mirë është dhe klubi i robotikës i krijuar brenda laboratorit të elektronikës.</p> <p>[DVV Evidenca Agreement, EPOKA University & Smartwork for Electronics and Digital Communication Engineering program] dhe [dok DVV Evidenca Agreement_EPOKA University & Facilitation for Computer Engineering program]. [http://clubs.epoka.edu.al/http://clubs.epoka.edu.al/robotics-club/]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përbushjes së standardit</p> | | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Përmbushet pjesërisht | | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|--|-----------------------|--|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| Standardi II.1 | |
|--|---|
| Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi. | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje 3 vite dhe në total ka 180 kredite. [VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018] [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE, Curriculum distributed according to Formation Activities (A-E) (Table 9)] [dok DVV Evidenca 9. Regulation On Undergraduate Studies and Examinations] |
| Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) synon t'i përgatisë studentët me njohuri bazë teorike dhe aplikative në fushat e teknologjive elektronike dhe komunikimi dixhital, si dhe në disiplina mbështetëse; të formojë specialistë me kompetenca praktike në fushat e telekomunikacionit dhe të elektronikës. GVJ konstaton se programi i ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE), nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara krijon mundësinë e formimin e shprehive të veçanta të një gamë të gjerë profesionale e specialitetesh. Programi i ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) u jep njohuri studentëve në fushat e teknologjive të elektronikës dhe Komunikimi Dixhital, ku një vend të konsiderueshëm në program zë të kuptuarit kritik të teorive dhe primeve akademike të fushës së zbatimit të teknologjive elektronike dhe komunikimi dixhital. [DVV Evidenca Annex 1.3 Computer Engineering Department Epoka University], [dok DVV Evidenca Annex 3.8.1b Directive Graduation work of undergraduate programs], [Plan programi http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program], [dok DVV Evidenca Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)] dhe [dok DVV Evidenca 3-Policy on Continuous Improvement of Study Program]. |
| Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe primeve akademike të fushës. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se ky kriter përmbushet mjaft mirë nga Universiteti EPOKA për programin e ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE). Me këtë program synohet ndër të tjera: përgatitja e studentëve |
| Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se ky kriter përmbushet mjaft mirë nga Universiteti EPOKA për programin e ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE). Me këtë program synohet ndër të tjera: përgatitja e studentëve |

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 2/9, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 16

| | | | | |
|--|---|-----------------------------|------------------------------|----------|
| <p>për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p> | <p>me njohuritë bazë mbështetëse teorike dhe praktike në funksion të teknologjive të elektronikës dhe komunikimi dixhital; njohjen e studentëve me teknologjitë e përdorura së fundmi në fushën e elektronikës moderne-smart dhe komunikimi dixhital smart, njohjen e studentëve me bazat e konceptimit dhe implementimit të infrastrukturës teknologjike mbështetëse. Kjo mbështetet mirë nga laboratorët moderne të IAL dhe me bashkëpunimet dhe projektet ku merr pjesë Universiteti Epoka dhe bashkëpunimin me institucionet homologe, shtetërore apo industrinë në funksion të zhvillimit të praktikave dhe trajnimeve profesionale dhe pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta.</p> <p>[DVV Evidenca Annex 1.3 Computer Engineering Department Epoka University], [dok DVV Evidenca Annex 3.8.1b Directive Graduation work of undergraduate programs], [Plan programi http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program], [dok DVV Evidenca Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)] dhe [dok DVV Evidenca 3-Policy on Continuous Improvement of Study Program], [dok DVV Evidenca Annex 6.4.2 Company Satisfaction Survey 2018-2019 Academic Year] dhe [dok DVV Evidenca 3. Agreement_EPOKA University & Facilitation for Computer Engineering program & Agreement, EPOKA University & Smartwork for Electronics and Digital Communication Engineering program]</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> <p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi mësimor i ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) përmban shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, kategorizimin e lëndëve, elementët e mësimdhënies etj., të cilat rezultojnë të paraqitura në përputhje me akte ligjore e nënligjore. Nga shqyrtimi i programit mësimor Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) rezulton se ky program studimi ka një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të përcaktuara në dhe secila prej tyre ka të përcaktuar ngarkesën përkatëse në kredite duke e respektuar totalin vjetor prej 60 kreditesh në 3 vjet në total 180 kredite. Përqindja sipas propozimit të përmirësuar të vitit akademik 2020-2021 për secilin tip të komponentit mësimor është:</p> <ul style="list-style-type: none"> A. lëndët bazë mbi 18% B. lëndët karakterizuese mbi 53% C. lëndët ndërdisiplinore mbi 16% D. lëndët plotësuese mbi 8.8 % E. detyrimet përmbyllëse 3.3 % <p>ku plotësohet dhe kushti i shumës mbi 70 % të krediteve për komponentët mësimorë A dhe B.</p> <p>[dok DVV Evidenca Annex 3.8.1b Directive Graduation work of undergraduate programs], [Plan programi http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program], [dok DVV Evidenca Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)] dhe [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE]. [VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018] [dok DVV BA ECE proposed curriculum and changes _20_04_2020]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>X</p> |

Standardi II.2**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|-----|-----|---------|---|---|------------|---|---|----|----|---|-----|----|---|----------|----|---|
| <p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Universiteti EPOKA ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.92, datë 20.10. 2017 që e akrediton institucionin për 4 vite akademike. Universiteti EPOKA është në procedurë për vlerësimin institucional periodik.</p> <p>[DVV Evidenca Annex 6.13 Statute_Uni_EPOKA_en] dhe [dok DVV Evidenca nr. 21 univ_org_scheme_AL_oct_2018.]</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) cakton koordinatorin e programit të studimit, i cili ndihmon në përmbushjen me sukses të objektivave të programit të studimit. Koordinator i për këtë program studimi është është F.T. Koordinator i programit kryen detyrat e përcaktuara në nenin 34 të statutit.</p> <p>[DVV Evidenca Statute_Uni_EPOKA_en] dhe [dok DVV Evidenca RVB BA ECE_shqip]</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si njësi kryesore dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike pjesë e Fakultetit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe ka në përbërje 3 njësitë bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamentin e Inxhinieri Kompjuterike 2. Departamentin e Arkitekturës 3. Departamentin e Inxhinierisë Civile <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ofron 6 programe të ndryshme studimi në tre cikle të ndryshme studimi.</p> <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë në vitin aktual akademik 2020-2021 nga 44 staf akademik gjithsej, ka 35 pedagogë me kohë të plotë, dhe 9 pedagogë me kohë të pjesshme.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>-</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>4</td> <td>-</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>15</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>16</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td>35</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table> | Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë | PAE | PAK | Prof.Dr | - | 1 | Prof.As.Dr | 4 | - | Dr | 15 | 4 | Msc | 16 | 4 | Në total | 35 | 9 |
| Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë | PAE | PAK | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Prof.Dr | - | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Prof.As.Dr | 4 | - | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Dr | 15 | 4 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Msc | 16 | 4 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Në total | 35 | 9 | | | | | | | | | | | | | | | | | |

GVJ konstaton që Departamenti i Shkencave Kompjuterike në vitin aktual akademik 2020-2021 nga 23 personel akademik gjithsej, ka 16 pedagogë me kohë të plotë, dhe 7 pedagogë me kohë të pjesshme.

Në stafin **ndihmës akademik** të Departamentit për vitin akademik 2020-2021 janë 6 Bsc.

Njësia bazë, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike paraqiten në tabelat 2.1-2.6 si më poshtë:

| Tituj/grada | 2020- 2021 | | 2019 - 2020 | | 2018 - 2019 | |
|---------------|------------|----------|-------------|-----------|-------------|-----------|
| | PAE | PAK | PAE: | PAK: | PAE: | PAK: |
| Prof.Dr | 0 | 1 | 1 | 1 | 1 | 0 |
| Prof.As.Dr | 1 | 0 | 2 | 1 | 3 | 2 |
| Dr | 6 | 4 | 6 | 6 | 3 | 5 |
| Msc | 9 | 2 | 5 | 3 | 6 | 9 |
| Totali | 16 | 7 | 14 | 11 | 13 | 16 |

| Tituj/grada | 2017 - 2018 | | 2016 - 2017 | | 2015 - 2016 | |
|---------------|-------------|-----------|-------------|-----------|-------------|-----------|
| | PAE | PAK | PAE: | PAK: | PAE: | PAK: |
| Prof.Dr | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 |
| Prof.As.Dr | 1 | 2 | 0 | 1 | 0 | 2 |
| Dr | 5 | 7 | 4 | 4 | 6 | 3 |
| Msc | 4 | 3 | 5 | 7 | 4 | 8 |
| Totali | 11 | 12 | 10 | 13 | 10 | 14 |

Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital, ka të regjistruar në total 124 studentë për vitet akademik 2018-2021 (3 vite), dhe raporti pedagog PAE - student është për vitin 2020-2021 është 1:5.

[dok DVV Evidenca Statute_Uni_EPOKA_en] dhe [dok DVV Summary Tables of Annex_SER ECE Tabelat 1 dhe 21]

[dok DVV Evidenca Statute_Uni_EPOKA_en] dhe [dok DVV Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 1, Tabelat 2.1-2.6 dhe Tabela 21] [dok DVV Summary Tables of Annex_SER ECE Tabelat 6.1-6.6]

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | X |

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë përgjegjëse për programin e ciklit të parë, Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE), Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si rregullorën dhe programin mësimor |

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë



E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Page 19

| | [DVV http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf], [dok DVV Evidenca Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)] dhe [dok DVV Summary Tables of Annex_SER ECE]. | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|--|-----------|------------|---------------|-----------------|-----------------|------|---|----------|------------|---------|-----------|---------------|----------|----------------------|-----------|-----------|---------------|----------|-----------------------------------|---------|-----------|---------------|----------|----------------------------|-----|-----------|--------------|----------|----------------------|--------|----------|--------------|
| Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se veprimtaritë formuese janë shpërndarë në përputhje me VKM nr.41/2018. Veprimtaritë formuese kanë një shpërndarje si në tabelën më poshtë:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kat</th> <th rowspan="2">Pershkrimi</th> <th rowspan="2">Sipas VKM 41</th> <th colspan="2">Te dhenat ne PS</th> </tr> <tr> <th>ECTS</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>Lëndë bazë</td> <td>15%-20%</td> <td>33</td> <td>18.4 %</td> </tr> <tr> <td>B</td> <td>Lëndë karakterizuese</td> <td>50% - 55%</td> <td>96</td> <td>53.3 %</td> </tr> <tr> <td>C</td> <td>Lëndë ndërdisiplinore/ integruese</td> <td>12%-15%</td> <td>29</td> <td>16.1 %</td> </tr> <tr> <td>D</td> <td>Lëndë plotësuese(praktika)</td> <td>10%</td> <td>16</td> <td>8.8 %</td> </tr> <tr> <td>E</td> <td>Detyrime përmbyllëse</td> <td>3%- 5%</td> <td>6</td> <td>3.4 %</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga shqyrtimi i rregullores së programit, planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ konstaton se programi përmban 30 lëndë + Praktikën + Provimin Përfundimtar. Në syllabuset e lëndëve paraqitet qartë ndarja e elementëve të lëndës (leksion, seminar, laborator).</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf], [dok DVV Evidenca SER ECE Curricula Signed and Sealed], [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE] dhe [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program].</p> | Kat | Pershkrimi | Sipas VKM 41 | Te dhenat ne PS | | ECTS | % | A | Lëndë bazë | 15%-20% | 33 | 18.4 % | B | Lëndë karakterizuese | 50% - 55% | 96 | 53.3 % | C | Lëndë ndërdisiplinore/ integruese | 12%-15% | 29 | 16.1 % | D | Lëndë plotësuese(praktika) | 10% | 16 | 8.8 % | E | Detyrime përmbyllëse | 3%- 5% | 6 | 3.4 % |
| Kat | Pershkrimi | | | | Sipas VKM 41 | Te dhenat ne PS | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | ECTS | % | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| A | Lëndë bazë | 15%-20% | 33 | 18.4 % | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| B | Lëndë karakterizuese | 50% - 55% | 96 | 53.3 % | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| C | Lëndë ndërdisiplinore/ integruese | 12%-15% | 29 | 16.1 % | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| D | Lëndë plotësuese(praktika) | 10% | 16 | 8.8 % | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| E | Detyrime përmbyllëse | 3%- 5% | 6 | 3.4 % | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton e paraqitur shpërndarja e krediteve në 6 semestra e tre vite akademike dhe për secilën lëndë apo veprimtari brenda programit të studimit. Ky program rezulton me 30 kredite për semestër, 60 kredite në një vit të plotë akademik dhe 180 kredite në total për 3 vite akademike.</p> <p>[Dok DVV http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf], [dok DVV Evidenca SER ECE Curricula Signed and Sealed], [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE] dhe [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program].</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Syllabusi u prezantohet studentëve në javën e parë të mësimit dhe të gjitha syllabuset publikohen në faqen kryesore web të universitetit. Në të njëjtën kohë syllabuset u shpërndahen studentëve nëpërmjet koordinatorit të programit të studimit apo pedagogëve titullar të lëndëve dhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm(EIS) në IAL.</p> <p>Syllabusi paraqet në mënyrë të qartë ngarkesën e studentit (orë në auditor dhe jashtë auditorit) të ndara sipas aktiviteteve specifike si leksione, seminare, labore, provime, detyra kursi etj. Gjithashtu, bazuar edhe në rregulloren e provimeve, studentët duhet të frekuentojnë të paktën 70% të orëve të leksioneve teorike si dhe të paktën 80% të orëve laboratorike/praktike që të lejohen të marrin pjesë në provimin përfundimtar të lëndës.Ky informacion ndahet me studentët nëpërmjet udhëzuesit të tyre (Smart Guide). Vlerësimi i njohurive të përvetësuara</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

nga studentët bëhet sipas kriterëve specifike të secilës lëndë, që në mënyrë të përmbledhur paraqitet në tabelën e mëposhtme:

| Programi i studimit Bsc Inxhinieri Elektronike dhe komunikimi dixhital | |
|---|---|
| <i>Format e kontrollit të njohurive</i> | <i>(përqindja përkundrejt totalit të vlerësimit të studentit)</i> |
| <i>Pjesëmarrja dhe puna aktive në lëndë</i> | 0-10% |
| <i>Plotësimi i detyrimeve (lab, detyra kursi)</i> | 5-25% |
| <i>Provime gjatë vitit</i> | 0-20% |
| <i>Provimi final</i> | 10-60% |
| <i>Në total</i> | 100% |

Informacione të detajuara dhe specifike për vlerësimin e secilës lëndë jepet në syllabuset përkatëse. Më poshtë jepet një ekstrakt i mënyrës së vlerësimit për një lëndë specifike të këtij programi studimi.

| Metoda e vlerësimit të lëndës | | |
|--------------------------------------|--------------|------------------|
| Metoda | Sasia | Përqindja |
| <i>Detyra shtëpie</i> | 2 | 5% |
| <i>Provimi (e) ndërmjetës</i> | 1 | 35% |
| <i>Kuize</i> | 2 | 5% |
| <i>Provimi final</i> | 1 | 45% |
| | | 100% |

[<http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf>], [dok DVV Evidenca Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)], [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabelat 14 dhe 15] dhe [<http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program>], [dok DVV Evidenca Annex. 7, Regulation “On Undergraduate Studies And Examinations”] [dok DVV Evidenca Annex 9. Smart_Student_Guide_2019-2020].

Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) u siguron studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalencën e studimeve. Të gjitha rregulloret në lidhje me transferimin e studentëve nga një program studimi në një tjetër brenda institucionit, dhe transferimi i studentëve nga një program studimi të një universiteti tjetër në një program studimi të Universitetit “EPOKA” janë të parashikuara në aktet rregullatore të IAL për programet e studimit dhe bëhen publike në faqen e internetit të Universitetit.

[<http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf>], [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 21] dhe [<http://epoka.edu.al/home-staff-doc-publications-6-404.html> - Directive “On Student Transfer”]


Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se syllabuset e lëndëve të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) janë përgatitur sipas një formati standard dhe integrojnë elementët në vijim:

- Emërtimin e lëndës;
- Ngarkesën e lëndës në kredite dhe në orë;
- Semestrin kur zhvillohet lënda;
- Përshkrimin dhe objektivat e lëndës;


| | | | |
|---|--|-----------------------------|--|
| <p>auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p> | <ul style="list-style-type: none"> • Rezultatet dhe kompetencat e mësimi; • Kontributin e lëndës në rezultatin e programit; • Detyrimet e lëndës; • Laboratorët e parashikuar; • Literaturën bazë; • Literaturën ndihmëse; • Mënyrën e vlerësimit, detajuar me detyrimet e studentit, kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e vlerësimit me notë; • Përmbajtjen e temave të kursit. <p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë përgjithësisht të gjithë elementët e nevojshëm për tu pasqyruar në to dhe se ka një përputhje të mirë me profilin e programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se në syllabuset e lëndëve janë paraqitur lektorët e lëndës, por jo titullarët e lëndës, ku titullarët e lëndëve në të gjithë syllabuset duhet të jenë personel akademik i kategorisë “Profesor”.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf], [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 14] dhe [dok DVV Evidenca Syllabuse Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)]</p> | | |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) i nënshtrohet përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm. Procedura e përditësimit të programeve është e përcaktuar në “Politikat për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programit të Studimit”. Procedura e parashikuar me akt rregullator fillon në fund të çdo viti akademik, për të cilën ka dhe një formë specifike të miratuar që duhet ndjekur. Departamenti analizon kërkesat e parashtruara nga personeli akademik dhe në rast kërkese për përmirësim, përgatitet draft propozim për përditësimet e miratuara në Departament, të cilat përcillen në Dekanat, dhe pastaj në Rektorat. Rektorati ia përcjell ndryshimet e propozuara Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave, i cili pasi kryen një shqyrtim të detajuar ia paraqet ndryshimet Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë (KPSC) për miratim. Pas miratimit të KPSC, dokumentet i dërgohen Senatit Akademik për miratimin përfundimtar. Procedura dokumentohet në sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit (EIS). Përmirësimet e realizuara për 6 vite akademike (2015-2021) në programin e studimit kanë qenë në masën më pak se 20 %.</p> <p>[DVV Evidenca 52. Curricula change procedure], [dok DVV Evidenca 52.1 Curriculum Change Proposal Form], [dok DVV Evidenca 136 curricula change format] dhe [dok DVV Evidenca 49- CURRICULA CHANGES ECE BA]</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi II.4
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të




Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|--|-------------------|-------------------|-------------------|--------------------|-------------------|------------------------|--|------------------------|---------|-------------------|---------|-------------------|---------|-------------------|-----------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|
| <p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) është i organizuar në 3 vite akademike, me 180 kredite në total dhe është në përputhje të plotë me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe publikohet në faqen web të IAL.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf], [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabelat 10.1-10.4] dhe [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program]</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se emërtimi i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) është në përputhje me fushën akademike të tij. Shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. Praktikrat në institucione të ndryshme, pjesëmarrjet në projektet e IAL ju mundësojnë studentëve aftësimin dhe në disa raste punësimin e tyre. Zhvillimi i praktikave profesionale parashikohet të realizohet në bashkëpunim me një numër të madh institucioneve e subjektsh të tjera private. Praktikrat, kryesisht në vitin e fundit) shikohen edhe si një mundësi për t'u njohur e për të siguruar lidhje me tregun e punës dhe eventualisht për të hapur mundësinë e punësimit të tyre të ardhshëm.</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf], [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE], [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program] dhe [dok DVV Evidenca 1.7 List of Institutional Cooperations]</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite mundëson përgjithsisht arritjen e objektivave formuese të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësimin profesional. Studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) angazhohen dhe me pagesë në projekte inovative të IAL me bashkëpunëtorë të ndryshëm dhe janë vlerësuar shumë pozitivisht duke nxjerrë në pah kompetencat e fituara në programin e studimit.</p> <p>GVJ konstaton se në Universitetin Epoka, organizimi i aktivitetit didaktik edhe pse është organizuar sipas akteve ligjore në fuqi në bazë viti akademik dhe semestra, lejon studentët që të ndjekin aktivitetin didaktik në bazë lëndësh, ku studentët që kanë lëndë të bartuara apo që janë vlerësuar jokalues lejohen të frekuentojnë deri në 45 kredite ECTS për semestër, gjithmonë me aprovimin e pedagogut tutor dhe të përgjegjësit të njësisë bazë.</p> <p>GVJ konstaton se ngarkesa e programit të studimit është e shpërndarë në tre vite akademike me një shpërndarje thujse uniforme midis orëve në auditor dhe atyre të studimit individual. Ndarja e orëve mësimore (në Auditor dhe orë të studimit individual të studentëve) është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="507 1798 1417 1919"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti akademik</th> <th colspan="2">Viti I (60 ECTS)</th> <th colspan="2">Viti II (60 ECTS)</th> <th colspan="2">Viti III (60 ECTS)</th> <th rowspan="2">Total ore / (180 ECTS)</th> </tr> <tr> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2015-2016</td> <td>752</td> <td>748</td> <td>768</td> <td>732</td> <td>656</td> <td>844</td> <td>4500</td> </tr> </tbody> </table> | Viti akademik | Viti I (60 ECTS) | | Viti II (60 ECTS) | | Viti III (60 ECTS) | | Total ore / (180 ECTS) | Auditor | studim individual | Auditor | studim individual | Auditor | studim individual | 2015-2016 | 752 | 748 | 768 | 732 | 656 | 844 | 4500 |
| Viti akademik | Viti I (60 ECTS) | | Viti II (60 ECTS) | | Viti III (60 ECTS) | | Total ore / (180 ECTS) | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Auditor | studim individual | Auditor | studim individual | Auditor | studim individual | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2015-2016 | 752 | 748 | 768 | 732 | 656 | 844 | 4500 | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | |
|-----------|------|-----|------|-----|------|-----|------|
| 2016-2017 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 |
| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | |
| 2017-2018 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 |
| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | |
| 2018-2019 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 |
| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | |
| 2019-2020 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 |
| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | |
| 2020-2021 | 672 | 828 | 672 | 828 | 576 | 774 | 4500 |
| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | |

Tabelat e planeve mësimore, të paraqitura në tabelat 10.1 – 10.6, të përditësuara nga IAL, paraqesin një ndarje korrekte të lëndëve në vite akademike, kreditet përkatëse dhe orët në auditor dhe për studim individual të studentit. Plotësimi i këtyre tabelave ka pasaktësi të vogla në mbledhjen totale të orëve për disa prej viteve akademike, por që nuk prekin organizimin total të planit mësimor. P.sh. për vitet akademike 2016-2017 dhe deri në vitin akademik 2019-2020, shumatorja totale e orëve në auditor dhe studim individual për vitin e tretë jepet si $576 + 699 = 1275$, kur në të vërtetë, nëse bëhet analiza e secilës lëndë rezultojnë korrektësisht në $624 + 876 = 1500$ orë sikurse e kemi paraqitur në tabelën përmbledhëse më sipër.

Gjithashtu, vërehet një ndarje e orëve në auditor për aktivitetet formuese në rreth 9 – 12 orë/ECTS.

Nëse i referohemi vitit të fundit akademik (2020-2021) vërehet një ulje e orëve në auditor (shih tabelën më sipër) ku ngarkesa në auditor për vitin e parë ka kaluar nga 752 orë në 672 orë, për vitin e dytë nga 768 në 672 orë dhe për vitin e tretë nga 656 në 576 orë. Gjithsesi, është një mesatare nga 9 – 12 orë në auditor/ECTS çka gjykohej e nevojshme për përcimin e dijeve.

GVJ rekomandon që të mos reduktohet më tej ngarkesa në auditor, e nevojshme për përcimin e dijeve.

[DVV: 2021_07_07_Summary Tables of Annex_SER BA ECE], [DVV: Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tebla 10.1-10.6], [DVV: Sqarim në lidhje me Tab 10 dhe 12], [<http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program>], [<http://eis.epoka.edu.al/curricula/62/program>]

Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa e shprehur në kredite, si dhe raporti i teorisë dhe praktikës janë në përputhje me profilin e programit bachelor dhe të përafëruara me programe të ngjashme ndërkombëtare. Studentët e departamentit të inxhinierisë kompjuterike janë pranuar me sukses si studentë të transferuar dhe kanë vazhduar studimet e ciklit master në shkollat inxhinierike ndërkombëtare.

GVJ konstaton se në planin mësimor të paraqitur nga GVB, në vitin akademik 2020-2021 rezultojnë 2032 orë mësimore në auditor, si më poshtë:

- 1264 orë leksione
- 320 orë seminare
- 448 orë ushtrime dhe laboratorë


| | |
|---|--|
| | <p>- Totali 2032 orë mësimore</p> <p>[dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE] dhe [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program Tabela 10.4]</p> |
| <p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë përgjithsisht arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE). Disa studentë të departamentit të inxhinierisë kompjuterike kanë përfunduar programet e mobilitetit në Universitete në Sh.B.A dhe Evropë me një përputhje të programeve të studimit të IAL universitetin e huaj. Një tregues janë dhe 7 transferimet e bëra në këtë program studimi në vitin e II për 4 vite akademike përkatësisht 2016-2020.</p> <p>[DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 21] dhe [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program]</p> |
| <p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se syllabuset e përditësuara ngarkohen në fillim të cdo semestri akademik në Sistemin Informatik Epoka(EIS), si dhe publikohen në faqen web të IAL. Programet e lëndëve bazohen në literaturën e detyruar dhe ndihmëse, të cilat duhet të jenë të 5 viteve të fundit.</p> <p>GVJ konstaton që një pjesë e syllabuseve të programit të studimit nuk e kanë literaturën të 5 viteve të fundit.</p> <p>[dok DVV Evidenca Syllabuset Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital(ECE)] dhe [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program]</p> |
| <p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli bachelor. Në mënyrë specifike synon aftësimin e studentëve me njohuritë bazë inxhinierike si dhe aftësimin e tyre në fushën e teknologjive së elektronikës dhe komunikimi dixhital.</p> <p>[dok DVV Evidenca Syllabuset Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)] dhe [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program]</p> |
| <p>Kriteri 8. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) u jep mundësi të diplomuarve të vijojnë studimet e mëtejshme në programet e ciklit të dytë dhe të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale në fushat e teknologjive elektronike dhe komunikimi dixhital. Programi i studimit duke ndërthurur teorinë me praktikën ka siguruar që aftësitë dhe kompetencat e kërkuara të jenë në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Kjo tregohet edhe në statistikat e dhëna në RVB nga numri i lartë i punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi për vitet e dhëna 2015-2019, ku pjesa më e madhe e tyre janë të punësuar në profilin përkatës.</p> <p>[DVV Evidenca Syllabuset Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)], [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program]; [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 23]</p> |

| | | | | |
|--|---|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| <p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se janë organizuar takime të studentëve me bashkëpunëtorë dhe partnerë të ndryshëm nga tregu i punës duke i orientuar rreth kërkesave dhe pritshmërive të punëdhënësve të interesuar.</p> <p>Departamenti i inxhinierisë kompjuterike për të siguruar përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE), si dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës, konsultohet vazhdimisht dhe merr parasysh propozimet e partnerëve nga tregu i punës, si dhe të diplomuarve kjo e fundit me mbështetjen e Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe Diplomuarve. Një eksperiencë e mirë është vijimi i konsultimit gjatë dhe pas përfundimit të praktikave profesionale të studentëve për të cilën është parashikuar dhe një proces vlerësimi i njohurive dhe aftësive të studentëve nga ana e bashkëpunëtorëve apo partnerëve.</p> <p>[DVV Evidenca 3-Policy on Continuous Improvement of Study Program], [dok DVV Annex 6.4.2 Company Satisfaction Survey 2018-2019 Academic Year] [http://cpao.epoka.edu.al/]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përbushjes së standardit</p> | <p>Suk përbushet</p> | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> |
| | | | <p>X</p> | |

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|--|--------------|-------------|------|-------------|------|-------------|--|-----|-----|------|------|------|------|---------|---|---|---|---|---|---|------------|---|---|---|---|---|---|----|---|---|---|---|---|---|
| <p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) është:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 16 pedagogë nga të cilët 9 PAE dhe 7 PAK (56% /44%) 2. Për vitin akademik 2019 - 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 21 pedagogë nga të cilët 10 PAE dhe 11 PAK (48 % / 52 %): 3. Për vitin akademik 2018 - 2019 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 22 pedagogë nga të cilët 15 PAE dhe 7 PAK (68% / 32 %) 4. Për vitin akademik 2017 - 2018 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 20 pedagogë nga të cilët 11 PAE dhe 9 PAK (55 % / 45 %). 5. Për vitin akademik 2016 - 2017 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 23 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 11 PAK (52% / 48 %). 6. Për vitin akademik 2015 - 2016 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 11 pedagogë nga të cilët 5 PAE dhe 6 PAK (45 % / 55 %). <table border="1" data-bbox="614 1765 1361 1910"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Tituj/gradat</th> <th colspan="2">2020- 2021</th> <th colspan="2">2019 - 2020</th> <th colspan="2">2018 - 2019</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> <th>PAE:</th> <th>PAK:</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>1</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Prof.As.Dr</td> <td>1</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>2</td> <td>3</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Dr</td> <td>4</td> <td>2</td> <td>4</td> <td>6</td> <td>5</td> <td>2</td> </tr> </tbody> </table> | Tituj/gradat | 2020- 2021 | | 2019 - 2020 | | 2018 - 2019 | | PAE | PAK | PAE: | PAK: | PAE: | PAK: | Prof.Dr | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | Prof.As.Dr | 1 | 2 | 2 | 2 | 3 | 2 | Dr | 4 | 2 | 4 | 6 | 5 | 2 |
| Tituj/gradat | 2020- 2021 | | 2019 - 2020 | | 2018 - 2019 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | PAE | PAK | PAE: | PAK: | PAE: | PAK: | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Prof.Dr | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Prof.As.Dr | 1 | 2 | 2 | 2 | 3 | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Dr | 4 | 2 | 4 | 6 | 5 | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |




| | | | | | | |
|--------------------|---|---|----|----|----|---|
| Msc (Dr në proces) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Msc | 4 | 2 | 3 | 3 | 6 | 2 |
| Në total | 9 | 7 | 10 | 11 | 15 | 7 |

| Tituj/grada | 2017 - 2018 | | 2016 - 2017 | | 2015 - 2016 | |
|--------------------|-------------|-----|-------------|------|-------------|------|
| | PAE | PAK | PAE: | PAK: | PAE: | PAK: |
| Prof.Dr | 1 | 0 | 1 | 1 | 0 | 1 |
| Prof.As.Dr | 0 | 2 | 0 | 2 | 0 | 1 |
| Dr | 6 | 5 | 5 | 2 | 3 | 2 |
| Msc (Dr në proces) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Msc | 4 | 2 | 6 | 6 | 2 | 2 |
| Në total | 11 | 9 | 12 | 11 | 5 | 6 |

Ndërkohë pasi analizuar informacionin e dhënë në tabelat 12.1-12.6 të RVB, për ngarkesën mësimore *javore* të personelit akademik PAE dhe PAK rezultoi se raporti i ngarkesës mësimore (orë mësimore) PAE/PAK është si më poshtë:

- 2015-2016 **62 % / 38%**;
- 2016-2017 **72 % / 28%**;
- 2017-2018 **72% / 28%**;
- 2018-2019 **78% / 22%**;
- 2019-2020 **76% / 24%**
- 2020-2021 **69% / 31%**

GVJ konstaton se ngarkesa mësimore e personelit akademik efektiv për këtë program studimi është në rritje për vitet akademike 2015-2020 dhe vetëm për vitin akademik 2020-2021 ka pësuar ulje, afër limitit të lejuar.

Ngarkesa mesatare e personelit akademik efektiv, i departamentit të Inxhinierise kompjuterike, i realizuar në të gjitha programet e studimit, për vitin akademik 2020-2021 është rreth 280 orë në auditor.

Ngarkesa maksimale e regjistruar për këtë vit akademik është rreth 352. orë.

Numri mesatar i lëndëve/moduleve semestrale që mban një pedagog është 3 lëndë, me një numër maksimal lëndësh semestrale 2.

GVJ konstaton se kriteri në lidhje me ngarkesën mësimore dhe numrin e moduleve që mund të mbaj një pedagog plotësohet.

[<http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program>], [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabelat 6.1-6.6 dhe 12.1-12.6]; [VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre", pika 2.b.ii]

Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ pasi analizoi dosjet personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme të angazhuar në programin të studimit, konstaton se kanë kualifikimin e duhur akademik për të menaxhuar modulet e lëndëve të programeve të studimit, me eksperiencë dhe veprimtari të gjatë shkencore.

[<http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program>], [dok DVV CV personeli akademik Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)] dhe [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE]

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| mësimore të programit të studimit. | | | | |
| Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikhën e moduleve të tij. | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik i programit është i specializuar në fusha specifike të cilat mbulojnë më së miri të gjitha lëndët që zhvillohen në këtë program studimi.</p> <p>Një pjesë e stafit janë të huaj, gjë që sjell edhe gërshetimin e metodikave të mësimdhënies dhe një eksperiencë mjaft të mire për studentët të cilët synojnë të vijojnë studimet e tyre në universitete të huaja.</p> <p>[http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program], [dok DVV CV personeli akademik Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)] dhe [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE]</p> | | | |
| Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike angazhon personelin akademik dhe atë ndihmës në përmbushjen e objektivave të programit, ku një objektiv i rëndësishëm është udhëzimi, udhëheqja dhe mbikëqyrja e praktikave profesionale të studentëve që realizohet në bashkëpunim me korrnditorët e kompanive apo institucioneve shtetërore.</p> <p>GVJ konstaton se IAL ka marrëveshje dhe me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të angazhuar jo vetëm për praktikat profesionale, por edhe në disa projekte inovative, si midis institucioneve akademike ashtu edhe kompanive. Këto bashkëpunime krijojnë infrastrukturën dhe mbështetjen e nevojshme për praktikat profesionale dhe zhvillimin e tezave dhe diplomave cilësore.</p> <p>[http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program], [dok DVV Evidenca 1.7 List of Institutional Cooperations]; [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE]</p> | | | |
| Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka siguruar dhe vënë në dispozicion të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE) laboratorë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme sipas natyrës specifike të lëndëve të këtij programi studimi. Zhvillimi i seancave laboratorike mbështetet dhe prej stafit akademik ndihmës, të cilët së bashku me personelin administrativ të IAL kanë përgjegjësi dhe mirëmbajtjen e laboratorëve.</p> <p>[http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program], [dok DVV CV personeli akademik Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)]; [dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE]</p> | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | X | |
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

Faqe 28

Standardi III.1**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**



| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka hartuar rregullore dhe udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të teknologjisë inovative referuar natyrës dhe fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve të programeve të studimit. Universiteti EPOKA përdor metodologji dhe infrastrukturë bashkëkohore të mësimdhënies për të rritur efikasitetin në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Universiteti EPOKA mbështet dhe vlerëson hulumtimet e personelit akademik në mësimdhënie. IAL ka organizuar trajnime dhe udhëzime mbi përdorimin e metodave dhe teknikave të ndryshme (Infrastruktura Hyflex, Vtech, VALEU-X Erasmus+ project etj) në mësimdhënie inovative në mësimdhënie sipas nevojave të njëjësive bazë të IAL.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf], [Dok DVV Evidenca 1.6_Policy on Continuous Improvement of Study Program], [Dok DVV Evidenca Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards], [Dok DVV Evidenca Annex No. 2.1 - EIS GuideLine - Lecturer-Draft], [Dok DVV Evidenca Annex 3.1.1b Epoka University_Academic Training on Digital Education], [Dok DVV Evidenca Annex 3.2.4b Epoka University_Open Forum_Bringing Creativity into 21st Century Classrooms], [Dok DVV Evidenca Annex 3.2.5], [Dok DVV Evidenca Annex 3.2.6] dhe [Dok DVV Evidenca Annex 3.2.6b]</p> |
| Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në statutin e Universitetit EPOKA është përcaktuar që struktura përgjegjëse për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe ndihmës akademik është njësi bazë, Departamenti. Drejtuesi i Departamentit të Inxhinierisë kompjuterike analizon në fund të çdo semestri performancën e të gjithë anëtarëve të personelit akademik. IAL ka përcaktuar në rregulloret dhe udhëzuesit e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë mekanizmat vlerësues si për aktivitetet mësimdhënëse dhe vlerësimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe të institucionit në tërësi. IAL ka një udhëzues specifik për "Vlerësimin e performancës akademike dhe administrative dhe përmirësimin e cilësisë në IAL".</p> <p>GVJ gjatë vizitës në IAL, në takim me përfaqësues të Zyës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, GVJ u informua për procedurat që ndiqen për monitorimin e cilësisë dhe për përmirësimin e tyre. Procesi i vlerësimit të personelit akademik është i automatizuar dhe raportet që gjenerohen i dërgohen Drejtuesit të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, i cili i dërgon për vendimmarrje nëpërmjet Njësisë Kryesore, Rektoratit dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë që jep rekomandimet për përmirësimin e cilësisë. Në një rast është marrë vendimi i ndërprerjes së kontratës së një personeli akademik. Në të njëjtën kohë IAL ka një politikë, udhëzues sipas së cilës vlerësohen dhe rankohen pedagogët sipas një forme vlerësimi nga del lista e rankimit të pedagogëve, ku më të rankuarve ju jepet bonus.</p> <p>[http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html]</p> |

| | |
|---|---|
| | <p>[Dok DVV Evidenca 2. Statute of EPOKA] [Dok DVV Directive_Acad Admin Perfor Assess _ Quality Improv]. [Dok DVV Evidenca Annex 6.7-Quality Policy], [Dok DVV Evidenca EPOKA_Quality Assurance Handbook_19 12 2018_final], [Dok DVV Evidenca 3-Policy on Continuous Improvement of Study Program], [Dok DVV Evidenca Annex No. 2.1 - EIS GuideLine - Lecturer-Draft]; [http://aeqi.epoka.edu.al/cat-internal-audit-2326.html]</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të procesit të mësimdhënies, vlerësimin e kompetencave, si dhe mundësinë e trajtimit të ankimimeve nëpërmjet procesit të vlerësimit me pyetësorët online të performancës së personelit akademik. Në çdo semestër pas zhvillimit të provimit përfundimtar dhe para marrjes së notës studentët plotësojnë një pyetësor online anonim, i cili është i detyrueshëm, për të parë rezultatin e notës në sistem online. Raporti i përgjithshëm i vihet në dispozicion drejtuesit të departamentit dhe secilit pedagog për lëndën e tij, duke ruajtur anonimatin e studentëve. Në rastet e ankimimeve studentët paraqiten në sekretari dhe shohin fletët e provimit. Aktualisht kjo ndodh online dhe studentët kanë mundësi të shohin dhe t'i krahasojnë me përgjigjet e sakta që janë të ngarkuara gjithashtu në platformë. Në rast paqartësie të mëtejshme jepen sqarimet e nevojshme nga pedagogu përkatës.</p> <p>[Dok DVV Evidenca Annex No. 2.2 - EIS GuideLine - Students-Draft], [Dok DVV Evidenca 40 Course Instructor Evaluation Survey Questionnaire], [Dok DVV Evidenca Annex 6.4.1 Student Satisfaction Survey]; [Dok DVV Evidenca Annex 6.10-Exam Assessment Form] dhe [Dok DVV Evidenca Annex 6.11-Examination Period Assessment Form]</p> |
| <p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Institucioni në statutin dhe rregulloren bazë të IAL ka përcaktuar departamentin përkatës si përgjegjës për sigurimin e cilësisë së programeve që mbulon. Në të njëjtën kohë IAL ka të ngritur Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë i cili ka detyrë specifike monitorimin e cilësisë në mësimdhënie, si dhe rekomandon dhe ndjek marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Studentët nëpërmjet sistemit EIS shprehin mendimin e tyre për çdo lëndë duke plotësuar pyetësorin e vlerësimit të lektorit të lëndës online në mënyrë anonime. Ky pyetësor është një nga mjetet kryesore të përdorura për vëzhgimin e cilësisë të mësimdhënies në IAL. Rezultatet e pyetësorëve të përmbledhura jepen në raportet vjetore, që publikohen në faqen zyrtare web të IAL(raportet vjetore për vitet akademike 2009-2020 të IAL).</p> <p>[Dok DVV Evidenca 8. Regulation_On the Organization and Functioning of the PCQA], [Dok DVV Evidenca Annex No. 2.2 - EIS GuideLine - Students-Draft], [Dok DVV Evidenca 40 Course Instructor Evaluation Survey Questionnaire], [Dok DVV Evidenca Annex 6.4.1 Student Satisfaction Survey]; [Dok DVV Evidenca Annex 6.10-Exam Assessment Form], [Dok DVV Evidenca Annex 6.11-Examination Period Assessment Form] dhe [http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html]</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Institucioni ka të ngritura dy struktura për kontrollin e cilësisë: Komisionin e Përhershëm të Sigurimit të</p> |




| | | | | |
|---|---|-----------------------------|----------------------------|---|
| <p>praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.</p> | <p>Cilësisë dhe Grupin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Këto struktura për informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit akademik organizojnë trajnime dhe seminare informuese me stafin akademik të institucionit në lidhje me përbërësit dhe rëndësinë që mbart sigurimi i cilësisë dhe mirëfunksionimi i Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë në mënyrë të veçantë. Universiteti EPOKA është i anagazhuar në projekte ndërkombëtare dhe ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare me të cilat inkurajon dhe stimulon stafin të marrë pjesë në programet e shkëmbimit siç është Erasmus+ KA1 ose KA2, ku një nga benefitet kryesore është përmirësimi i aftësive të personelit akademik në mësimdhënie.</p> <p>[Dok DVV Evidenca univ_org_scheme_AL_oct_2018] [Dok DVV Evidenca EPOKA_Quality Assurance Handbook_19 12 2018_final], [Dok DVV Evidenca Annex No. 2.1 - EIS GuideLine - Lecturer-Draft]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| <p>Standardi III.2 Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p> | |
|---|--|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Institucioni në nivel institucional ka miratuar rregullore dhe udhëzues dhe organizon trajnime të vazhdueshme për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve të parashikuara për cdo lëndë të programeve mësimore, në syllabuset, ku janë të përcaktuara të gjithë elementët. Format e mësimdhënies janë të ndara sipas aktiviteteve specifike si leksione, seminare, laboratore, provime, detyra kursi etj. Gjithashtu, bazuar edhe në rregulloren e provimeve, studentët duhet të frekuentojnë të paktën 70% të orëve të leksioneve teorike si dhe të paktën 80% të orëve laboratorike/praktike që të lejohen të marrin pjesë në provimin përfundimtar të lëndës.</p> <p>GVJ konstaton se në planin mësimor të paraqitur nga GVB, në vitin akademik 2020-2021 rezultojnë 2032 orë mësimore në auditor, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1264 orë leksione - 320 orë seminare - 448 orë ushtrime dhe laboratorë - Totali 2032 orë mësimore <p>[http://aeqi.epoka.edu.al/cat-training-activities-1411.html] [Dok DVV Evidenca SER ECE Curricula Signed and Sealed]; [Dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE]</p> |
| <p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma,</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në programin mësimor dhe syllabuset e lëndëve janë të parashikuara forma e metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies</p> |

| | |
|--|---|
| <p>mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p> | <p>duke ju përshtatur fushës dhe natyrës së lëndëve specifike të programit të studimit, leksion, seminare, laboratore, projekte, praktika profesionale, si dhe aktivitete dhe pjesëmarrjes në projekte kërkimore që përkthehen në tema diplome në të shumtën e rasteve.</p> <p>Të gjitha materialet mësimore gjenden në formën klasike si: libra fizik në bibliotekë, literaturë elektronike si dhe materiale të lëndës të ofruara nga pedagogu nëpërmjet sistemit EIS dhe platformës LMS. Një mënyrë alternative është mësimdhënia online për të cilën personeli akademik është i mirëpërgatitur dhe përdor metoda dhe teknika të ndryshme inovative të përshtatura sipas natyrës dhe programit së lëndëve. Departamenti ka punësuar asistentë lektorë për të ndihmuar studentët dhe është në funksion sistemi i këshillimit ku studentët e viteve më të larta mbështesin studentët e vitit të parë dhe të dytë, në lëndët ku ata hasin vështirësi.</p> <p>[Dok DVV Evidenca SER ECE Curricula Signed and Sealed] dhe [Dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE] Annex 2.2 Teaching Assistants, [Dok DVV Evidenca Annex 3.6.7 Smart Student Guide 2020-2021], [http://lms.epoka.edu.al/] dhe [Dok DVV Evidenca Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards].</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Institucioni ofron kushtet dhe infrastrukturën inovative për procesin e mësimdhënies, si dhe mbështet dhe stimulon personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike si dhe përditësimet e metodave të mësimdhënies që duhet të jenë në përputhje me rezultatet e nxënies, praktikat më të mira në universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe kërkesat e tregut të punës. GVJ konstaton gjatë vizitës se IAL ka vënë në dispozicion të procesit mësimor infrastrukturën inovative në mësimdhënie dhe laboratorë bashkëkohore në përputhje me natyrën dhe kërkesat e lëndëve të programit të studimit, si në rastin e laboratorit të elektronikës dhe komunikimi dixhital.</p> <p>[Dok DVV Evidenca SER ECE Curricula Signed and Sealed] dhe [Dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE] Annex 2.2 Teaching Assistants, [Dok DVV Evidenca Annex 3.6.7 Smart Student Guide 2020-2021], [http://lms.epoka.edu.al/], [Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure] dhe [Dok DVV Evidenca Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards].</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton nga vlerësimi i CV-ve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, në programin e studimit, se ai është kompetent dhe me eksperiencë të gjatë në fushë. Ai përdor metoda të ndryshme duke iu përshtatur natyrës dhe temës së zhvilluar, kjo në përputhje me syllabusit efektiv të lëndës, të ngarkuar në sistemin EIS në fillim të semestrit.</p> <p>[Dok DVV Evidenca CV të Personelit Akademik të angazhuar në Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)], [Dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 2 dhe 12] [Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure] dhe [Dok DVV Evidenca Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards].</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit vlerëson dhe përmirëson format dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë të vazhdueshme, në të cilën mbështetet nga infrastruktura e vënë në dispozicion, trajnime dhe pjesëmarrje në projekte e shkëmbimit të eksperiencës me institucione akademike në vend dhe jashtë. Studentët përfshihen në këtë proces gjatë zhvillimit të lëndës në komunikim dhe konsultim direkt me pedagogun e lëndës në platformat inovative në përdorim në IAL dhe në procesin e vlerësimit të mësimdhënies.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, nga takimi dhe komunikimi me 9 studentët pjesëmarrës, nga viti i II dhe III i programit të studimit mësuam se ishin të kënaqur nga infrastruktura e vënë në dispozicion nga IAL dhe metodat e përdorur në mësimdhënie nga personeli akademik në sistemin online.</p> <p>Nga studentët, GVJ u informua se në rastet kur është e nevojshme për laboratorët, studentët mund të organizohen në grupe deri në 7 studentë për zhvillimin e laboratorit. [Dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 2 dhe 12] [Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure]; [Dok DVV Evidenca Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards].</p> |
| <p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimi.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik mbështetet dhe inkurajohet nga IAL në procesin e përmirësimit të procesit të mësimdhënies nëpërmjet përdorimit të metodave inovative interaktive dhe diskutimeve mbi zhvillimet e fundit në fushat e studimit të lëndës dhe të kërkuara nga tregu i punës. Kalimi në sistemin online të mësimdhënies e ka bërë të domosdoshëm përdorimin e teknikave dhe metodave interaktive me qëllim rritjen e fokusit dhe interesit të studentëve, me anë të aktivizimit e të gjithë studentëve në punët praktike, projektet, përfshirjen në punën në grup dhe projekte dhe kërkim shkencor nën udhëheqjen e personelit akademik të fushës.</p> <p>Përdorimi i infrastrukturës inovative në mësimdhënie të vënë në dispozicion nga IAL dhe demonstrimet në laboratorë e kanë rritur efektivitetin e metodave dhe interaktivitetin në mësimdhënie. Në këtë proces kanë qenë mbështetje dhe projektet inovative ku merr pjesë Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike si Projekti European që fokusohet në implementimin e realitetit virtual në mësimdhënie (VTech).</p> <p>[Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure], [Dok DVV Evidenca Annex No. 2.2 - EIS GuideLine - Students-Draft], [Dok DVV Evidenca Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards] dhe [http://www.vtech-project.eu/].</p> |
| <p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se format dhe metodat inovative në mësimdhënie të përdorura nga personeli akademik, në sistemin online janë të orientuara drejt punëve dhe zbatimit praktik të njohurive të dhëna, në mënyrë që aftësojnë nga ana praktike dhe të inkurajojnë sensin e pavarësisë tek studentët në realizimin e detyrave si: projekte, raste studimore, shembuj praktikë dhe simulime të ndryshme në detyrat laboratorike. Në rast se haset vështirësi studentët mbështeten në distancë apo në auditor nga pedagogu i lëndës dhe asistenti i</p> |



| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | lëndës. Nga ana tjetër interaktiviteti ndikon dhe në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit dhe vlerësimit të ndërsjellë. [Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure dhe [http://www.vtech-project.eu/]. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Niveli i përmbushjes | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në ambientet, se në funksion të procesit mësimor dhe shkencor ka hapësira të mjaftueshme, moderne dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme në funksion procesit mësimor si: auditore, laboratorë, zyra, salla konferencash, bibliotekë, etj. Mjediset e procesit mësimor dhe shkencor janë të pajisura me sistem CCTV, kondicionimi, kompjuter, projektor, tabelë interaktive (smart board), internet, etj. [Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure], [Dok DVV Evidenca Annex 3.6.4 Guideline on the Functioning of the CTV system] dhe [Dok DVV Evidenca Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards] |
| Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton gjatë vizitës në ambientet e dedikuara për procesin mësimor në IAL se ambientet janë të pajisura me infrastrukturë dhe instrumenta inovative për realizimin e procesit të mësimdhënies, të mbështetur me smartborde, projektorë, laboratorë kompjuterik dhe instrumentet eksperimentale për laboratorin e elektronikës dhe komunikimi dixhital, një bibliotekë funksionale dhe moderne, si dhe internet, i aksesueshëm nga të gjithë studentët dhe personeli akademik. [Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure] dhe [Dok DVV Evidenca Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards] |
| Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka siguruar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të gjithë stafin akademik dhe studentët duke përfshirë platformat online të mësimdhënies dhe informimit (EIS dhe LMS), shërbimin online në bibliotekë dhe platformat e literaturave online, internet pa limit dhe me akses kudo në kampus. Gjatë vizitës në IAL, në takimet me personelin akademik dhe studentët u informuam që ata janë të kënaqur nga infrastruktura e vënë në dispozicion nga IAL për realizimin me sukses të programit mësimor. Në shërbim të programit të studimit janë dhe laboratorët të cilët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të këtij programi studimi. |

| | |
|---|--|
| | [DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure] dhe [Dok DVV Evidenca Annex 29. ICTC Office Services] |
| Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se studentëve të programit të studimit u ofrohet shërbimin fizik dhe online në bibliotekë dhe platformat e literaturave online, ku ata mund të gjejnë literaturën e nevojshme, bazë dhe të nevojshme. Studentët gjithashtu kanë akses në materialet e dhëna nga pedagogët e lëndëve akademik në platformën online LMS të ndërtuar nga IAL. [http://lms.epoka.edu.al/], [Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure]; [Dok DVV Evidenca LIST of Books for BA in ECE] |
| Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se biblioteka e vënë në dispozicion nga IAL ka hapësirat e mjaftueshme dhe është e pajisur me literaturë cilësore me një numër të mjaftueshëm botimesh. Për pasurimin e literaturës fizike në fillim të çdo semestri të gjithë pedagogët duhet të përcaktojnë librat që planifikojnë të përdorin në procesin mësimor dhe ti paraqesin ato në departament, në mënyrë që librat të jenë të disponueshëm në bibliotekë për studentët me fillimin e vitit akademik. Universiteti EPOKA është i abonuar në JSTOR që i mundëson stafit dhe studentëve akses online në një gamë mjaft të gjerë të revistave shkencore, si dhe burime të tjera elektronike: Science Direct, IOPscience, SCOPUS, Taylor and Francis, OECD-Library and Cambridge Journals Online, të cilat i mbështesin në realizimin e objektivave, si dhe përgatitjen e nevojshme në të gjithë elementët e programit të studimit si: detyra, punë studimore dhe kërkimore, temat e diplomimit etj. Në të njëjtën kohë studentët mund të aksesojnë në internet apo dhe në postet kompjuterike në librarinë online të IAL me adresën e domain/email të IAL. [Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure], [Dok DVV Evidenca LIST of Books for BA in ECE] [http://www.epoka.edu.al/kerko.html]dhe [http://lib.epoka.edu.al/] |
| Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | |
| Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka vënë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme laboratorike me pajisjet dhe instrumentet e nevojshme në fushat e programit të studimit të cilat në kohën e pandemisë janë realizuar përgjithsisht nëpërmjet demonstrimit live dhe të regjistruar nga pedagogu i lëndës. Nga vizita në institucion rezultoi se Departamenti i Inxhinierisë kompjuterike në funksion të programit të studimit “Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe komunikimi dixhital” ka labororet e mëposhtme. <ul style="list-style-type: none"> • Labororët e informatikës • Laboratori i elektronikës Labororët janë të pajisur me aparatura dhe mjete mësimore bashkëkohore, të mjaftueshme në numër për kryerjen e orëve laboratorike. Në raste kur ka qenë e nevojshme për shpjegime të mëtejshme grupe të vogla studentësh, deri në 7 studentë, të asistuar dhe nga stafi akademik ndihmës kanë shfrytëzuar dhe realizuar detyrat në ambientet laboratorike. |

| | |
|---|--|
| | <p>[Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure]; [Dok DVV Evidenca Annex 29. ICTC Office Services]</p> |
| <p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p> <p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në funksion të mësimdhënies online IAL ka vënë në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve platformën Google Suite (Meet, Classroom, Gmail dhe Drive), ku mundësohet dhënia e mësimi live dhe të regjistruar, komunikim dhe konsultim të drejtpërdrejtë mes pedagogëve dhe studentëve, mundësohet publikimi i leksioneve të regjistruara, materialeve të procesit mësimor, publikimin e detyrave dhe projekteve, mundësojnë komunikimin e drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit të studentëve. Një pjesë e pedagogëve publikojnë materialet e regjistruara të mësimi online nga auditori, për tu aksesuar nga studentët dhe në You Tube. Në të njëjtën kohë platforma Google Suite (Classroom, Gmail dhe Drive) përdoret dhe për komunikimin e brendshëm pedagog-studentë në funksion të procesit mësimor, të dhënies së detyrave dhe provimeve, si dhe vlerësimit të tyre. Në të njëjtën kohë kjo platformë mundëson akses në materialet e procesit mësimor në format elektronik, si në emailin e tyre (emer.mbiemer@epoka.edu.al) dhe në hapësirën vetjake të dedikuar dhe personalizuar – Google Drive. Në të njëjtën kohë për publikimin e materialeve mësimore përdoret edhe platforma LMS (open Source) e përshtatur nga stafi IT i IAL.</p> <p>Personeli akademik për të ndjekur pjesëmarrjen në mësim të studentëve, për të shfaqur notat e detyrave dhe provimeve dhe për të vëzhguar performancën e studentëve përdor sistemin e brendshëm të informacionit (Epoka Interactive System – EIS) – një produkt inhouse i Universitetit Epoka. Në të njëjtën kohë këshilluesit e studentëve përdorin këtë sistem për të monitoruar performancën e studentëve të programit të studimit që mbulojnë.</p> <p>[Dok DVV Evidenca Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure], [Dok DVV Evidenca Annex 29. ICTC Office Services], [http://lms.epoka.edu.al/] [http://eis.epoka.edu.al/login]</p> |
| <p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se studentët që paraqesin kërkesën për përgatitje teze diplome, orientohen nga personeli akademik në përzgjedhjen e temave të diplomave udhëhiqen, konsultohen dhe mbështeten gjatë zhvillimit të punimeve. Nga takimi me personelin akademik dhe studentët, gjatë vizitës në IAL u informuam që studentët e programit të studimit që në të shumtën e rasteve kanë një mesatare të lartë që në hyrje të programit të studimit dhe rezultate të larta gjatë programit të studimit janë përgjithësisht ata që shfaqin interes dhe përzgjedhin diplomën. Pjesëmarrja e studentëve në projektet ku është e angazhuar IAL i aftëson teknikisht studentët dhe ndihmon që pjesët e projekteve kërkimore ku ata marrin pjesë të asistuar nga personeli akademik të përdoren si bazë për përzgjedhjen dhe zhvillimin e punimeve të tyre të diplomës. 7 studentë të këtij programi studimi marrin pjesë në projektin aktual shkencor të IAL “Vlerësimi i riskut të biomaterialit të personalizuar dhe/ose të përgjithshur - Personalised And/or Generalised Integrated Biomaterial Risk Assessment” (PANBioRA)” me temën “Zhvillimi i një metodologjie të besueshme për menaxhimin me të mirë të riskut nga biomaterialet inxhinierike në produktet dhe/ose pajisjet mjekësore të terapive të avancuara” nën Horizon 2020 që përfundon në vitin 2022. 3 prej</p> |



| | <p>studentëve janë punësuar me kohë të pjeshme dhe mbështeten financiarisht nga projekti në punën e tyre. Ndërkohë në këtë drejtim kanë ndihmuar dhe bashkëpunimet student- personel akademik për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në punën individuale shkencore të lektorëve - 2 studentë; • Në nivel fakulteti/program studimi në funksion të bashkëpunimeve ndërkombëtare gjatë 6 viteve të fundit - 2 studentë; • Në klubin e robotikës. <p>[DVV Evidenca Gradation Projects of Students in Collaboration ëith their Supervisors], [Dok DVV Evidenca Annex No. 2.2 - EIS GuideLine - Students-Draft. Annex], [Dok DVV Evidenca 3.8.1c Thesis Guideline],[http://cen.epoka.edu.al/home-robotics-club-2234-2028.html]; [http://cen.epoka.edu.al/home-panbiora-project-2234-2280.html]</p> | | | | | | | | |
|--|---|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| Shkalla e përmbushjes së standardit | <table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programet e studimit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL në zbatim të kërkesave ligjore në shërbim të sigurimit të cilësisë në institucion ka vënë në funksion struktura/njësi në nivel institucional: Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) me nën-njësitë e tij si Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve në funksion të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë të IAL. Organizimi dhe funksionimi i këtyre strukturave është përcaktuar në statutin e IAL dhe rregulloren e funksionimit të KPSC dhe manualit të sigurimit të cilësisë të IAL. Universitetit EPOKA ka hartuar dhe politikën e cilësisë, ku jepen politikat e objektivave kryesore dhe standardet e sistemit të menaxhimit të cilësisë në përdorim në IAL. Dokumentet që rregullojnë Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë publikohen dhe në faqen web të IAL.</p> <p>[DVV Evidenca Annex 4.4b Statuti Uni EPOKA 16 12 2016_shq], [Dok DVV Evidenca 8. Regulation_On the Organization and Functioning of the PCQA], [Dok DVV Evidenca 8-Directive "On the Functioning of the Exam Board], [Dok DVV Evidenca 7-Quality Policy], [Dok DVV Evidenca Annex 6.12-EPOKA_Quality Assurance Handbook_19 12 2018_final] [http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html]</p> |
| <p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se njësia bazë, departamenti i inxhinierisë kompjuterike është përgjegjës së pari për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjen e ndërgjegjësimit të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e mësimdhënies. Ky proces fillon me punësimin e personelit akademik përmes një procedure të plotë e transparente në përputhje përcaktimet ligjore dhe me rregulloren e IAL dhe kriteret specifike të vendosura nga departamenti që përcaktojnë ekspertizën</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>në fushë të kandidatit për personel akademik, si dhe njohjen e mirë të gjuhës angleze. Departamenti është pjesë e komisionit adhoc për përzgjedhjen e personelit akademik. Ndërgjegjësimi nga IAL dhe departamenti përgjegjës është proces që duhet të vijojë përveç personelit dhe me studentët, të cilët informohen në mënyrë të vazhdueshme dhe përfaqësohen në të gjitha strukturat e cilësisë të IAL ose ftohen në aktivitete specifike. Në të njëjtën kohë informohen dhe ndërgjegjësohen nëpërmjet udhëzuesve specifik (Smart Student Guide 2020-2021) që publikohen dhe në faqen web të IAL, si dhe trajnimet të ndryshme të personelit akademik.</p> <p>[DVV Evidenca Annex 3.2.4 Internal Quality Assurance Unit Department_Epoka University_Staff Training Report Menu], [Dok DVV Evidenca Annex 3.6.7 Smart Student Guide 2020-2021], [Dok DVV Evidenca Annex 4.4b Statuti Uni EPOKA 16 12 2016_shq]& [http://aeqi.epoka.edu.al/cat-training-activities-1411.Ht ml]</p> |
| <p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Universiteti Epoka ka mbështetur eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies nga personeli akademik me qëllim rritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe përshtatjen me zhvillimet teknologjike në fushë. Kjo është treguar më mbështetjen nga IAL të departamentit dhe personelit akademik në pjesëmarrjen në konferenca dhe trajnime të ndryshme dhe bashkëpunimin me universitete të huaja në projekte inovative, si projekti VTECH Erasmus+ për të shkëmbyer dhe zhvilluar ide inovative dhe eksperiencat të sukseshme në mësimdhënie.</p> <p>[DVV Evidenca 1.7 List of Institutional Cooperations] & [http://projects.epoka.edu.al/news-virtual-technologies-erasmus-project vtech-2nd-student-training-5651.html]</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se Universiteti EPOKA ka funksionale të tre ciklet e studimit dhe përdor politika dhe metoda motivuese dhe vlerësuese të stafit akademik në lidhje me performancën e tyre në kërkim shkencor dhe angazhimin në projekte. IAL merr pjesë aktive në programet e shkëmbimit të stafit akademik dhe bashkëpunon në projekte të përbashkëta shkencore me Universitete të huaja, në mënyrë që të rriten kualifikimet e personelit akademik në fushat e ekspertizës, si dhe në trajnime të ndryshme. Informacioni mbi kualifikimet dhe trajnimet e personelit akademik të Universitetit Epoka jepen edhe në faqen web të IAL.</p> <p>[DVV Evidenca Annex 3.7.9 Directive “On the promotion of scientific publications], [Dok DVV Evidenca 1.7 List of Institutional Cooperations]; [Dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 19 dhe 20]</p> |
| <p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në IAL departamenti i inxhinierisë kompjuterike dhe njësitë përgjegjëse të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë organizojnë dhe koordinojnë trajnime të vazhdueshme për personelin akademik në përmirësimin e aftësisë mësimdhënëse dhe zbatimit të teknikave inovative në mësimdhënie. Universiteti EPOKA për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies të personelit akademik në kuadër të programit Erasmus+ ka nënshkruar një numër të madh marrëveshjesh me një sërë universitetesh</p> |

| | <p>perëndimore prej të cilave përfitojnë shkëmbime mobiliteti personeli akademik dhe studentët. Informacioni mbi kualifikimet dhe trajnimet e personelit akademik të Universitetit Epoka jepet edhe në faqen web të IAL.</p> <p>[DVV Evidenca 1.7 List of Institutional Cooperations], [Dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 19 dhe 20]; [http://aeqi.epoka.edu.al/cat-training-activities-1411.html]</p> | | | | | | | | |
|---|---|----------------------|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|--|---|
| <p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se departamenti dhe personeli akademik i IAL përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për zhvillimin e programeve të studimeve në përputhje me programin mësimor dhe syllabuset e përditësuara në sistemin EIS. Departamenti cakton lektorin më të përshtatshëm për lëndët, në mënyrë që të ofrojnë mbështetje për kurrikulat e plota. Në të njëjtën kohë angazhimi është maksimal dhe në përmirësimin e mësimdhënies dhe zbatimin e metodave dhe teknologjive të reja në mësimdhënie, në infrastrukturën moderne të ofruar nga IAL.</p> <p>[DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE], [Dok DVV Evidenca Syllabuset e Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)], [Dok DVV Evidenca CV-të e personelit akademik Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)] [http://aeqi.epoka.edu.al/cat-training-activities-1411.html]</p> | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik krahas metodave tradicionale është orientuar drejt zbatimit praktik, nisur nga natyra e programit të studimit nëpërmjet ofrimit e zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë, simulime në laborator dhe në kompjuter të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të dhe punën në grup të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, për të aplikuar dhe testuar njohuritë e marra. Një metodë inovative është dhe përfshirja në projekte inovative të departamentit dhe kërkimin shkencor nën udhëheqjen e personelit akademik.</p> <p>[DVV Evidenca 1.7 List of Institutional Cooperations] dhe [Dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 19 dhe 20]</p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | X |
| Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka hartuar rregullore për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive personale të studentëve. Mënyra e vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale është dhënë në syllabusin e lëndës.

Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.

Më poshtë jepet një ekstrakt i mënyrës së vlerësimit të notës përfundimtare për një lëndë specifike të këtij programi studimi.

| <i>Metoda e vlerësimit të lëndës</i> | | |
|--------------------------------------|--------------|------------------|
| <i>Metoda</i> | <i>Sasia</i> | <i>Përqindja</i> |
| <i>Detyra shtëpie</i> | <i>2</i> | <i>5%</i> |
| <i>Provim (e) ndërmjetës</i> | <i>1</i> | <i>35%</i> |
| <i>Kuize</i> | <i>2</i> | <i>5%</i> |
| <i>Provimi final</i> | <i>1</i> | <i>45%</i> |
| | | <i>100%</i> |

Studentët informohen për mënyrën e testimit dhe të vlerësimit që në javën e parë mësimore, nga titullari i lëndës, si dhe nëpërmjet sistemit EIS, ku ngarkohen syllabuset e përditësuara të lëndëve. Në varësi të natyrës së lëndës, nga çdo pedagog, në përputhje me rëndësinë që ka aspekti aplikativ përcaktohet pesha e secilit element në vlerësimin përfundimtar dhe i bëhen të ditura studentit me anë të syllabusit të lëndës. Në të njëjtën kohë në javën e parë të orientimit jepet ky informacion nga koordinatori i programit të studimit së bashku me udhëzuesin informues Nga IAL publikohet në faqen web programi i plotë mësimor(me syllabuset) i programit të studimit.

[DVV Annex 3.6.7 Smart Student Guide 2020-2021], [Dok DVV Evidenca Syllabuset e Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)], [Dok DVV Evidenca Policy on Continuous Improvement of Study Program] dhe [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program]

Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në EPOKA, GVJ konstaton se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin tradicional të kontrollit të vazhduar të njohurive dhe aftësive profesionale, ku metodat dhe elementët që bëjnë pjesë në vlerësimin e një lënde janë të përcaktuara në syllabusin e lëndës. si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë, simulime në laborator dhe në kompjuter, testimet në sezonin e ndërmjetëm dhe përfundimtar, të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese dhe punën në grup të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, për të aplikuar dhe testuar njohuritë e marra. Një metodë inovative është dhe përfshirja në projekte inovative të departamentit dhe kërkimin shkencor nën udhëheqjen e personelit akademik. [DVV Evidenca Syllabuset e Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)], [Dok DVV Evidenca Policy on Continuous Improvement of Study Program]; [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program]

Shkalla e përmbushjes së standardit

| | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | | | X |

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..



Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve



Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive

Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në EPOKA, GVJ konstaton se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit në IAL mbështetet

| | |
|---|--|
| <p>profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p> | <p>në parimin tradicional të kontrollit të vazhduar të njohurive dhe aftësive profesionale. Nota është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive • Testimet gjatë vitit • Provimi përfundimtar <p>[DVV Evidenca Syllabuset e Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)], [Dok DVV Annex 6.10-Exam Assessment Form] dhe [http://eis.epoka.edu.al/ curricula/3/program].</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në EPOKA, GVJ konstaton se IAL për rritjen e transparencës dhe eliminimin e formave të abuzimit ka vënë në përdorim sistemet e testimit dhe vlerësimit elektronik, që përdoren në bazë semestrale, ku ekspertët e programeve të studimit të caktuar nga njësia kryesore e programit të studimit për të vlerësuar cilësinë e provimeve, plotësojnë formularin e vlerësimit të provimit me përzgjedhje në Sistemin Interaktiv të Epokës (EIS) pas hedhjes së notave të provimeve në sistem. Me rezultatet e përfuara, Bordi i Provimeve përgatit një raport vjetor të cilin e dërgon për mendim tek Komisioni i Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë. Më pas raporti me gjetjet dhe masat dhe rekomandimet përkatëse i paraqitet Senatit Akademik dhe në fund i dërgohet në njësi të përkatëse për ndjekjen e tyre.</p> <p>[DVV Evidenca 8-Directive “On the Functioning of the Exam Board”], [DVV Evidenca 9. Regulation On Undergraduate Studies and Examinations] dhe [Dok DVV Evidenca Annex 3.6.3 Guideline “On Examinations“]</p> |
| <p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në EPOKA, GVJ konstaton se në zbatim të udhëzuesit “Për funksionimin e Bordit të Provimeve”, testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale bëhet nga komisionet e provimeve të përbëra nga të paktën dy anëtarë, njëri prej të cilëve është titullari i lëndës. Testimi bëhet në formën e testimit me shkrim ose me teste në platformat online ose më projekte e detyra të pavaruara ose në grup sipas natyrës së lëndës për të cilën studenti përgatit dhe dorëzon raportin dhe e prezantojnë para titullarit apo pedagogëve të lëndës nëse ka më shumë se 1, në auditor apo në platformat online. E njëjta procedurë ndiqet edhe praktikën profesionale me ndryshimin që prezantojnë përpara një komisioni të përbërë nga dy anëtar të personelit akademik të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike.</p> <p>[DVV Evidenca 8-Directive “On the Functioning of the Exam Board”], [Dok DVV Evidenca 9.Regulation On Undergraduate Studies and Examinations]; [Dok DVV Evidenca Annex 3.6.3 Guideline “On Examinations“]</p> |
| <p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në EPOKA, GVJ konstaton se për realizimin e testimit dhe vlerësimin e të gjitha kompetencave në provimet me shkrim në auditor IAL përdor një infrastrukturë të veçantë të monitoruar nga stafi i duhur i trajnuar. Procedura konsiston në pajisjen e çdo studenti me një kod provimi dhe dokumenti i provimit i studentëve identifikohet me kodin e provimit. Më tej notat hidhen nga titullari i lëndës në sistemin EIS. Në periudhën e pandemisë dhe masave antiCovid në zbatim dhe të përcaktimeve të Komitetit Teknik dhe MASH provimet janë organizuar me</p> |

| | |
|---|--|
| | <p>anë të platformave online nëpërmjet testimit të kombinuar me alternativa dhe me zgjidhje me shkrim sipas natyrës së lëndës.</p> <p>[DVV Evidenca 8-Directive “On the Functioning of the Exam Board”], [Dok DVV Evidenca Annex No. 1 - ICTC Office Services] dhe [Dok DVV Evidenca Annex No. 2.1 - EIS GuideLine - Lecturer-Draft]</p> |
| <p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në EPOKA, GVJ konstaton se në IAL vlerësimi i aftësive dhe kompetencave shoqërohet me komente/feedback, nëse ka nevojë dhe përfshin rekomandime për mungesat dhe nevojat për përmirësim të identifikuar në mënyrë që të ndihmojnë studentët të përmirësojnë në të ardhmen. Kjo metodë vlerësimi është më eficente për lëndët ku vlerësimi i njohurive realizohet me projekte apo detyra.</p> <p>[DVV Evidenca 8-Directive “On the Functioning of the Exam Board”]; [Dok DVV Evidenca Annex No. 1 - ICTC Office Services]</p> |
| <p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në EPOKA, GVJ konstaton se në IAL, njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën dhe nuk e tolerojnë kopjimin në provime dhe detyra. Lektorët vlerësojnë rastet e identifikuar dhe ndërmarrin veprimet për vlerësimin e materialit të paraqitur që mbart elemente kopjimi nëpërmjet platformës open source TURNITIN.</p> <p>Në syllabusin e çdo lënde është bërë e ditur politika antiplagjaturë në IAL me qëllim shmangien e saj nga studentët dhe rastet me elemente të konsideruara plagjaturë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kopjimi e punës së një personi tjetër. ➤ Shkarkim, huamarrja apo blerja nga interneti, e projekteve, punimeve apo detyrave të kursit. ➤ Përdorimi i punës së dikujt tjetër. ➤ Paraqitja e rrejtshme e burimeve që janë përdorur. ➤ Lejimi i një personi tjetër për të bërë punën akademike. <p>[DVV Evidenca Annex 3.6.7 Smart Student Guide 2020-2021], [Dok DVV Evidenca Annex No. 1 - ICTC Office Services] dhe [Dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 17]</p> |
| <p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se bazuar në përcaktimet në rregulloret përkatëse të IAL rezultatet e kontrollit të njohurive dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në afatin e caktuar, sipas natyrës së njohurive dhe aftësive profesionale dhe formës së vlerësimit. Provimet me shkrim në auditor që janë realizuar në vitet akademike 2015-2019 dhe në semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020 për sezonet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare janë vlerësuar në mënyrë anonime duke bërë të mundur një vlerësim objektiv të provimeve të studentëve. Ndërkohë në platformën online testimet një pjesë e tyre realizohen të kombinuara me pyetje me alternativa dhe me shkrim, por në të gjitha rastet pas vlerësimit, studenti ka përgjigjen korrekte për çdo pyetje dhe komentet e pedagogut për vlerësimin e secilës pyetje.</p> <p>[DVV Evidenca Annex 3.6.3 Guideline “On Examinations“]; [DVV Evidenca Annex No. 1 - ICTC Office Services]</p> |






| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|--|
| <p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL bazuar në përcaktimet në rregulloret përkatëse dhe procedurat e vlerësimit bën vlerësimin e studentëve në bazë të sistemit amerikan të notave dhe krediteve ECTS. IAL ka garantuar procedurën e rishikimit të vlerësimit në rregulloren përkatëse të studimeve Bachelor dhe provimeve, ku përcaktohen të gjitha hapat që ndiqet në rastin e një ankimi rezultati provimi nga kërkesa e deri në marrjen e vendimit përfundimtar, njoftimit të rezultatit dhe arshivimin e tij. Studentët që kanë ankime në lidhje me notën e marrë mund të aplikojnë për ankesë për notë sipas rregulloreve të institucionit e përshkruar në rregulloren e studimit dhe guidën e studentit. Në takimin e zhvilluar me studentët e programit të studimit u informuan se në rastet që kanë pasur paqartësi apo nuk ishin të kënaqur me rezultatin kanë ndjekur procedurën e udhëzuar dhe janë sqaruar nga pedagogët e lëndës.</p> <p>[DVV dok Evidenca Regulation on Undergraduate studies and Examinations], [Dok DVV Evidenca Annex 3.6.7 Smart Student Guide 2020-2021] dhe [http://registrar.epoka.edu.al/cat-rules-regulations-490. Html]</p> | | | |
| <p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p> | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se programi Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE), si program studimi i ciklit të parë ka si objektiva kryesore formimin, përditësimin, aplikimin e njohurive praktike, analitike profesionale apo kërkimore, si edhe të zhvillojë aftësitë e nevojshme tek të diplomuarit që ata të jenë të përgatitur për tregun e punës. Ky program studimi siguron përgatitjen e specialistëve në fushën e inxhinierisë elektronike dhe të komunikimi dixhital dhe është mbështetur në programet më të përparuara të kohës. Në të njëjtën kohë ky program studimi synon që tu japë studentëve përvec koncepteve themelore të inxhinierisë elektronike dhe njohjes së veçorive kryesore të komunikimi dixhital, komponentëve hardware dhe softëare të tyre.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf] dhe [DVV dok SER ECE Curricula Signed and Sealed]</p> |
| <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaja).</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se plani mësimor i programit të studimit që zhvillohet në gjuhën angleze garanton përvec zhvillimit të aftësive në fushën TIK që është pjesë e programit të studimit, mbështet zhvillimin e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit, përfshirë dhe gjuhët e huaja. Në këtë program studimi, studentët duhet të zgjedhin dy lëndë joteknike që janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hyrje në Ekonomi; |

| | |
|---|---|
| | <p>2. Aftësi Komunikimi;</p> <p>3. Hyrje në Ligj;</p> <p>4. Gjuhë të huaja si: Gjermanishtja I, Gjermanishtja II, Frëngjishtja, Italisht etj.</p> <p>[DVV Evidenca SER ECE Curricula Signed and Sealed]</p> |
| <p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në zbatim të përcaktimeve në rregulloren e IAL, në fund të çdo semestri analizohen dhe rishikohen kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në syllabuset e lëndëve të programit të studimit. Një vëmendje e vecantë nga departamenti i kushtohet rishikimit të syllabuseve të lëndëve që janë të ndërlidhura dhe mbahet komunikim midis lektorëve.</p> <p>[http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf]; [DVV dok Evidenca SER ECE Curricula Signed and Sealed]</p> |
| <p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se sipas programit të lëndës nga personeli akademik në javën e fundit të programit të lëndës bëhet përsëritjeja e njohurive dhe koncepteve më thelbësore, e cila orienton studentët mbi strukturën e provimit përfundimtar, si një nga elementët kryesorë të vlerësimit të dijeve dhe aftësive të fituara nga ana e studentit. [DVV Evidenca Syllabuset e Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital (ECE)]</p> |
| <p>Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të programit të lëndës, personeli akademik krahas zhvillimit të mësimin të parashikuar në auditor, organizon dhe zhvillon mësim të hapura për studentët, sic është është dhe prezantimi i teknologjisë dhe punës kërkimore në funksion të projektit “Vlerësimi i riskut të biomaterialit të personalizuar dhe/ose të përgjithshuar-Personalised and/or Generalised Integrated Biomaterial Risk Assessment”(PANBioRA)” me temën “Zhvillimi i një metodologjie të besueshme për menaxhimin me të mirë të riskut nga biomaterialet inxhinierike në produktet dhe/ose pajisjet mjekësore të terapive të avancuara” nën Horizon 2020 që përfundon në vitin 2022. 7 studentët nga programi i studimit janë angazhuar si pjesë e projektit. Personeli akademik organizon dhe zhvillon mësim të hapura për studentët, tek dhe me industrinë dhe biznesin mbi zhvillimet e reja të teknologjisë në fushën e studimit, ku ftohen dhe marrin pjesë ekspertë të fushës dhe të ftuar të tjerë për të ndarë eksperiencën e tyre me studentët.</p> <p>[DVV Evidenca Gradation Projects of Students in Collaboration with their Supervisors], [http://cen.epoka.edu.al/home-panbiora-project-2234-2280.html] [Dok DVV Evidenca Student Satisfaction Survey].</p> |
| <p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se procesi mësimor realizohet mbi bazën e kompetencave në mënyrë që tu japë studentëve mundësinë për të zhvilluar kompetencat e tyre në laboratorë dhe praktikë. GVJ vizitoi dhe konstatoi se studentët kanë një laborator të dedikuar elektronike të pajisur me poste pune dhe pajisje specifike profesionale për të zhvilluar laboratorët dhe vënë në punë projektet e tyre.</p> |

| | | [DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE] | | | |
|--|---|--|---|----------------------|-----------------------|
| <p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p> <p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p> | | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve ose çështjeve të caktuara. Kjo pasqyrohet dhe në bashkëpunimet në organizimin e aktiviteteve dhe botimeve shkencore të përbashkëta ndër vite, si dhe bashkëpunimin në projekte të IAL. Personeli akademik ka një klimë komode për diskutimin dhe zhvillimin e ideve inovative, kërkimin shkencor dhe mbështetjen e studentëve. Studentë edhe të programit të studimit janë përfshirë në projekte kërkimore (PANBioRA dhe VTECH) nën mbikëqyrjen e personelit akademik të departamentit në kuadër të projekteve dhe të punimeve shkencore në IAL.</p> <p>[DVV Evidenca Alumni Survey], [Dok DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 19, 20 dhe 22] dhe [Dok DVV Evidenca Student Satisfaction Survey]</p> | | | |
| | <p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p> | | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se institucioni mbështet dhe promovon zhvillimin e ideve inovative, kërkimeve dhe studimeve shkencore të studentëve, duke u ofruar atyre mbështetje financiare. Bazuar në rregulloret e Universitetit "EPOKA", studentët bachelor të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike përveç mbikëqyrjes dhe asistimit nga personeli akademik i përfshirë në projekt janë mbështetur financiarisht si Asistentë të Projektit me kohë të pjeshme gjatë studimeve të tyre për të punuar në projektet Horizon 2020 (PANBioRA aktualisht), ku mbështetja konsiston në pagë për studentin, kontributin e tyre në kërkimin shkencor dhe blerjen e pajisjeve për eksperimentet që do të kryejnë. Një mbështetje tjetër e ofruar për studentët është për trajnime në universitete të tjera partnere jashtë vendit me anë të granteve të projekteve europiane.</p> <p>[DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 22], [Dok DVV Evidenca Gradation Projects of Students in Collaboration with their Supervisors] dhe [Dok DVV Evidenca Student Satisfaction Survey]</p> | | |
| <p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p> | | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se personeli akademik ka bashkëpunuar dhe përshtatur format e mësimdhënies me institucionet partnere për të mundur dhe mbështetur mobilitetin e studentëve. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka bashkëpunuar me universitete të ndryshme evropiane në kuadër të marrëveshjeve të mobilitetit si psh Erasmus, që kanë mundur vizita të personelit akademik në universitetin pritës. Nga këto programe studentët kanë përfituar nga metodat e ndryshme të mësimdhënies në universitet pritëse.</p> <p>[DVV Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tabela 19 dhe 20]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | | X |

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë



E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 45

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ka hartuar një procedurë të veçantë për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës, që është në përputhje me aktet rregullatore dhe standartet e cilësisë. Studentët informohen për procedurën në vitin e 3-të nga kordinatori i programit të studimit, si dhe nëpërmjet sistemit EIS. Në të njëjtën kohë informacioni bëhet publik dhe në faqen web të IAL.</p> <p>[DVV Evidenca Regulation on Undergraduate studies and Examinations], [DVV Evidenca Guideline “On Examinations“], [DVV Evidenca Annex 3.8.1c Thesis Guideline], [http://registrar.epoka.edu.al/cat-graduation-diploma-491.html] dhe [http://cen.epoka.edu.al/home-gs-form-385-593.html]</p> |
| <p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se departamenti i inxhinierisë kompjuterike dhe personeli akademik asistojnë studentët me informacionin, udhëzimet dhe materialet e nevojshme në kuadër të provimit përfundimtar dhe mbrojtjes së diplomës. Në Universitetin Epoka studentit i caktohet një këshilltar akademik që e ndjek dhe miraton regjistrimin e lëndëve në fillim të çdo semestri, këshillon studentin për procedurat gjatë periudhës të studimit deri në provimin përfundimtar apo diplomim. Në të njëjtën kohë informacioni dhe udhëzimet bëhen publike dhe në faqen web të IAL.</p> <p>[DVV Evidenca Regulation on Undergraduate studies and Examinations], [Dok DVV Evidenca Guideline “On Examinations“], [DVV Evidenca Annex 3.8.1c Thesis Guideline]; [http://registrar.epoka.edu.al/cat-graduation-diploma-491.html]</p> |
| <p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se departamenti i inxhinierisë kompjuterike ngrë një komision të posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar. Ky komision merr për bazë në përgatitjen e pyetjeve të provimit përfundimtar testimin e njohurive të marra gjatë dy viteve të fundit akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët dhe bazuar në rëndësinë e tyre. Në të njëjtën kohë departamenti i inxhinierisë kompjuterike dhe personeli akademik udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen për provimin final apo për tezën e diplomës. Gjatë semestrit të dytë lektorët që mbulojnë lëndët e përfshira në provim orientojnë dhe asistojnë studentët me përmbledhje të temave që do të jenë pjesë e testimit në provimin përfundimtar. Studentët që kanë një GPA (mesatare notash) kumulative më të lartë se 3.0 në vend të provimit përfundimtar mund të zgjedhin temë diplomimi.</p> |
| <p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p> | <p>Studenti gjatë përgatitjes së diplomës asistohet dhe nga pedagogë të tjerë apo specialistë në fushën e fokusit të diplomës. Vlen të përmendet që disa nga studentët e këtij programi studimi kanë zgjedhur tema diplome që lidhen me fushën e zhvillimit të projektit PANBioRA.</p> <p>[DVV Evidenca Regulation on Undergraduate studies and Examinations], [DVV Evidenca Guideline “On Examinations“]; [http://cen.epoka.edu.al/home-gs-form-385-593.html]</p> |
| <p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve,</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL mbështet studentët në realizimin e matjeve, analizave apo</p> |

| | |
|--|---|
| <p>analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> | <p>testeve ose në ambientet e IAL, në laboratorët ekzistues apo në raste specifike mund të përfshijë edhe blerjen e mjeteve laboratorike, si në rastin laboratorit të elektronikës. Në të njëjtën kohë IAL bashkëpunon dhe ka nënshkruar marrëveshje me institucione homologe në vend dhe jashtë, si dhe kompani e biznese në kuadër të zhvillimit dhe shkëmbimit të praktikave profesionale. Në të njëjtën kohë disa studentë të programit të studimit po zhvillojnë diplomat dhe kanë përfutur dhe mjete dhe instrumente laboratorike në kuadër të zbatimit të projekteve të IAL si projekti PANBioRA.</p> <p>[DVV Evidenca Regulation on Undergraduate studies and Examinations], [DVV Evidenca Gradation Projects of Students in Collaboration with their Supervisors] dhe [http://cen.epoka.edu.al/home-panbiora-project-2234-2280.html]</p> |
| <p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në departamentin e inxhinierisë kompjuterike udhëheqësi i tezës së diplomës orienton dhe asiston studentin gjatë dhe për përgatitjen e e projekt-diplomës në mënyrë specifike dhe jo vetëm në nxjerrjen e rezultateve dhe përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e projekt-diplomës sipas udhëzimeve të miratuara nga IAL.</p> <p>[Dok DVV Evidenca Regulation on Undergraduate studies and Examinations], [Dok DVV Evidenca Annex 3.8.1c Thesis Guideline] dhe [http://cen.epoka.edu.al/home-gs-form-385-593.html]</p> |
| <p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në zbatim dhe të përcaktimeve të rregullores për studimet Bachelor dhe provimet, në IAL në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës studenti vlerësohet me notë përfundimtare.</p> <p>[Dok DVV Evidenca Regulation on Undergraduate studies and Examinations]</p> |
| <p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> | <p>Bazuar në DVV dhe informacionin e siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se në zbatim të rregulloreve dhe udhëzimeve të IAL, për studentët që kanë përfunduar me sukses studimet dhe plotësuar kërkesat e plota për procedurën e diplomimit, si kërkesa për kredite ECTS, notën minimale CGPA, sekretaria mësimore përfundon procedurën zyrtare të diplomimit të studentit. Zyra e Regjistrimeve përgatit diplomën dhe suplementin e diplomës për studentët e diplomuar në afatet e caktuara kohore, si dhe regjistron këto dokumente në sistemin EIS sipas formateve dhe rregullave të licencuara dhe të miratuara nga MASR. Në të njëjtën kohë, me kërkesë të studentit jepet dhe një kopje e programit të studimit të zhvilluar me përshkrimin e lëndëve që përgatitet nga departamenti i inxhinierisë kompjuterike. Në të njëjtën kohë informacioni bëhet publik dhe në faqen web të IAL.</p> <p>[Dok DVV Evidenca Regulation on Undergraduate studies and Examinations], [Dok DVV Evidenca Annex 3.8.8b BA-suplement-diplome ECE], [Dok DVV Evidenca Annex 3.8.8 Diploma Format_BA ECE] dhe [http://registrar.epoka.edu.al/home-diploma-delivery-491-2059.html]</p> |
| <p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti,</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga GVB dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në IAL, GVJ konstaton se IAL ruan të gjithë dokumentacionin e studentit përgjatë programit të studimit, që arkivohen sipas kërkesave të udhëzuesit së vitit përkatës dhe një kopje</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| informacione për studentin, nëse kërkohen. | arkivohet pas diplomimit të studentëve, në dosjet e tyre personale. Nga IAL në bazë të kërkesës së studentëve lëshohen dhe dokumente specifike për të provuar statusin e tyre studentor pranë institucione të tjera. Në të njëjtën kohë informacioni bëhet publik dhe në faqen web të IAL. [http://registrar.epoka.edu.al/cat-forms-492.html] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi IV.1 | |
|--|---|
| Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | <p>Bazuar në organigramën e Insitucionit të Arsimit të lartë, “Universiteti EPOKA” ka në strukturën e tij zyrën e Burimeve Njerëzore Zyrë që është përgjegjëse për dokumentimin dhe ndjekjen procedurale të të gjithë stafit akademik dhe administrativ të angazhuar në institucion.</p> <p>Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ konstaton se kjo zyrë dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Në shqyrtimin e tre dosjeve rastësore të personelit të angazhuar në programin e studimit, u vu re plotësia dhe rifreskimi i dokumentacionit sipas kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p>Në dosje ishin të përditësuar edhe të dhënat e leje-qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë për staf akademik të huaj të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Dosjet e kontrolluara përmbanin: ID, CV, lejeqëndrimi (për shtetasit e huaj), librezë shëndetësore, format aplikimi, Kontratë mes palëve, certifikata të titujve dhe gradave shkencore me njuhësimet përkatëse të ministrisë përgjegjëse për arsimin në rastin kur janë lëshuar nga institucione të huaja.</p> <p>Nga zyra e burimeve njerëzore vihet re një organizim i mirë i informacionit të brendshëm e cila bazohet në një sistem informatik si për katalogizimin e të dhënave dixhitale ashtu edhe për referenca praktike në ato fizike dhe vendndodhjen e tyre në arkivë.</p> <p>[Annex 2.1 Organization Scheme.pdf].</p> |

| | |
|---|---|
| | [Shenimet në vizitë Bsc Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Digital - EPOKA]. |
| Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Insitucioni ka të hartuar një rregullore të brendëshme për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademi dhe administrativ. Bazuar në këtë rregullore, nevojat për staf paraqiten nga departamentet përkatëse të cilët përcaktojnë edhe kualifikimet apo kriteret që kërkohen nga stafi i ri. Këto akte rregullatorë janë publike në faqen zyrtare ueb të institucionit si dhe në rregulloren përkatëse të cilat referohen për çdo ppozicion pune që hapet në institucion. [Annex 4.3 Regulation_Staff_Recruitment]. |
| Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike. | Bazuar në rregulloren e rekrutimit të stafit në institucionin EPOKA, kriteret dhe nevojat për staf hartohen fillimisht në nivel departamenti dhe më pas i kalojnë hierarkisë institucionale si fakultet e më pas si universitet. Në bazë të miratimit të kërkesës së departamentit, zyra e burimeve njerëzore ndjek të gjithë procedurën administrative dhe logjistike nga marja e kërkesave të departamenteve, shpallaje e vendeve vakante, marja e dokumentacionit nga kandidatët dhe deri në përfundim të procesit të rekrutimit. Zyra e burimeve njerëzore, e cila ka një faqe të personalizuar në domainn e vet universitetit me të gjitha informacionet e nevojshme për cdo punë kërkues, në bazë nevojave shpall njoftime për pozicione vakante në faqen ueb zyrtare të institucionit. Nga konsultimi i faqes ueb të zyrës së burimeve njerëzore: [http://hr.EPOKA.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html] (dt. 14.04.2021) nuk rezultojnë vende vakante, megjithatë, sikurse u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion, edhe në rastet kur nuk ka njoftime aktive, publikohet një informacion për këdo që është i interesuar dhe mendon se plotëson kriteret e kërkuara nga institucioni, mund të aplikojë edhe pa patur vende vakante. Në këtë rast, zyra e burimeve njerëzore, në vartësi të aplikimeve që mund të jenë, informon departamentet që mund të jenë të interesuara për profilin e kandidatëve që mund të kenë aplikuar edhe në mungesë të një vendi efektiv vakant. |
| Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Zyra e burimeve njerzore në IAL “Universiteti EPOKA” ndjek të gjithë procedurën administrative të rekrutimit të stafit të ri. Njoftimet për vende vakante së bashku me kriteret specifike akademike të hartuara nga departamentet, bëhen publike jo vetëm në faqen ueb të zyrës së burimeve njerëzore, por publikohen edhe në faqe ueb kombëtare [www.duapune.com] dhe ndërkombëtare të specializuara për rekrutime stafi akademik me karakter ndërkombëtar [www.akadeus.com]. Nga konsultimi i këtyre faqeve ueb më datë 14.04.2021, nuk rezultonin aktiv njoftime nga institucioni, por kishte njoftime jo më aktuale, apo të mbyllura më parë. Kjo është edhe në koherencë me mungesën e vendeve vakante në faqen ueb të institucionit. Bazuar në aplikimet e mundëshme dhe shqyrtimin e dokumentacioneve të paraqitur nga kandidatët, zyra e burimeve njerëzore kryen një vlerësimin paraprak të tyre. Kandidatët e përzgjedhur ftohen të zhvillojnë një seancë dëgjimore (leksion të hapur) përpara stafit akademik aktual të universitetit. Kjo procedurë shërben për të vlerësuar aftësitë e kandidatit për të përçuar dijet si dhe aftësinë e tij për të komunikuar në gjuhën angleze në nivele të kuptueshme nga studentët. |



| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | E gjithë procedura e vlerësimit kryhet nga Komiteti Shkencor i njësisë bazë që ka shpallur pozicionin vakant. Objektivitetit i vlerësimit të kandidatëve vërehet edhe në skedën e pikëzimit përkatëse të përcaktuar në rregullore [Annex 4.5 Academic Staff Application Form] [Annex 4.3 Regulation_Staff_Recruitment] dhe në skedat përkatëse [Annex 4.6 Academic Staff Recruitment Form]. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | <p>Institucioni i Arsimit të Lartë, “Universiteti EPOKA” zhvillon aktivitetin në kampusin universitar të ndodhur përgjatë Rrugës Tiranë-Rinas, Km. 12. Ambientet e këtij kampusi universitar përfshijë ambiente zyresh për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, ambiente mësimdhënje (salla leksioni dhe seminari), ambiente laboratorike, bibliotekë, menxë dhe ambiente të tjera ndihmëse dhe shplohëse.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, përtej paraqitjes në DVV, vihet re që të gjitha ambientet në funksion jo vetëm të këtij programi studimi, kanë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin efektiv të të gjithë procesit didaktik.</p> <p>Universiteti EPOKA ka venë në dispozicion të studentëve/stafit një bibliotekë me literaturë në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht, të dedikuar për programet e studimit.</p> |
| Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | <p>Gjatë takimeve në institucion, në veçanti me stafin akademik, me përfaqësues të zyrës së sigurimit të cilësisë dhe në takimin me përfaqësues drejtues të institucionit dhe të programit të studimit, u nënvizuan politikat mbështetëse dhe promovuese të zbatuara nga IAL. Politikat promovuese janë të sanksionuara edhe në direktiva të brendshme të institucionit.</p> <p>Kjo vihet re edhe nga publikimet e arritura nga stafi i institucionit i cili paraqitet në nivele të larta të publikimeve në përgjithësi dhe në veçanti të atyre me faktor impakti të cilat gjatë vitit të fundit (2020) kanë patur një rritje gati me 50%.</p> <p>Një nga mënyrat që institucioni përdor për të motivuar stafin është ai financiar i cili bazohet në arritjet e stafit në publikime shkencore dhe pjesëmarrje në projekte. Sa më të larta të jenë rezultatet e arritura aq më i lartë është edhe shpërblimi financiar. Rregullat e brendshme të kësaj procedure janë transparente për të gjithë stafin</p> <p>[Akt-Ekspertimi dhe Veprimi Teknik_Godina A, Akt-Ekspertimi dhe Veprimi Teknik_Godina E, Annex 3.3.2 Summary Table for Infrastructure]. [Annex 3.7.9 directive “on the promotion of scientific publications] [Annex 6.2-Directive_Acad_Admin Perfor Assess_Quality Improv].</p> |
| Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të | <p>Institucioni inkurajon përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Kjo vërehet edhe në impenjimin e institucionit për të mbështetur me infrastrukturën e nevojshme në zhvillimin modern të mësimdhënies (si vendosja e tabelave interaktive në thujtje çdo auditor apo edhe i sistemeve të video-konferencës në</p> |

| <p>reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p> | <p>rastet e pjesëmarrjes në aktivitetin didaktik të personave që ndodhen jashtë institucionit.</p> <p>Në periudhën e vështirësive objektive për të gjitha IAL-të, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia e SARS-Cov-2, Universiteti Epoka ka rritur angazhimin në përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies duke krijuar infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënje online direkt nga auditorët e shkollës. Gjithashtu, së bashku me mësimdhënien klasike, një pjesë e leksioneve të regjistruara nga stafi akademik, bëhen publike dhe në rrjetet sociale (si youtube) të aksesueshme nga studentët por jo vetëm.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të rritjes së cilësisë së brendshme në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, organizohen aktivitete të ndryshme trajnuese.</p> <p>[http://aeqi.EPOKA.edu.al/cat-training-activities-1411.html].</p> | | | | | | | | | |
|--|--|--------------------------|-----------------------------|--------------------------|-----|-----------|-----|-----|-----------|-----|
| <p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p> | <p>Universiteti EPOKA kë të miratuar në rregulloret e brendshme procedurat dhe kriteret për shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis stafit akademik.</p> <p>Të dhënat me ngarkesën totale të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, duke përfshirë edhe ngarkesën në programe të tjera studimi të institucionit për vitin aktual akademik (2020-2021) duhej të jepej e plotë në tabelën 4 në shtojcat në RVB.</p> <p>Plotësimi i kësaj table nuk është i saktë, të dhënat e paraqitura nuk përputhen me ato të plotësuara për të njëjtit staf akademik në tabelat 12 po në RVB.</p> <p>Kjo pasaktësi e përpilimit të raportit nuk paragjykon analizën e GVJ pasi nuk ka një kufizim ligjor mbi ngarkesën maksimale të lejuar për stafin akademik në IAL jopublike [Udhëzim nr. 29, dt. 10.09.2018 i Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Kreu III, pika 5].</p> <p>E përmbledhur nga ngarkesa e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi, pas dergimit të të dhënave të perditësuara nga institucioni paraqesim si më poshtë [përpunim nga tabela 4 e përditësuar në RVB]:</p> <table border="1" data-bbox="689 1234 1257 1384"> <thead> <tr> <th>Statusi PAE/PAK</th> <th>Ngarkesa në orë (min – max)</th> <th>Ngarkesa mesatare në orë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>PAE</td> <td>416 – 672</td> <td>533</td> </tr> <tr> <td>PAK</td> <td>128 – 480</td> <td>277</td> </tr> </tbody> </table> <p>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik i angazhuar në këtë program studimi ka formimin e kërkuar dhe të nevojshëm për lëndët që mbulon. Kjo duket edhe nga analiza e të dhënave në tabelën 6.1-6.6 në RVB dhe formimin e stafit përkatës siç jepet në CV-të e tyre.</p> <p>Megjithatë, ngarkesa e kërkuar ndaj stafit akademik vetëm për këtë program studimi nuk del e qartë nëse i referohemi tabelave 12.1 – 12.6 në RVB [Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (Tabelat 12)], vërehet një ngarkesë totale e stafit të angazhuar në këtë program studimi që nuk përputhet me ngarkesën e programit të studimit për orët në auditor.</p> <p>Duke ju referuar tabelave 10 dhe 12 të përditësuar dhe faktit që në këtë program studimi, lëndët zhvillohen në 16 javë mësimore kemi:</p> | Statusi PAE/PAK | Ngarkesa në orë (min – max) | Ngarkesa mesatare në orë | PAE | 416 – 672 | 533 | PAK | 128 – 480 | 277 |
| Statusi PAE/PAK | Ngarkesa në orë (min – max) | Ngarkesa mesatare në orë | | | | | | | | |
| PAE | 416 – 672 | 533 | | | | | | | | |
| PAK | 128 – 480 | 277 | | | | | | | | |

| Viti akademik | Ngarkesa në orë/ javore PAE + PAK në total për të gjithë stafin (Tab. 12.1 – 12.6) | Ngarkesa në orë për program studimi PAE + PAK në total për të gjithë stafin (16 javë) | Plani mësimor, ngarkesa në auditor në orë (Tab. 10.1-10.6) |
|---------------|--|--|--|
| 2015 – 2016 | 159 | 2544 | 2176 |
| 2016 – 2017 | 220 | 3520 | 2018 |
| 2017 – 2018 | 200 | 3200 | 2018 |
| 2018 – 2019 | 151 | 2416 | 2018 |
| 2019 – 2020 | 181 | 2896 | 2018 |
| 2020 – 2021 | 161 | 2576 | 1920 |

[përpunim nga tab. 10 dhe 12 të përditësuara në RVB]

Nga analiza e të dhënave në RVB, ngarkesa totale në auditor për programin e studimit është rreth 2018 orë. Këto vlera nuk përputhen me ngarkesën e paraqitur në planet mësimore (shih tabelën më sipër të përpunuar) ku ndryshime nga 12 % deri në 25 % vërehen për vite të ndryshme akademike.

Bazuar në sqarimet e paraqitura nga institucioni, mospërputhja vjen për dy motive: së pari, pasi institucioni në vitin akademik 2016-2017 ka përditësuar kurrikulën e këtij programi; së dyti, disa prej lëndëve zhvillohen në 14 javë dhe jo në 16, çka paraqitet në syllabuset e lëndëve.

Për pikën e parë, të ndryshimit të kurrikulës, kjo ka prekur studentët e regjistruar nga viti akademik 2016-2017 e në vijm, ndërsa studentët e regjistruar më herët, kanë vijuar të ndjekin kurrikulën e vjetër. Kjo ka bërë që stafi akademik të ketë orë/lëndë shtesë për mbajtjen pjesërisht aktive të të dy kurrikulave. Prania aktive e dy kurrikulave për studentët paraqitet si ngarkesë në tabelat 12, ndërsa të dhënat e paraqitura në tabela 10 i referohen vetëm një kurrikule, asaj aktive për regjistrimin e studentëve të rinj për atë vit akademik.

GVJ rekomandon që ngarkesa e stafit akademik të zvogëlohet në mënyrë që të garantohet një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore. Në këtë mënyrë mund të rritet angazhimi i stafit në projekte kërkimore ku përfshihen e kërkimeve dhe njohurive do të mund të pasqyrohen edhe në dijet e përçuara tek studentët.

[RVB_BA ECE_Tabelat permbledhese_shqip]

[Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program (Tabela 13)]

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |



Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në DVV si dhe në Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se Universiteti EPOKA siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse.</p> <p>Universiteti EPOKA zhvillon aktivitetin didaktik brenda kampusit universitar të ndodhur përgjatë Rrugës Tiranë-Rinas, km 12. Në këtë kampus ndodhen tre godina. Godina e parë ka kryesisht ambiente administrative, auditorë/salla leksionesh/seminaresh, laboratorë didaktik. Godina e dytë ka kryesisht ambiente leksionesh, mense/bar, bibliotekën dhe ambiente ndihmëse. Godina e tretë është konvikt studentor.</p> <p>Përveç ambienteve të dedikuara për mësimdhënie si salla leksionesh dhe laboratorë dhe biblioteka, vlerësohet shumë pozitive edhe nga studentët prania e ambienteve ndihmëse si bar-restoranti apo ato sportive.</p> <p>[42. Annex.... The Planimetry of E-Building dhe 42.1 Annex.... The Planimetry of A-Building]</p> |
| <p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet si salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse. Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektor dhe PC fiks në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Së fundmi, sallat ishin pajisur edhe me sistem video-konference/kamera për regjistrimin dhe stream-in e leksioneve në kohë reale në platformat e mësimi online si pasojë e zhvillimit të procesit didaktik online të diktuar nga situata e pandemisë Covid-19.</p> <p>Një pjesë e auditorëve ishin të pajisur edhe me tabela interaktive në funksion të një mënyre mësimdhënie inovative dhe më gjithëpërfshirëse. Staf i IT mirëmban dhe asiston stafin akademik në mirëpërdorimin e pajisjeve teknologjike të vëna në dispozicion.</p> |
| <p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> | <p>Bazuar edhe nga vizita në institucion, Universiteti EPOKA ka tre laboratorë që mund të përdoren në funksion të këtij programi studimi.</p> <p>Dy janë laborator elektronik me pajisje matëse dhe testimi të sinjaleve dhe pajisjeve elektronike si FPGA, DSP, miktokontroller etj. Fizikisht këto dy laboratorë ndodheshin brenda të njëjtës salle të ndarë me dollap njëri nga tjetri. Laboratori është i pajisur me të gjithë strumetmat e nevojshëm për një post laboratorik si: Oshiloskop dixhitale, Gjenerator sinjali (Disa janë edhe të frekuencës së lartë deri në 3GHz), analizator spektri deri në 3GHz, bllok ushqimi laboratorik.</p> <p>Nga studentët përdoret edhe një laborator i tretë i vendosur në ambientet e nëndheshme të institucionit ku ishin të instaluar pajisje elektronike të përfutuara nga projekte ku institucioni është i angazhuar.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ofron edhe laboratorë të teknologjisë së informacionit të cilët kanë të instaluar softuer në funksion të programit të studimit. Kompjuterët e këtyre laboratorëve paraqesin karakteristika teknike të afta të përballojnë ngarkesën e kërkuar në simulime dhe aktivitete laboratorike të këtij programi studimi.</p> |

| <p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p> | <p>Institucioni, sikurse përmendet edhe në Kriterin 3 më sipër, ka në dispozicion tre laborator informatike të pajisur me programe profesionale në funksion të aktivitetit didaktik dhe programeve të studimit që ofron.</p> <p>Nga biseda me studentët, këto laboratorë aksesohen prej tyre jo vetëm gjatë orëve të parashikuara për lëndët përkatëse, por mund të aksesohen sa herë e kanë të nevojshme edhe nën kujdesin e studentëve të viteve më të larta.</p> <p>Aktualisht kjo mundësi u është ofruar studentëve edhe në kushtet e zhvillimit të mësimin online, që nëse e kanë të nevojshme, mund të paraqiteshin në institucion dhe në grupe të vogla të aksesonin laboratorët përkatëse si për zhvillime laboratorit ashtu edhe të projekteve të ndryshme.</p> | | | | | | | | |
|---|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|----------|
| <p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p> | <p>Për realizimin e praktikës profesionale institucioni vë në dispozicion jo vetëm mjediset e tij por edhe ato të ofruara nga institucionet me të cilat bashkëpunon.</p> <p>Gjithashtu vihet re një angazhim në rritje të institucionit për të marrë pjesë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ku pjesëmarrja në këto projekte shihet si pozitive në tërësi për rritjen e nivelit të institucionit, stafit dhe studentëve. Në veçanti për studentët shihet si mundësi e mirë për zhvillimin e praktikave profesionale apo kërkimit shkencor në nivele ndërkombëtare. Për cdo praktikë të ndjekur nga studentët hartohen raportet përkatëse si nga studenti, ashtu edhe nga IAL dhe institucioni ku praktika është zhvilluar.</p> <p>[1.7 List of Institutional Cooperations; Agreement, EPOKA University & Smarteork for Electronics and Digital Communication Engineering program;]. [dok. Nga vizita: 4. Professional Practice_ ECE]</p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="545 1012 762 1079">Nuk është përmbushur</th> <th data-bbox="769 1012 970 1079">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="976 1012 1177 1079">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1184 1012 1412 1079">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table> | Nuk është përmbushur | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| Nuk është përmbushur | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |



| <p>Standardi IV.4</p> | |
|--|--|
| <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni si dhe vizitën në institucion, Universiteti EPOKA disponon një bibliotekë me sipërfaqe rreth 400m², të pajisur me një fond të gjerë librash, kryesisht në gjuhën angleze por jo vetëm. Të dhënat e bibliotekës mund të aksesohen online nga i gjithë stafi dhe studentët në adresën ueb http://library.epoka.edu.al/</p> <p>Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme për konsultimin e literaturës fizike me rreth 100 vende (tavolinë/ karrige) për konsultim. Gjithashtu disponon edhe PC për konsultimin e bibliotekës virtuale e cila ofrohet në bashkëpunimi me bazën e të dhënave JSTOR.</p> <p>[Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards]</p> |
| <p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e</p> | <p>Bazuar në syllabuset e lëndëve të parashikuara për këtë program studimi dhe në liuteraturën e kërkuar, ajo gjendet në të paktën në një kopje fizike në bibliotekën e institucionit. Për pjesën më të madher të literaturës, institucioni ka edhe kopjen</p> |

| | | | | |
|---|---|----------------------------|-----------------------------|----------|
| <p>mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> | <p>në format elektronik. Literatura e kërkuar dhe e rekomanduar për këtë program studimi është e gjitha në gjuhën angleze. Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe nuk përbën pengesë për këtë institucioni dhe në veçanti për këtë program studimi pasi ai zhvillohet i gjithi në gjuhën angleze. Gjetja e librave në gjuhën shqipe për këtë program studimi, duke qenë ai dinamik dhe në evolucion shumë të shpejtë në rang botëror, do të sillte literaturë të vjetërsuar për vetë kohën që një literaturë në këtë fushë kërkon që të përkthehet/përshtatet në gjuhën shqipe.</p> <p>[LIST of Books for BA in ECE].</p> | | | |
| <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> | <p>Përveç bibliotekës fizike të pajisur me libra dhe poste akses online dhe poste studimi, institucioni garanton qasje online në koleksionet JSTOR specifike për materiale të lidhura me programet e studimit të ofruara nga Universiteti EPOKA.</p> <p>Menaxhimi i bibliotekës si katalog, sistme prenotimi, hua-marrje e literaturës etj, ofrohet nëpërmjet një sistem menaxhimi dhe informimi të personalizuar [http://lib.EPOKA.edu.al/] nga ku mund të konsultojnë gjendjen e librave, mundësitë e leximit të tyre në ambientet e bibliotekës apo të marrjes së tyre të përkohshme jashtë ambienteve të bibliotekës.</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p> | <p>Biblioteka ofron të gjitha kushtet logjistike për një përdorim efikas të ambienteve. Ambienti është <i>open-space</i> me libra në rafte të organizuara sipas klasifikimit LC (ndarje sipas argumenteve të trajtuar).</p> <p>Ofrohen rreth 100 poste konsultimi me sistem kondicionimi. Ambienti është i pajisur edhe me PC me qasje në internet dhe me mundësi për të përdorur bibliotekën virtuale nga të gjithë studentët dhe stafi.</p> <p>Gjithsesi, biblioteka dhe koleksionet online mund të aksesohen si nga studentët ashtu edhe nga stafi, nga cdo postacion (në institucion apo edhe nga shtëpia) me kredenciale aksesit syrtare të institucionit.</p> <p>[Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs, Logistics and other Services towards].</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p> | <p>Institucioni ka një procedurë të brendshme për planifikimin dhe shtimin e fondit të librave/revistave dhe materialeve të tjera të bibliotekës.</p> <p>Kryesisht procedura për shtimin e zërave të bibliotekës kalon nga nevoja e përdoruesve të bibliotekës të cilët paraqesin formularin e aplikimit tek përgjegjësi i njësisë përkatëse, dhe lista totale më pas aprovohet nga Administratori i Institucionit i cili autorizon shtimin e fondit të bibliotekës. Procedura më pas ndiqet nga zyrat përkatëse për prokurimet.</p> | | | |
| <p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p> | <p>Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë, E Hënë – E Premte, ora 08:30 – 12:30 dhe 13:30 – 19:30 dhe të Shtunën 09:00-13:00.</p> <p>Qasje në bibliotekën fizike është i mundur 6 ditë në javë me orare të afishuara publikisht si në hyrje të bibliotekës ashtu edhe në faqen ueb përkatëse.</p> <p>Këto orare janë të përshtatshme edhe me sistemin e transporti dhe të aksesit në institucion. Biblioteka online është e aksesueshme 24 orë nga cdo post me qasje në internet.</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> | <p>X</p> |

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> | <p>IAL “Universiteti Epoka” bazon menaxhimin e brendshëm informatik në disa platforma të ndara logjikisht në platforma të përshtatura për mësimdhënie si moodle, të përgjithshme komunikimi dhe IT si platforma GSuite (platforma Google), office 365 (Microsoft) dhe një platformë e krijuar dhe mirëmbajtur nga stafi IT i vet institucionit i quajtur EIS = EPOKA Interactive System</p> <p>Menaxhimi i të gjithë informacionit të brendshëm që përfshinë të gjithë anën administrative (zura e burimeve njerëzore, sekretaria mësimore, zyra e projekteve etj.) dhe anën akademik (stafi akademik, studentët etj) bëhet nëpërmjet platformës së sistemit të menaxhimit të informatizuar. Përdorimi i platformës së informatizuar është komplementar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.</p> <p>Përdorimi i sistemit të informatizuar është në ndihmë edhe të sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore dhe të gjithë instancave përkatëse të cilat ruajnë kopje fizike/regjistra. Përdorimi efikas i sistemit të menaxhimit lehtëson punën e sekretarisë pasi edhe vendndodhja e dokumenteve fizik në institucion është një e dhënë e këtij sistemi që ndihmon personelin për reflektimin e dokumenteve zyrtar edhe në dosjen e gjithsecilit student/staf.</p> <p>[Annex No. 1 - ICTC Office Services].</p> |
| <p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> | <p>Një pjesë e veprimtarisë së menaxhimit të informacionit bazohet edhe në platformën <i>Google</i> e cila lejon përdorimin e adresave të postës elektronike për të gjithë stafin dhe studentët nën domain @epoka.edu.al</p> <p>Sistemi EIS i institucionit është hierarkik dhe me privilegje në bazë të rolit që çdo personel akademik/administrativ apo në çfarëdo roli që ka në institucion, ka qasje në sistemin EIS dhe të dhënat e ruajtura në të sipas funksionit fizik që mbulon. Kjo garanton edhe privatësinë e qasjes të dokumentacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi sikurse edhe lirinë akademike dhe të vlerësimit për të gjithë stafin. [Annex No. 2.1 - EIS GuideLine – Lecturer dhe Annex No. 2.2 - EIS GuideLine – Students].</p> |
| <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>I gjithë sistemi informatik, si ai i ndërtuar dhe mirëmbajtur nga vet institucioni, si ato të përdorura nga platforma komerciale si Google apo Microsoft të përdorura nga Universiteti Epoka, kanë qasje nazuar në përdorues/fjalëkalim.</p> <p>Bazuar në privilegjet dhe hierarkinë e përdoruesit, garantohet edhe qasja në informacionet e menaxhuara. Më saktësisht, pedagogët kanë qasje në vetëm të dhënat personale dhe në lëndët që mbulojnë. Përgjegjësi i departamentit ka një qasje më të gjerë si për lëndët ashtu edhe për raportet dhe vlerësimin e stafit nga studentët [Annex No. 2.1 - EIS GuideLine – Lecturer dhe Annex No. 2.2 - EIS GuideLine – Students].</p> <p>Të gjithë përdoruesit kanë qasje në të dhënat personale dhe mund të përditësojnë disa prej tyre si CV, foto etj</p> |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|--|
| <p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p> | <p>Përdorimi i platformës Google Suite e cila përfshin Google meet; platformës Microsoft Office 365 me platformën Microsoft Teams, platform moodle dhe EIS lejojnë komunikimin interaktiv të përdoruesve.</p> <p>Studentët aksesojnë avancimin e tyre akademik, vlerësimet përkatëse, materialet e lëndëve të cilat përditësohen nga stafi akademik dhe aksesohen vetëm nga studentët përkatës në sistem të bazuar në platformën moodle [http://lms.epoka.edu.al/]</p> | | |
| <p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p> | <p>Sistemi interaktiv EIS lejon plotësimin e pyetësorëve apo formularë të nevojshëm për menaxhimin e brendshëm të fluksit të punës dhe aktivitetit administrativ si për studentët ashtu edhe për stafin.</p> <p>Ndër pyetësorët që mund të plotësohen në platformë e informatizuar gjendet vlerësimi i pedagogut nga studentët, vlerësimi i kënaqësisë së studentit ndaj institucionit, etj. Gjithashtu në sistemin e informatizuar janë të dhënat akademike si nota, praktika, herët që një student ka dhënë një provim të caktuar etj.</p> <p>Bazuar në këto të dhëna, sistemi është në gjendje në mënyrë të automatizuar të përpunojë dhe të krijojë raporte përmbledhëse si mbi kalueshmërinë, apo vlerësimin mesatar të studentëve, përdorimi i auditorëve dhe ambienteve laboratorike në bazë orareve apo të tjera.</p> <p>[Annex 3.1.2 Course Instructor Evaluation Survey] [Annex 6.4.1 Student Satisfaction Survey]</p> | | |
| <p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p> | <p>IAL “Universiteti EPOKA” ka të sanksionuar në statut përdorimin e faqes ueb zyrtare për afishimin e informacionit të senatit akademik [Neni 21, i statutit: Announcing, signing and publication of Academic Senate decisions].</p> <p>Faqe web zyrtare e Universitetit Epoka arrihet në adresën [http://www.epoka.edu.al/]. Informacionet e afishuara në këtë faqe janë në dy gjuhë, atë angleze dhe shqipe.</p> <p>Lundrimi në faqen web është i mirë porganizuar sipas logjikës së progameve të studimit të ofruara dhe sipas veprimtarive akademike dhe jo vetë të kryera nga institucioni. Infomracione më të detajuara arrihen në faqet dytësore (domain sekondar) ku gjeden të dhëna për programet specifike të studimit ku në rastin e programit të studimit nën vlerësim, informacioni arrihet në faqen web Në këtë faqe gjendet i gjithë informacioni i nevojshëm për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital.</p> <p>[http://cen.epoka.edu.al/home-bachelor-in-electronics-dig-570-2483.html].</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

| | |
|------------------------|--------------------------------------|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
|------------------------|--------------------------------------|


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 57




| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> | <p>Në dispozicioni të GVJ mbasi u kërkua gjatë vizitës në institucion, u vendos në dispozicion një raport financiar i detajuar i shoqërisë “Turgut Ozal Education sh.a” ku pjesë e saj është dhe Universiteti “EPOKA”. Ku dokument paraqet pasqyrat financiare për vitin kalendarik 2018 [Dok. në vizitë: 1. Sqarim mbi Raportin e Audituesit te pavarur] [Dok. në vizitë: 1. Deloitte-Raport i Audituesit te Pavarur dhe Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018].</p> <p>Bazuar në këto të dhëna dhe ato të deklaruara në raportet vjetore të vetë deklaraura nga institucioni të dorëzuar në DVV për vitet akademike nga 2015-2016 deri në vitin akademik 2019-2021 në kapitullin 5 të secilit raport jepet një përmbledhje e shpenzimet operative për secalin vitin akademik dhe kostoso për student.</p> <p>[Annual_Report 2015-2016; 2. RAPORTI VJETOR 2016-2017; 2. RAPORTI VJETOR 2017-2018; 2. Annual Report 2019_2020 dhe 2. Annual Report 2019-2020]</p> |
| <p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p> | <p>Në raportet vjetore vihet re një analizë analitike e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel institucioni.</p> <p>Nga analiza edhe e rregulloreve të brendshme, vihet re një procedurë e konsoliduar e hartimin të nevojave të brendshme të institucionit në nivel programi studimi të cilat më pas reflektohen edhe në planifikimin e buxhetit të vitit pasardhës. Procedura është transparente edhe për hartimin e nevojave për literaturë dhe pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj.</p> <p>Bazuar në raportet vjetore të hartuara nga institucioni në 6 vitet e fundit shohim një përmbledhje të kostove për student të vlerësuara për çdo vit akademik në nivel universiteti.</p> <p>[Annual_Report 2015-2016; 2. RAPORTI VJETOR 2016-2017; 2. RAPORTI VJETOR 2017-2018; 2. Annual Report 2019_2020 dhe 2. Annual Report 2019-2020]</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> | <p>Sipas RVB, Universiteti EPOKA kryen audit të përvitshëm të pasqyrave financiare sipas dispozitave ligjore në fuqi si pjesë e shoqërisë “Turgut Ozal Education sh.a”.</p> <p>Vështirësi haset në raportimin e të dhënave financiare të cilat në bazë të dispozitave ligjore në fuqi janë sipas vitit fiskal (janar-dhjetor) dhe të audituara nga ekspertët përkatës dhe të depozituara në QKB, dhe të dhënave të kërkuar për menaxhimin e brendshëm të programeve të studimit të cilat janë në bazë viti akademik (afërsisht tetor-shtator të vitit pasardhës).</p> <p>Bazuar në raportet e kërkuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe në veçanti formati i tabelës 18 në RVB institucioni paraqet një pamje të të ardhurave nga tarifat për dhe gjatë shkollimit në formë përqindje.</p> <p>[RVB_BA ECE_Tabelat permbledhese_shqip]</p> |
| <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni</p> | <p>GVJ pati akses vetëm në vetë deklaratimet e institucionit në raportet vjetore të cilat janë depozituar në DVV si dhe publike në faqen ueb të institucionit.</p> |



| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Gjithashtu u vendos në dispozicion një raport i audituesit të jashtëm për vitin kalendarik 2018. Raporti hartohet nga drejtoria e Përgjithshme e shoqërisë “TurgutOzal Education Sh. A.” ku dhe IAL “Universiteti Epoka” është pjesë. Megjithatë, nuk kishte një raport të detajuar për vlerësimin ekonomik të këtijë programi studimi në veçanti. | | | |
| Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | Bazuar në raportet zyrtare financiare si: Pasqyra e të Ardhurave dhe deklarata e Shpenzimeve të Institucionit, kompania ka një bilanc vjetor pozitiv dhe stabilitet financiar i cili siguron përparimin e institucionit. Në këtë mënyrë institucioni nga pikëpamja financiare garanton zhvillimin e tij perspektiv duke qenë se ka një bilanc pozitiv. [Annual_Report 2015-2016; 2. RAPORTI VJETOR 2016-2017; 2. RAPORTI VJETOR 2017-2018; 2. Annual Report 2019_2020 dhe 2. Annual Report 2019-2020] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|--|------------------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| | |
|---|---|
| Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit | |
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | IAL “Universiteti Epoka” ka të miratura rregulloren themelore të tijë e cila saktëson të gjithë procedurën administrative nga pranimi i studentëve deri në diplomimin e tyre dhe marjen e diplomës përkatëse. Rregullorja është publike dhe e aksesueshme në ueb në adresën [http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/basic-regulation.pdf]. Gjithashtu, të dhëna specifike për këtë program studimi jepen edhe në udhëzuesin e studentit. [Annex 3.6.7 Smart Student Guide 2020-2021] |
| Kriteri 2. Politikrat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Institucioni, bazuar edhe në statutin, dhe në veçanti në nenin 117, ka politikrat dhe procedurat të qarta që garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta për të gjithë studentët dhe kandidatët për student. Edhe rregulloret e programit të studimit dhe ato të brendshme si për përfaqësinë e studentëve janë gjithëpërfshirëse. |

| | |
|---|--|
| | <p>Ndër kriteret e barazisë është edhe vlerësimi me meritë për bursat sipas kriterëve:</p> <p>1 - Bazuar në rezultatet e shkollës së mesme dhe Provimet e Maturës Shtetërore të Republikës së Shqipërisë. Pikët e bursave janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 6600 ose më shumë 100% ▪ 6400 - 6599.99 75% ▪ 6200 - 6399.99 50% <p>2 - Bursa bazuar në rezultatet e provimit SAT. Pikët e bursave janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 1350 ose më shumë 100% ▪ 1290 - 1349 75% ▪ 1220 - 1289 50% <p>Institucioni ofron edhe bursa të plota për disa kategori të ndryshme studentësh si bursa për fëmijët e ish-policëve të rënë në krye të detyrës, fëmijëve jetimë, fëmijëve nga komuniteti Romë dhe Egjiptian si dhe gjithashtu sportistëve të dalluar.</p> <p>Këto informacione dhe të tjera në lidhje me institucionin bëhen publike edhe nëpërmjet fushatave komunikuese dhe marketingu që institucioni harton.</p> <p>[Dekanati i studentëve: http://dos.epoka.edu.al/] [http://admissions.epoka.edu.al/cat-scholarships-2745.html] [3. Rector_s Cabinet_Framework Strategy and Action Plan 2018-2022] [47.1 Marketing Policy].</p> |
| <p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p> | <p>Universiteti Epoka, bazuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, çdo vit publikon kriteret dhe procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të studentëve jo vetëm në këtë program studimi, por për të gjithë programet e studimit të ofruara nga institucioni.</p> <p>Kriteret bëhen publike në faqen ueb syrtare të institucionit në adresën [http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html]</p> <p>Gjithashtu informacioni bëhet publik edhe në portalin e aplikimit U-Albania sipas periudhës dhe udhëzimeve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, ku publikohen edhe afatet kohore përkatëse.</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p> | <p>Bazuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, Universiteti Epoka harton kriteret specifike për çdo program studimi të ofruar prej tij. Kriteret bëhen publike në faqen e institucionit si dhe në portalin U-Albania ku kandidatët për student aplikojnë.</p> <p>Për programin specifik Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikim Dixhital, për vitin akademik 2020-2021, kriteret e vendosura nga institucioni dhe të publikuar në portalin U-Albania janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Notë mesatare > se 7/10 - Note mesatare në lëndët Matematikë dhe Fizikë > se 7/10 - Niveli i zotërimit të gjuhës angleze B1 sipas CEFR. <p>Kandidatët duhet të paraqesin dëshmi të njohjes së gjuhës angleze në nivelin “B1” sipas CEFR (Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët) në një nga provimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cambridge |

| | <ul style="list-style-type: none"> - TOEFL Internet-based Test (iBT) - TOEFL Paper-based Test (ITP) - IELTS - TOEIC - GESE - APTIS, <p>Kandidatët të cilët kanë ndjekur dhe përfunduar të gjithë ciklin e shkollës së mesme në gjuhën angleze, janë të përjashtuar nga detyrimi për të paraqitur dëshminë e njohjes së gjuhës angleze.</p> <p>[http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html]; [https://ualbania.al/pages/fakultete.html?id=35]</p> | | | | | | | | |
|--|---|-----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|----------|
| <p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p> | <p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike për programin e studimit, propozohen nga njësitë bazë të fakultetit përkatës, miratohen nga Dekanati i Fakultetit dhe miratohen nga ana e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Kriteret e miratuar dërgohen sipas kuadrit ligjor në ministrinë përkatëse për arsimin si kriteret të përzgjedhjes së kandidatëve për vitin e ardhshëm akademik. Të dhëna që më pas përdoren në sistemin U-Albania në nivel kombëtar për rankimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve.</p> <p>Për shtetasit e huaj aplikohen të njëjta kriteret si edhe për shtetasit shqiptarë sikurse duket nga analiza e faqes ueb të institucionit për krahasim të kriterëve për studentët ndërkombëtar dhe atyre vendas.</p> <p>[http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-495-1926.html]; [http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html].</p> | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> | <p>Universiteti Epoka ka politika dhe udhëzime të brendshme që përcaktojnë mënyrën dhe modelet e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. Këto informacione dhe të tjera në lidhje me institucionin bëhen publike edhe nëpërmjet fushatave komunikuese dhe marketingu që institucioni harton edhe në institucione arsimore parauniversitare.</p> <p>[47. Media and Public Relations Office Procedures]. [47.1 Marketing Policy]</p> | | | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table> | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | X |
| Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | | |
| | | | X | | | | | | |

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> | <p>Studentët e këtij programi studimi, bazuar edhe në syllabuset e lëndëve por edhe në statutin e institucionit si dhe në rregulloren e fakultetit dhe të programit të studimit, vlerësimi i dijeve bazohet në një sistem me pikë ku maksimumi i vlerësimit është 4.00. Në programet e të tre cikleve, në mënyrë që studentët të diplomohen, duhet të kenë arritur në përfundim të studimeve një mesatare të përgjithshme prej më së paku 2.00 nga 4.00. Në të njëjtën kohë, studentët mund të marrin çdo semestër një ngarkesë maksimale prej 45 ECTS. Sistemi i vlerësimit të rezultateve të studentëve tek Universiteti "EPOKA" nuk është i bazuar tek kalimi i vitit, por tek kalimi i lëndëve në bazë semestrale.</p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 61

| | | | | |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | [Smart_Student_Guide_2019-2020]. [Annex 3.8.1 Student Guide Final Comprehensive Exam] [Annex 6.9-Guideline "On Examinations"] | | | |
| Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Institucioni ka të publikuar në faqen zyrtare në ueb të dhënat me kriteret dhe procedurat që ndiqen për njohjen e kualifikimeve të mëparshme. Këto të dhëna janë të qarta dhe nuk lenë vend për interpretime apo keq-kuptime nga ana e studentëve sikurse jepet edhe në shtojcat e paraqitur nga institucioni në DVV. [Annex 3.8.1b Directive Graduation work of undergraduate programs] | | | |
| Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Bazuar edhe në kriteret e kërkuar në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", në plan-programet e lëndëve janë të paraqitur mënyrat e vlerësimit të dijeve. Gjithashtu informacione të përgjithshme jepen edhe në udhëzuesit e provimeve si për studentët ashtu edhe për lektorët. [Syllabus në DVV]. [Annex 6.9-Guideline "On Examinations"] | | | |
| Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti takimi me përfaqësues të studentëve, vihet re një qasje transparente dhe informuese e institucionit kundrejt studentëve. Studentët janë të qartë për procedurat dhe kriteret që duhen ndjekur për punimin e temës së diplomës, kriteret antiplagjaturë dhe rezultatet e pritshme që duhet të arrijnë. Në udhëzuesin e studentit jepen edhe të dhëna në lidhje me mënyrën e vlerësimit të sistemit anti-plagjaturë me anë të softuerit "Turnitin" Udhëheqësi i diplomës është përgjegjës për ndjekjen e studentit gjatë zhvillimit cilësor të punimit deri në përfundimin e tij. [Smart_Student_Guide_2019-2020] [Annex 3.8.1c Thesis Guideline] | | | |
| Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Organizimi i institucionit në nivel informimi është në disa hallka paralele të cilat informojnë studentin. Studentët në mënyrë periodike informohen me anë të njoftimeve me anë të postës elektronike. Një rol të veçantë në informimin e studentëve jo vetëm për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve por për cdo aspekt të lidhur me formimin e tyre, realizohet nga këshillimi me stafin administrativ në momentin që interesohen apo pranohen në programin e studimit. Një rol të veçantë në informimin dhe udhëzimin e studentëve e zë edhe Këshilli i Studentëve [http://dos.epoka.edu.al/cat-student-council-669.html]. Të dhëna të detajuara gjenden edhe në udhëzuesin e studentit [Annex 3.6.7 Smart Student Guide 2020-2021]. Gjithashtu, bazuar edhe në rregulloren e fakultetit përgjegjës për këtë program studimi për çdo student, zgjidhet një pedagog këshillues nga departamenti përkatës. Këshilluesi akademik ndjek studentin gjatë gjithë periudhës së studimeve. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Kurrë përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.3

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 62

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p> | <p>Studentët aktual, por edhe ata që parashikojnë të regjistrohen në këtë institucion, mund të marrin informacione të hollësishme në lidhje me strukturën akademike të ofruar nga institucioni dhe jo vetëm për këtë program studimi.</p> <p>Informacione të plota për këtë programstudimi gjenden në faqen ueb [http://cen.epoka.edu.al/home-bachelor-in-electronics-dig-570-2483.html]</p> <p>Këto informacione publikohen edhe në udhëzuesin e studentit dhe gjithashtu edhe në raportet vjetore të hartuara nga institucioni në përputhje me kriteret ligjore të raportimit të aktivitetit vjetor.</p> <p>[Smart_Student_Guide_2019-2020] [2. Annual_Report 2015-2016; 2. RAPORTI VJETOR 2016-2017; 2. RAPORTI VJETOR 2017-2018; 2. Annual Report 2019_2020 dhe 2. Annual Report 2019-2020]</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> | <p>Të dhëna specifike për modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese jepen në plan-programet e lëndëve. Të dhëna dhe materiale të lëndëve gjenden edhe në platformën online të institucionit ku studentët kanë akses në bazë përdorues/fjalëkalim e ndërtuar në platformën “Moodle”. Gjithashtu, udhëzues për studentët se si t’i përdorin dhe ku ti aksesojnë këto informacione janë të publikuara në faqen web të institucionit dhe gjithashtu gjenden edhe si udhëzues fizik.</p> <p>[Syllabus në DVV] [http://lms.epoka.edu.al/] [Annex No. 2.2 - EIS GuideLine - Students-Draft].</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p> | <p>Studentët e regjistruar në këtë institucion kanë adresa të postës elektronike në domain të institucionit. Këto adresa përdoren, në mënyrë periodike për të shpërndarë informacione nga zyra e karrierës mbi mundësitë e punësimit [dok. Nga vizita në institucion].</p> <p>Institucioni organizon çdo vit që prej vitit 2014 panairin e karrierës i cili për dy vitet e fundit është zhvilluar online si pasojë e kushteve të krijuara nga situata e pazakontë pandemike. Të dhëna të përditësuara gjenden edhe në faqen ueb të zyrës së karrierës [http://cpao.epoka.edu.al/].</p> |
| <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p> | <p>Platforma kryesore ku përditësohet i gjithë informacioni për studentët është faqia ueb e institucionit EIS. Studentët kanë qasje të përditësuar në të gjithë informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e të gjithë procesit didaktik dhe jo vetëm. Në të gjenden dhe përditësohen të dhëna në lidhje me orari mësimor, plani mësimor, syllabuset e lëndëve, orari i transportit nga dhe për në institucion në linjën Durrës-Universitet dhe Tiranë-Universitet dhe anasjelltas.</p> |
| <p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p> | <p>Universiteti EPOKA ka në përdorim një sistem informatik të brendshëm të personalizuar me nevojat reale të menaxhimit të të gjithë informacionit si për stafin administrativ, atë akademik dhe për studentët. Aksesit në këtë sistem është në bazë të përdorues/fjalëkalim dhe mund të aksesohet nga kudo ku ka një qasje në internet.</p> |

| | | | | |
|--|---|-----------------------------|----------------------------|-----------------------------|
| | Ky sistem është i ndarë logjikisht në nën-sisteme si: EIS, Turnitin, Curricula, LMS, EPAS, Library, Open Akses të cilat mund të aksesohen lehtësisht nga faqja ueb kryesore: [http://www.epoka.edu.al/]. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përbushet plotësisht | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht |
| | | | | X |

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|--|------------------------|--|------------------------|----------|---------------|-----------|-----------|----|-----------|-----|-----------|----|---|----|------|-----------|----|---|----|------|-----------|----|---|----|------|-----------|----|---|----|-----|-----------|----|---|----|-----|-----------------|------------|----------|------------|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve për çdo program studimi.</p> | <p>Numri i studentëve në të diplomuar për çdo program studimi të ofruar nga institucioni, dhe në veçanti për këtë program studimi janë paraqitur për gjashtë vitet e fundit në DVV dhe përkatësisht në [RVB_BA ECE_Tabelat permbledhese_shqip, tab. 23]:</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Student të diplomuar në këtë program studimi</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2015-2016</td> <td style="text-align: center;">12</td> </tr> <tr> <td>2016-2017</td> <td style="text-align: center;">18</td> </tr> <tr> <td>2017-2018</td> <td style="text-align: center;">17</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td style="text-align: center;">35</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td style="text-align: center;">35</td> </tr> </tbody> </table> <p>Bazuar edhe në plotësimin e dokumentacionit të paraqitur nga institucioni, janë shtuar edhe të dhënat për numrin e studentëve të diplomuar për vitin akademik 2019-2020.</p> <p>Të dhëna statistikore për numrin e studentëve të diplomuar jepen edhe në raportet vjetore të paraqitura edhe në dosjen e vetë vlerësimit gjatë vizitës në institucion si dhe të publikuara në faqen ueb zyrtare.</p> | Viti akademik | Student të diplomuar në këtë program studimi | 2015-2016 | 12 | 2016-2017 | 18 | 2017-2018 | 17 | 2018-2019 | 35 | 2019-2020 | 35 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Viti akademik | Student të diplomuar në këtë program studimi | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2015-2016 | 12 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2016-2017 | 18 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2017-2018 | 17 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2018-2019 | 35 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2019-2020 | 35 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>Institucioni ka dhe përpunon të dhënat sasiore të regjistrimit/ diplomimit/ largimit/transferimit etj për studentët. Referuar edhe tabelave të paraqitura në DVV kemi studentë të regjistruar për herë të parë si:</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Student të regjistruar në vit të parë</th> <th>Student të transferuar</th> <th>Gjithsej</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2015-2016</td> <td style="text-align: center;">32</td> <td></td> <td style="text-align: center;">32</td> <td style="text-align: center;">9.4</td> </tr> <tr> <td>2016-2017</td> <td style="text-align: center;">49</td> <td style="text-align: center;">1</td> <td style="text-align: center;">50</td> <td style="text-align: center;">9.14</td> </tr> <tr> <td>2017-2018</td> <td style="text-align: center;">33</td> <td style="text-align: center;">1</td> <td style="text-align: center;">34</td> <td style="text-align: center;">9.16</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td style="text-align: center;">31</td> <td style="text-align: center;">2</td> <td style="text-align: center;">33</td> <td style="text-align: center;">9.44</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td style="text-align: center;">52</td> <td style="text-align: center;">3</td> <td style="text-align: center;">55</td> <td style="text-align: center;">9.4</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td style="text-align: center;">41</td> <td style="text-align: center;">0</td> <td style="text-align: center;">41</td> <td style="text-align: center;">9.5</td> </tr> <tr> <td>Në total</td> <td style="text-align: center;">238</td> <td style="text-align: center;">7</td> <td style="text-align: center;">245</td> <td></td> </tr> </tbody> </table> <p>Këto të dhëna gjenden edhe në regjistrin fizik të administruar nga sekretaria mësimore ku gjatë vizitës në institucion u konsultua regjistri përkatës ku ishin të shënuara të gjitha largimet, transferimet, regjistrimet etj.</p> | Viti akademik | Student të regjistruar në vit të parë | Student të transferuar | Gjithsej | Nota mesatare | 2015-2016 | 32 | | 32 | 9.4 | 2016-2017 | 49 | 1 | 50 | 9.14 | 2017-2018 | 33 | 1 | 34 | 9.16 | 2018-2019 | 31 | 2 | 33 | 9.44 | 2019-2020 | 52 | 3 | 55 | 9.4 | 2020-2021 | 41 | 0 | 41 | 9.5 | Në total | 238 | 7 | 245 | |
| Viti akademik | Student të regjistruar në vit të parë | Student të transferuar | Gjithsej | Nota mesatare | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2015-2016 | 32 | | 32 | 9.4 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2016-2017 | 49 | 1 | 50 | 9.14 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2017-2018 | 33 | 1 | 34 | 9.16 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2018-2019 | 31 | 2 | 33 | 9.44 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2019-2020 | 52 | 3 | 55 | 9.4 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2020-2021 | 41 | 0 | 41 | 9.5 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Në total | 238 | 7 | 245 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | <p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me përgjegjësit e institucionit dhe ata të programit të studimit, u prezantua edhe aksesimi në platformën e menaxhimit EIS. Qasja në modulën e raporteve bëhet e në bazë të privilegjeve që përdoruesi ka, por në të dalin raporte të hollësishme edhe për statistikat e avancimit akademik, tërheqjet apo largimet etj.</p> <p>Këto raporte jepen edhe të përmbledhura në raportet vjetore të hartuara nga institucioni</p> <p>[RVB_BA ECE_Tabelat permbledhese_shqip, tab. 21]; [2. Annual_Report 2015-2016; RAPORTI VJETOR 2016-2017; RAPORTI VJETOR 2017-2018; Annual Report 2019_2020; Annual Report 2019-2020].</p> | | | | | | |
|---|---|----------------------|---------------------|----------------------|--|--|---|
| <p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p> | <p>Të dhënat statistikore disponohen nga institucioni edhe në përbushje të raporteve dhe udhëzimeve të kërkuara nga drejtori apo seksione të veçanta në ministrinë përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Gjithashtu, përdorimi i platformës së menaxhimit elektronik të të dhënave lejon një qasje të menjëhershme në performancën akademike të studentit. Të dhënat përfshijnë të gjithë jetën e studentit në Universitetin EPOKA, duke filluar që nga avancimi i tij akademik, të dhënat financiare në lidhje me institucionin, kërkesat e paraqitura për dokumentacione nga zyra të ndryshme brenda institucionit, etj.</p> | | | | | | |
| <p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u vu re përdorimi efektiv dhe efikas i sistemit të menaxhimit elektronik të brendshëm. Në këtë sistem ruhen të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me studentët që nga regjistrimi i tyre deri në përfundim të karrierës studentore. Këtu, dokumentacionin përveçse i azhurnuar në formatin elektronik, për efekte ligjore ruhet edhe në formë shkresore (hard copy). Kjo formë shkresore është lehtësisht e arritshme në arkivën përkatëse me të dhënat e menaxhimit të ruajtura në sistemin informatik.</p> | | | | | | |
| <p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p> | <p>Bazuar edhe në vizitën në institucion dhe në veçanti takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës, vihet re se Universiteti EPOKA i kushton një rëndësi të veçantë mbledhjes së të dhënave të studentëve të diplomuar. Kjo shërben edhe si një tregues i cilësisë dhe përdoret për përmirësimin e vazhdueshëm për të ofruar një program studimit që formon profesionist në fushat përkatëse.</p> <p>Këto të dhëna jepen në formë statistikore edhe në raportet vjetore që hartohen nga institucioni dhe publikohen në faqen ueb (shih raportet më sipër).</p> | | | | | | |
| <p>Shkalla e përbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table> | Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | X |
| Përbushet pjesërisht | Përbushet kryesisht | Përbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre



Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve

Bazuar në statutin e Universitetit EPOKA, prania e përfaqësuesve të studentëve është e sanksionuar në të gjitha organet kolegjiale.

| dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Në Universitetin EPOKA është i ngritur dhe funksionon edhe Këshilli Studentor i cili organizohet dhe kryen aktivitetin në bazë të statutit të tij [Annex 4.4 Statute_Uni_EPOKA_en] [http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/statute-of-student-council.pdf]. | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|--|-------------------|-------------------|-------------------|--------------------|-------------------|------------------------|--|------------------------|---------|-------------------|---------|-------------------|---------|-------------------|-----------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|------|--|------|--|------|--|-----------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|------|--|------|--|------|--|-----------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|------|--|------|--|------|--|-----------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|------|--|------|--|------|--|-----------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|------|--|------|--|------|--|-----------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|------|
| <p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p> | <p>Në statutin e Universitetit Epoka, në nenin 14 janë të përcaktuara organet kolegjiale si më poshtë [Annex 4.4 Statute_Uni_EPOKA_en]:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik; - Rektorati; - Dekanatet; - Asambletë e personelit akademik të njëjësive kryesore; - Këshilli i Etikës; - Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, - Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë; - Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët; - Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; - Bordi i Administrimit. <p>Në secilin prej këtyre organeve kolegjiale, studentët janë të përfshirë me përfaqësues të tyre. Prania e tyre është e sanksionuar edhe në Statutin e këshillit studentor [http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/statute-of-student-council].</p> <p>Studentët përveç pjesëmarrjes në organet kolegjiale të përmendura më sipër, janë pjesë e procesit të vlerësimit me anë të vlerësimeve periodike që plotësojnë si për stafin akademik ashtu edhe për institucionin dhe shërbimet e ofruara prej tij. [Annex 6.4-Course Instructor Evaluation Survey] [Annex 6.4.1 Student Satisfaction Survey] [Annex 6.4.2 Company Satisfaction Survey 2018-2019 Academic Year]</p> | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| <p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p> | <p>Ngarkesa e programit të studimit është e shpërndarë në tre vite akademike me një shpërndarje thujse uniforme midis orëve në auditor dhe atyre të studimit individual [RVB_BA ECE_Tabelat permbledhese_shqip, tab. 10].</p> <p>Ndarja e orëve mësimore (në Auditor dhe orë të studimit individual të studentëve) është si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="496 1420 1401 1888"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti akademik</th> <th colspan="2">Viti I (60 ECTS)</th> <th colspan="2">Viti II (60 ECTS)</th> <th colspan="2">Viti III (60 ECTS)</th> <th rowspan="2">Total ore / (180 ECTS)</th> </tr> <tr> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> <th>Auditor</th> <th>studim individual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="2">2015-2016</td> <td>752</td> <td>748</td> <td>768</td> <td>732</td> <td>656</td> <td>844</td> <td rowspan="2">4500</td> </tr> <tr> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">2016-2017</td> <td>672</td> <td>828</td> <td>722</td> <td>778</td> <td>624</td> <td>876</td> <td rowspan="2">4500</td> </tr> <tr> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">2017-2018</td> <td>672</td> <td>828</td> <td>722</td> <td>778</td> <td>624</td> <td>876</td> <td rowspan="2">4500</td> </tr> <tr> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">2018-2019</td> <td>672</td> <td>828</td> <td>722</td> <td>778</td> <td>624</td> <td>876</td> <td rowspan="2">4500</td> </tr> <tr> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">2019-2020</td> <td>672</td> <td>828</td> <td>722</td> <td>778</td> <td>624</td> <td>876</td> <td rowspan="2">4500</td> </tr> <tr> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> <td colspan="2">1500</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>672</td> <td>828</td> <td>672</td> <td>828</td> <td>576</td> <td>774</td> <td>4500</td> </tr> </tbody> </table> | Viti akademik | Viti I (60 ECTS) | | Viti II (60 ECTS) | | Viti III (60 ECTS) | | Total ore / (180 ECTS) | Auditor | studim individual | Auditor | studim individual | Auditor | studim individual | 2015-2016 | 752 | 748 | 768 | 732 | 656 | 844 | 4500 | 1500 | | 1500 | | 1500 | | 2016-2017 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 | 1500 | | 1500 | | 1500 | | 2017-2018 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 | 1500 | | 1500 | | 1500 | | 2018-2019 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 | 1500 | | 1500 | | 1500 | | 2019-2020 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 | 1500 | | 1500 | | 1500 | | 2020-2021 | 672 | 828 | 672 | 828 | 576 | 774 | 4500 |
| Viti akademik | Viti I (60 ECTS) | | Viti II (60 ECTS) | | Viti III (60 ECTS) | | Total ore / (180 ECTS) | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | Auditor | studim individual | Auditor | studim individual | Auditor | studim individual | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2015-2016 | 752 | 748 | 768 | 732 | 656 | 844 | 4500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2016-2017 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2017-2018 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2018-2019 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2019-2020 | 672 | 828 | 722 | 778 | 624 | 876 | 4500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | 1500 | | 1500 | | 1500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 2020-2021 | 672 | 828 | 672 | 828 | 576 | 774 | 4500 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| | 1500 | 1500 | 1500 | |
|--|--|----------------------|-----------------------|---|
| | <p>Tabelat e planeve mësimore, të paraqitura në tabelat 10.1 – 10.6, të perditesuara nga IAL, paraqesin nje ndarje korrekte te lëndëve në vite akademike, kreditet përkatëse dhe orët në auditor dhe për studim individual të studentit. Plotësimi i këtyre tabelave ka pasaktësi të vogla në mbledhjen totale të orëve për disa prej viteve akademike, por që nuk prekin organizimin total të planit mësimor. P.sh. për vitet akademike 2016-2017 dhe deri në vitin akademik 2019-2020, shumatorja totale e orëve në auditor dhe studim individual për vitin e tretë jepet si $576 + 699 = 1275$, kur në të vërtetë, nëse bëhet analiza e secilës lëndë rezultojnë korrektësisht në $624 + 876 = 1500$ orë sikurse e kemi paraqitur në tabelën përmbledhëse më sipër.</p> <p>Gjithashtu, vërehet një ndarje e orëve në auditor për aktivitetet formuese në rreth 9-12 orë/ECTS.</p> <p>Nëse i referohemi vitit të fundit akademik (2020-2021) vërehet një ulje e orëve në auditor (shih tabelën më sipër) ku për vitin e parë ka kaluar nga 752 orë në 672 orë, për vitin e dytë nga 768 në 672 orë dhe për vitin e tretë nga 656 në 576 orë. Gjithsesi, është një mesatare nga 9 – 12 orë në auditor/ECTS çka gjykohet e nevojshme për përçimin e dijeve.</p> <p><u>GVJ rekomandon që të mos reduktohet më tej ngarkesa në auditor, e nevojshme për përçimin e dijeve.</u></p> <p>[DVV: 2021_07_07_Summary Tables of Annex_SER BA ECE], [DVV: Evidenca Summary Tables of Annex_SER ECE Tebla 10.1-10.6], [DVV: Sqarim ne lidhje me Tab 10 dhe 12], [http://eis.epoka.edu.al/curricula/3/program], [http://eis.epoka.edu.al/curricula/62/program]</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p> | <p>Bazuar në statutin e institucionit, studentët janë të përfshirë në të gjitha organet kolegjiale vendimmarrëse.</p> <p>Përtej përfaqësuesve të studentëve në organet e mësipërme, institucioni garanton mbledhjen e mendimeve, opinionëve dhe sugjerimeve të studentëve me anketimet periodike në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</p> | | | |
| <p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p> | <p>Studentët e këtij programi studimi, e pohuar edhe në taikimin me përfaqësues të studentëve gjatë vizitës në institucion [përmbledhë e vizitës në institucion], janë të informuar me procedura dhe rregullat që mund të ndjekin nëse dëshirojnë të ankimojnë një vlerësim.</p> <p>Në përfundim të çdo semestri, studentët nëpërmjet anketimeve japin opinionin e tyre për të gjitha aspektet e jetës studentore brenda institucionit.</p> <p>Nga takimi me studentët në institucion u vu re një komunikim i hapur me stafin akademik dhe atë administrativ çka sillte një qartësim të problematikave dhe një zgjidhje të tyre në mënyrë natyrale dhe frytdhënëse për studentët dhe institucionin. [Annex 6.4-Course Instructor Evaluation Survey] [Annex 6.4.1 Student Satisfaction Survey] [Annex 6.4.2 Company Satisfaction Survey 2018-2019 Academic Year]</p> | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | X |

Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|--|
| <p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p> | <p>Institucioni ka disa procedura dhe njësi që kanë në fokus informimin e studentëve jo vetëm për angazhimet akademike, por edhe ato shoqërore dhe sociale.</p> <p>Në veçanti është zyra e regjistrimit e cila ndjek jetën akademike të studentëve nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre. Kjo zyrë, nëpërmjet sistemit të postës elektronike, në mënyrë periodike njofton studentët për çdo event që mund të preki aktivitetin e tyre didaktik. Gjithashtu përcjell edhe informacione në lidhje me mundësitë e projekteve apo praktikave që mund të kryhen pranë institucioneve me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi. Në shërbim të informimit të studentëve është edhe këshilli studentor i përfaqësuar nga Dekanati i Studentëve</p> <p>[Annex 2.1 Organization Scheme].</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p> | <p>Në këtë kuadër edhe gjatë takimit në institucion, studentët konfirmuan që në institucion orientohen nga organet përkatëse jo vetëm në aspektin akademik por edhe atë shoqëror e social. Studentët e viteve më të larta orientohen, edhe në bazë të aftësive të tyre personale, të ndihmojnë studentët e viteve më të ulëta në avancimin e tyre akademik.</p> <p>Zyra e Regjistrimit së bashku me zyrën e karrierës dhe Këshillin studentor përbëjnë burimin primar të informacionit për studentët. Informacionet jepen të personalizuara në rast kërkese apo nevojë nga studentët por jepen kryesisht edhe në formë udhëzuesish apo manualesh të publikuara në faqen ueb përkatëse.</p> <p>Më pas studentët ndiqen nga pedagogët këshillues akademik (tutor) duke përfshirë këtu jetën e tyre akademike dhe atë shoqërore të lidhur me iniciativat e institucionit.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> | <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e të Diplomuarve zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e fakulteteve dhe departamenteve.</p> <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e të Diplomuarve organizon edhe panairin e përvitshëm të punës në ambientet e institucionit çka shihet si një mundësi informuese shumë pozitive nga studentët.</p> <p>Universiteti EPOKA dhe organet e tij, informon studentët edhe për mundësi bashkëpunimi/studimi me institucione partnere</p> |
| <p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën</p> | <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e të Diplomuarve përpilon të dhëna statistikore për studentët e diplomuar dhe punësimin e tyre mbas diplomimit Gjithashtu nëpërmjet rrjetit Alumni të dhënat statistikore bëhen publike edhe në faqen ueb të institucionit: [http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-office-1457-</p> |

| | | | | |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | 1491.html]. Në këtë faqe jepen edhe shembuj të karrierës pas-universitare të studentëve të diplomuar në programet e studimit të ofruara nga Universiteti EPOKA. Zyra e karrierës e ka të saktësuar edhe në politikat e brendshme zhvillimin periodik të paktën një herë në vit anketimin e rrjetit alumni [Dok. Nga vizita në institucion]. [1.7 List of Institutional Cooperations]. [Annex 6.3-Policy on Continuous Improvement of Study Program] | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

| Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë | |
|--|--|
| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
| Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Universiteti Epoka, bazuar edhe në skemën organizative, ka të ngritur dhe funksional Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) Ky komision është i ndërvarur nga senati akademik tek i cili edhe raporton veprimtarinë e tij. Funksionimi i këtij komisioni bazohet në koordinimin e punës dhe të dhënave nga tre organe vartëse: Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve. Funksionimi i këtyre organeve garanton sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në Universitetin EPOKA. Funksionimi i këtyre organeve sanksionohet në rregulloret përkatëse të cilat janë publike dhe të afishuara në faqet ueb përkatëse [Annex 2.1 Organization Scheme]. [http://epoka.edu.al/home-staff-doc-publications-6-404.html], [http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-sigurimit-dokumente-1404.html]. |
| Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Bazuar në strukturën organizative të institucionit, ekziston Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) i cili vepron si një organ kolegjal me të paktën 5 (pesë) anëtar. Gjatë vizitës në institucionin u realizua edhe takimi me anëtarë të këtij komisioni. Në përbërjen e këtij komisioni është të paktën një përfaqësues i çdo fakulteti me të paktën gradën shkencore “Doktor”. Në këtë komision përfaqësohet edhe stafi administrativ, studentët si dhe një ekspert i jashtëm. Bazuar edhe në detyrat dhe rregullat e funksionimit të senatit studentor, nënkryetari i këshillit studentor është gjithashtu anëtar i këtij komisioni. [Annex 2.1 Organization Scheme] |

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219, Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



Faqe 69

| | | | | |
|--|---|------------------------------------|-----------------------------------|--|
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> | <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) koordinon realizimin e procesit të vetë vlerësimit të institucionit nëpërmjet mekanizmave dhe akteve rregullatorë të brendshme.</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në nivel institucioni dhe programi studimi organizohet në mënyrë periodike nga agjencitë përkatëse akredituese (ASCAL). Raportet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë si për institucionin ashtu edhe për program studimi janë publike në faqen ueb të institucionit në adresën [http://aeqi.epoka.edu.al/].</p> | | | |
| <p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p> | <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) koordinon realizimin e procesit të vetë vlerësimit të institucionit nëpërmjet mekanizmave dhe akteve rregullatorë të brendshme.</p> <p>Bazuar në sugjerimet dhe gjetjet e këtij komisioni, hartohen politika të brendshme për rritjen e cilësisë në të gjitha aspektet e jetës akademike, administrative dhe sociale të institucionit dhe stafit.</p> <p>Për sa më sipër, janë të sanksionuar në rregullore dhe politika të brendshme të institucionit për përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit të ofuara [http://epoka.edu.al/mat/aeqi/EU-PLC-002-EN Policy on Continuous Improvement of Study Program.pdf].</p> | | | |
| <p>Shkalla e përbushjes së standardit</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> | <p>Përbushet pjesërisht</p> | <p>Përbushet kryesisht</p> | <p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjsteve të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p> | <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), në rastin e vlerësimit të një programi studimi, koordinon procesin e rishikimit duke filluar në nivel departamenti. Bazuar në ndryshimet e propozuara dhe sugjerimet e paraqitura në nivel departamenti, rezultatet përcillen në njësinë kryesore përkatëse (fakultet). Institucioni ka procedura të qarta për propozime për ndryshime apo rishikime të programeve të studimit ekzistuese.</p> <p>Vendimi i departamentit dhe i Dekanit përkatës, bazuar në procedurat e brendshme, i përcillen Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave i cili shqyrton propozimet në përputhshmëri me objektivat e zhvillimit të institucionit.</p> <p>Nga ana institucionale, propozimet e komisionet të Zhvillimit të Kurrikulave i përcillen Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Mbas shqyrtimit në të gjitha këto komisione, vendimi përfundimtar për aprovimin e ndryshimeve shqyrtohen në Senatit Akademik bazuar në relacionet përkatëse të përcjella nga të gjitha zyrat dhe komisionet e përfshira në këtë proces. [Annex 6.3-Policy on Continuous Improvement of Study Program] [52. Curricula change procedure], [52.1 Curriculum Change Proposal Form] [136 curricula change format]</p> |

| | |
|--|--|
| <p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p> | <p>Bazuar në dosjen e vetë vlerësimit, vizitës në institucion sidomos takimi me studentët studentët në mënyrë periodike në fund të çdo semestri plotësonin anketime në lidhje me të gjitha aspektet e jetës akademike dhe jo vetëm në institucion.</p> <p>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe organet nga ai i varur sikurse janë: Zyra e sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, Bordi i Provimeve, etj. Kanë mekanizma të qarta për të vlerësuar në mënyrë periodike të gjitha aspektet akademike, administrative dhe sociale të organiuzara nga institucioni dhe për institucionin.</p> <p>Të dhënat kryesore mbliidhen nga proceset e anketimeve të cilat përpunohen për të nxjerrë të dhëna statistikore në funksion të përmirësimit të cilësisë. [dok. Takime në vizitë],</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p> | <p>Institucioni kryen analiza semestrale dhe vjetore për ecurinë e programeve të studimit duke i rishikuar ato në kontekstin e kërkesave të tregut. Rezultatet e anketimeve përbëjnë elementët kyç në vlerësimin e një programi studimi.</p> <p>Anketimet që përdoren nuk janë vetëm ato të përpiluara nga studentët aktual, por edhe ato të plotësuara nga ish studentë në kuadër të strukturës alumni.</p> <p>Analiza e anketimeve shërben për vlerësimin dhe orientimin e programit të studimit drejt nevojave të tregut të punës kombëtar dhe ndërkombëtar në varësi të profilit të programit të studimit. [Annex 6.4.1 Student Satisfaction Survey]. [Annex 6.4.3 Alumni Form].</p> |
| <p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> | <p>Raportet e brendëshme të cilësisë të hartuara nga përpunimi i të dhënave të anketimeve por jo vetëm, analizohen në të gjitha hallkat vendimmarrëse të institucionit.</p> <p>Raportet e hartuara dhe vlerësimet përkatëse përcillen në formë hierarkike Departament > Dekanat > Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulave > Komisioni i Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë > Senati Akademik.</p> <p>Detajet e raporteve janë specifike dhe të përmbledhura sipas hallkës së zinxhirit hierarkik që do të kryej analizën. Vlerësimet specifike për lëndë të caktuara apo aspekte të veçanta të tyre, analizohen në detajen në nivel departamenti, analiza dhe vlerësime më specifike në nivel program studimi dhe staf akademik realizohet në nivel dekanati. Hallkat e tjera analizojnë rezultatet e vlerësimit në kontekstin e programit specifik të studimit si dhe në atë të zhvillimit institucional.</p> <p>Raportet e përmbledhura, edhe në kuadër të ruajtjes së privatësisë së të dhënave, bëhen publike të përmbledhura apo të përpunuara në faqen zyrtare të institucionit [http://aeqi.epoka.edu.al/] ku aktualisht janë të publikuara disa prej këtyre vlerësimeve.</p> |
| <p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p> | <p>Raportet e vlerësimit individuale për secilin pedagog/staf akademik përmbajnë të gjithë treguesit e nevojshëm apo parametrat vlerësuese të dobishme për vet stafin që të përmirësojë në vijim.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion na u vunë në dispozicion edhe raporte vlerësimi për staf akademik efektiv të këtij programi studimi të realizuar për semestre dhe lëndë të ndryshme për të njëjtin pedagog ku vihej re objektiviteti i analizës dhe raporteve</p> |

| | | | | |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| | përkatëse që ishin secili i veçantë dhe me pika të ndryshme për tu analizuar lëndë pas lënde. | | | |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Përmbushet plotësisht | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
| | | | | X |



Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|--|---|
| <p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p> | <p>Zyrat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në mënyrë periodike dhe të vazhduar realizojnë vlerësimin e brendshëm të këtij programi studimi.</p> <p>Raportet e hartuara kryesisht në nivel departamentit bazohen në përpunimin e anketimeve studentnotre për çdo lëndë dhe çdo pedagog të angazhuar në procesin e mësim dhënies përkatëse.</p> <p>Përpunimi i këtyre të dhënave kryehtë në formë të automatizuar dhe statistikore nga sistemi i menaxhimit të brendshëm elektronik të informacionit EIS.</p> <p>Ndërtimi i raporteve dhe vlerësimeve përkatëse bazohet në direktiva të brendshme të njohura nga të gjithë punonjësit e institucionit.</p> <p>[Directive_Acad _ Admin Perfor Assess _ Quality Improv].</p> |
| <p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p> | <p>Bazuar në rregulloren institucionale, i gjithë procesi i raportimit, vlerësimit dhe veprimit bazohet në të njëjtën procedurë institucionale dhe nuk është specifike për këtë program studimi.</p> <p>Ndër kriteret specifike që përdoren nga institucioni në vlerësimin e brendshëm është edhe numri dhe cilësia e botimeve/publikimeve shkencore të realizuara nga stafi brenda një periudhe të caktuar vjetore.</p> |
| <p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p> | <p>Burimi parësor i mbledhjes së të dhënave nga institucioni për vlerësimin e të gjithë procesit didaktik bazohet kryesisht në anketime të plotësuara nga studentët por edhe nga vetë stafi akademik.</p> <p>Në rast ankesash apo vlerësime të ulëta të stafit në kriteret e vlerësimit të cilësisë, organet vendimmarrëse kanë mekanizma të përcaktuara qartë për ndjekjen dhe përmirësimin e cilësisë në tërësi.</p> <p>Në rast vlerësimi të ulët në mësimdhënie apo në provime, drejtuesi i njësisë bazë (përgjegjës departamenti) dhe ai i njësisë kryesore (dekan) zhvillojnë vëzhgime në klasë në formë të leksioneve të hapura [Annex 6.4- Course Instructor Evaluation Survey]. [Annex 3.6.3 Guideline “On Examinations“]. [Annex 6.8-Directive “On the Functioning of the Exam Board”]</p> |
| <p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit</p> | <p>Institucioni përveç përdorimit të teknikave të anketimeve dhe përpunimit statistikor të tyre, përdor edhe metoda motivuese dhe vlerësuese të stafit</p> |

| | | | | | | | |
|--|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|---|
| <p>përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p> | <p>akademik në lidhje me performancën e tyre në kërkim shkencor apo angazhimin në projekte dhe administrativ.</p> <p>Pjesëmarrja në aktivitetet e tjera përveç atyre didaktike vlerësohen pozitivisht si motivuese të punës në grup dhe frymës bashkëpunuese brenda institucionit. Kjo vihet re edhe në përfshirjen e studentëve në projektet e institucionit në lidhje me kërkimin shkencor si dhe bashkë autorësinë e publikimeve shkencore të stafit me studentët.</p> <p>Rrjeti Alumni, i ngritur në Universitetin Epoka shërben edhe për të mbledhur të dhëna në lidhje me cilësinë e procesit didaktik por edhe për të kuptuar trendët dhe nevojat e tregut të punës dhe formimin që mungon apo duhet forcuar në aspektin didaktik. [Dok. Shënime në vizitë]. [Annex 6.4.3 Alumni Form]</p> | | | | | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <table border="1"> <tr> <td data-bbox="603 607 775 678">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="775 607 983 678">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="983 607 1192 678">Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td data-bbox="603 678 775 714"></td> <td data-bbox="775 678 983 714"></td> <td data-bbox="983 678 1192 714">X</td> </tr> </table> | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | X |
| Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht | | | | | |
| | | X | | | | | |

| <p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</p> | |
|---|--|
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> | <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) si dhe strukturat nën vartësinë e tijë, kryejnë të gjithë aktivitetin e tyre të monitorimit dhe vlerësimin të cilësisë bazuar në rregullore dhe politika të brendshme të cilat janë publike për të gjithë stafin.</p> <p>Për të paraqitur një vlerësim sa më objektiv të cilësisë dhe monitorimit të sajë, në përbërjen e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, është i angazhuar edhe një ekspert publik i cili nuk është pjesë e stafit të Universitetit</p> <p>Në politikat e rritjes së cilësisë edhe në nivel ndërkombëtar, insitucioni motivon zhvillimin e projekteve dhe publikimeve shkencore ku stafi motivohet edhe me mbështetje financiare.</p> <p>[Annex 6.12 – EPOKA Quality Assurance Handbook 19 12 2018]; [Annex 6.1- Regulation On the Organization and Functioning of the PCQA revised]; [Annex 3.7.9 DIRECTIVE “ON THE PROMOTION OF SCIENTIFIC PUBLICATIONS”].</p> |
| <p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimet u vu re se stafi administrativ ka detyra të ndara qartë dhe frymë bashkëpunuese mes tyre.</p> <p>Bazur në politikat dhe aktet e brendshme rregullatorë, detyrat janë të ndara për çdo strukturë përbërëse të institucionit, jo vetëm ato akademik por edhe administrative.</p> |
| <p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe</p> | <p>Në vlerësimin e brendshëm të cilësisë, institucioni ndjek një strukturë hierarkike të vlerësimin dhe analizës së raporteve të hartuara nga njësitë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë.</p> |

| | | | |
|--|---|-----------------------------|--|
| <p>kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> | <p>Raportet e hartuara dhe vlerësimet përkatëse përcillen në formë hierarkike Departament > Dekanat > Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulave > Komisioni i Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë > Senati Akademik.</p> <p>Në këtë formë, të gjitha hallkat administrative, akademike dhe vendimmarrëse janë të përfshira në procesin e vlerësimit të cilësisë.</p> <p>Gjithashtu, në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) ka të paktën një anëtar të çdo njësie kryesore (Fakultet), përfaqësohet stafi administrativ me të paktën dy anëtare, një përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm. Nënkrjetari i Këshillit Studentor për çështje të sigurimit të cilësisë është gjithashtu anëtar i Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë [Annex 6.1-Regulation On the Organization and Functioning of the PCQA revised].</p> | | |
| <p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> | <p>Në vizitën në institucion, dhe në veçanti takimi me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit, vlerësohet respektimi i fushave të ekspertizës për secilin prej anëtarëve të stafit akademik dhe administrativ. Në proceset sqaruese/udhëzuese dhe të vlerësimit të brendshëm merret gjithmonë opinioni dhe vlerësimi i stafit më me eksperiencë apo përgatitje në fushën përkatëse pa diskriminime të pozicionit administrativ që ka në institucion. Gjithashtu, në hartimin e raporteve apo edhe në interpretimin e të dhënave institucioni bazohet në politikat e sigurimit të cilësisë</p> <p>[Annex 6.7-Quality Policy].</p> | | |
| <p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p> | <p>Gjatë takimit në institucion, në veçanti takimi me stafin akademik, vihet re një frymë bashkëpunimi edhe me stafin akademik të ftuar në lidhje me procesin e përmirësimit të programeve të studimit dhe të silabuseve të lëndëve. Gjithashtu, si pjesë e vlerësimit të brendshëm të cilësisë, Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë</p> <p>[Annex 6.1-Regulation On the Organization and Functioning of the PCQA revised] ka në përbërjen e tij një ekspert të jashtëm (me karrierë publike të mirënjohur në sigurimin e cilësisë).</p> | | |
| <p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p> |

| | |
|---|---|
| <p>Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</p> | |
| <p>Kriteret</p> | <p>Vlerësimi i ekspertëve</p> |
| <p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, kërkesës së dokumentacioneve shtesë por edhe nga lundrimi në faqen web të institucionit, vihet re një transparencë në publikimin e raporteve vlerësuese të përmbledhura [Në web: raportet vjetore nga 2015 deri në 2019]. Gjithashtu institucioni bën publike për stafin dhe të gjithë të interesuarit të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve të pranuar, diplomuar apo larguar për cdo vit dhe për çdo</p> |

| | |
|--|--|
| për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | program studimi. Bëhen publike trajnimet e ndryshme të realizuara në kuadër të trajnimeve të stafit dhe ato të realizuara në kuadër të projekteve [Annex 3.1.1b Epoka University _ ACADEMIC TRAINING ON DIGITAL EDUCATION] |
| Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Të dhënat e mbledhura dhe përpunuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në tërësinë e tyre publikohen të përmbledhura dhe në formë statistikore, çka garanton mos cenimin e të dhënave personale në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9887, datë 10 Mars 2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Qasja në të dhënat e pa përpunuara, apo që identifikojnë personelin akademik, studentin apo çdo të dhënë personale, kryhet konform rregulloreve të brendshme institucionale dhe në vartësi të hierarkisë të stafit në institucion. Të dhënat janë të aksesueshme si raporte në sistemin elektronik të brendshëm (EIS) ku qasja në nivele të ndryshme të të dhënave garantohej nga privilegjet gjë gjithsecili ka në këtë sistem, çka garanton privatësinë dhe etikën e përpunimit të këtyre të dhënave. [http://epoka.edu.al/mat/Alumni Survey 2017 BAF.pdf]. |
| Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Bazuar në gjetjet dhe raportet e hartuara nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë në nivel institucioni po edhe ato të hartuara nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave, Bordi i Provimeve etj, analizohen nga organet kolegjiale sikurse janë Senati akademik, Dekanati apo edhe në nivel departamenti. Të gjitha këto hallka vendimmarrëse bazuar në këto raporte, hartojnë plane veprimi të detajuara me afatet kohore të realizimit dhe zyrat dhe stafi përgjegjës për realizimin por edhe ndjekjen dhe raportimin e realizimeve. Aktualisht në këtë universitet janë duke u zbatuar një plan veprimi për përfshirjen e tij në “QS Graduate Employability Rankings 2022” [Dok. Në vizitë: 5.Action Plan_QS Graduate Employability Rankings 2022_EPOKA UNiversity]. |
| Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Në kuadër të rritjes së vazhdueshme të cilësisë, Universiteti Epoka organizon ovente trajnuese si për stafin akademik ashtu edhe atë administrativ. Gjithashtu vihet re një staf me eksperience dhe i konsoliduar në përbërjen e Njësisë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Në këtë njësi ka staf të angazhuar që në vitin akademik 2014-2015 e në vijim sikurse pjesa më e madhe është e ngazhuar në këtë funksion që nga viti akademik 2017-2018 [Tab. 24 në RVB_BA ECE_Tabelat permbledhese_shqip]. |
| Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Në kuadër të rritjes së vazhdueshme të cilësisë, Universiteti Epoka organizon ovente trajnuese si për stafin akademik ashtu edhe atë administrativ. [Annex 3.1.1b Epoka University academic training on digital education], [Annex 3.2.4b Epoka University open forum bringing creativity into 21st century classrooms] [Annex 3.2.5 Online Academic Workshop for Epoka University Staff] [Annex 3.2.6. - Epoka University Classes to be held through Remote Teaching during November 02-27, 2020], [Annex 3.2.6b - VTech Project - Acelerating Western Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies] |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Niveli i përmbushjes | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI | Niveli i përmbushjes | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
| | | | | X |

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri elektronike dhe komunikimi dixhital”, “Universiteti Epoka”

Pikat e forta dhe afirmime:



1. Sistemi funksional elektronik të menaxhimit të informacionit në funksion të administrimit të brendshëm të institucionit por dhe të gjithë aktivitetit didaktik;
2. Mjedise dhe infrastrukturë moderne në funksion të procesit mësimor dhe shërbimeve të tjera për studentët;
3. Pjesëmarrje në disa projekte kërkimore ndërkombëtare;
4. Fuqizimi i bazës laboratorike bazuar në donacionet e projekteve;
5. Proces selektiv përzgjedhës për studentët në hyrje bazuar në meritë dhe vlerësimi i meritave me bursa akademike çka rrit cilësinë e studentëve në hyrje;
6. Zhvillimi i të gjithë procesit akademik për këtë program studimi në gjuhën angleze;

Pika të dobëta:

1. Ndarja e orëve në auditor/studim individual në aktivitetet didaktike formuese (Leksione/Seminare/ushtrime/Laboratore) nuk ka një standard uniform për të gjitha lëndët e këtij programi studimi;
2. Personeli akademik me kohë të plotë në vitin akademik 2020-2021 mbulon 69% të ngarkesës mësimore;
3. Jo të gjitha lëndët e këtij programi studimi kanë titullarë sipas përcaktimeve ligjore në fuqi;
4. Literatura e detyrueshme e programit të studimit, në disa lëndë është jo e 5 viteve të fundit.

Rekomandime:

1. Të realizohet ndarja uniforme e orëve në auditor/studimin individual për lëndët e këtij programi studimi, nëse është e nevojshme të rishihet shpërndarja e orëve midis aktiviteteve formuese;
2. Universiteti Epoka të kujdeset që cdo vit akademik të plotësohet standardi që të paktën 70% e ngarkesës mësimore të mbulohet nga stafi efektiv.
3. Të zvogëlohet ngarkesa e stafit akademik në mënyrë që të garantohet një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore.
4. Të mbulohen të gjitha lëndët e këtij programi studimi me titullarë sipas dispozitave ligjore në fuqi;

5. Të përditësohet literatura e detyrueshme për të gjitha lëndët e programit të studimit;
6. Universiteti EPOKA të kujdeset që personeli që angazhohet në proceset e vetëvlerësimit të trajnohet në mënyrë periodike.

Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program "Bachelor in "Electronic Engineering and Digital Communication", "Epoka University"

Strengths and affirmations:



1. Functional electronic information management system in function of the internal administration of the institution but also of all didactic activity;
2. Modern facilities and infrastructure in function of the education process and other services for students;
3. The participation in several international research projects;
4. The strengthening of laboratory infrastructure based on project donations;
5. The selection process for incoming students based on merit and assessment of merits with academic scholarships which increases the quality of incoming students;
6. The Development of the entire academic process for this study program in english;

Weak points:

1. Non-uniform teaching load ratio of auditorium/individual study for each subject of this study program and for each didactic activities (Lectures/Seminars/exercises/Laboratories);
2. Full-time academic staff in the academic year 2020-2021 is responsible for 69% of the teaching load;
3. Not all courses of this study program have titles according to the legal provisions in force;
4. The mandatory literature of the study program, in some subjects is not of the last 5 years.

Recomandations:

1. To perform the uniform division of hours in the auditorium / individual study for the subjects of this study program, if it is necessary to reconsider the distribution of hours between education activities;
2. Epoka University to ensure that every academic year the standard is met so that at least 70% of the teaching load is covered by the effective staff;
3. To reduce the workload of the academic staff in order to guarantee a qualitative teaching and learning.
4. To cover all subjects of this study program with respective academic title professor according to the legal provisions in force;
5. To update the mandatory literature for all subjects of the study program;
6. EPOKA University ensures that staff involved in self-assessment processes is trained periodically.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|--|----------------------|---------------------|----------------------|
| | plotësisht | përbushen pjesërisht | përbushen kryesisht | përbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |